Gjatë 12-mujorit të vitit 2018, Bashkia Shkoder ka shlyer investime, detyrime të prapambetura në total 151 milion lekë, të përbëra si më poshtë:

Investime në vlerën 81,914 mijë lekë.
Investimet nga FZHR në shumën 41,719 mijë lekë.
Mallra dhe Shërbime në vlerën 23,999 mijë lekë.
Vendime gjyqësore në vlerën 3.496 mijë lekë.
Të tjera në vlerën 12 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave të veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe donacione. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2018 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit.

Keto politika të lehtësimit fiskal dhe incentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht natyrisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga

taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2018 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave.

Kujdes të veçantë gjatë vitit 2018 ju kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Kështu u hapën module të reja për dixhitalizimin on-line të akt-kontrolleve të mbajtura në terren, u mundësua hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, u mundësua llogaritja automoatike e kamatvonesave, u mundësua llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë Z1N për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulanteve etj.

U krijua aplikacioni për smartphone “Taksat e Mia Shkodër”, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare.

Gjatë vitit 2018 u mundësua lidhja on-line me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, dhe ka filluar up-date-imi i të dhënave për subjektet dhe familjet.

Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar 103%, duke përmbushur pritshmëritë referuar planifikimit buxhetor. Tejkalmi i planit fillestar buxhetor të vitit 2018 ka ardhur kryesisht nga tejkalmi i planit për kategoritë “të ardhur të tjera dhe donacione” si rezultat i marrëveshjeve të bashkisë me donatorë dhe praktikantët e mira të ushtruara, vjelja e detyrimeve të prapambetura si rrjedhojë performancës së punës dhe e procedurave të aplikuara, masat administrative të vendosura nga inspektoriat i mbrojtjes së territorit, si dhe dhe dhënia me “qira e aseteve të bashkisë” në zbatim të vendimeve të këshillit bashkiak.

Gjithashtu në krahasim me vitin e kaluar ka patur rritje të ndjeshme, duke realizuar +90,111 mijë Lekë të ardhura më shumë, ose +15% më shumë se viti 2017.

Referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2018, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të hyrave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor.

Të ardhurat e veta u realizuan nga Drejtoria e të Ardhurave, nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj

qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Kategorizimi i të ardhurave

Taksat vendore:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa e fjetjes në hotel
- Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT
- Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi

Taksat e ndara:

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ZRPP
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, agjent DRSHTRR
- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare agjent DRT
- Tatimi mbi të ardhurat personale, agjent DRT

Tarifat vendore

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- Tarifa për ndriçimin publik
- Tarifa për gjelbrimin
- Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër
- Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
- Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
- Tarifa për zënien e hapësirave publike

Të ardhura të tjera:

- Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
- Të ardhura nga gjoba
- Të ardhura nga qiraja asetëve, zhdëmtime, shitja e mallrave, e shërbimeve etj

Donacione

Realizimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore

Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore

në/000 lekë

TOTALI

702,144


Të ardhura nga taksat	280,071
Të ardhura nga Taksat e ndara	81,214
Të ardhura nga Tarifat Vendore	305,624
Të ardhura të tjera	30,811
Donacionet	4,424

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2018 arritën vlerën 702.144 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifatat, të ardhura të tjera dhe donacionet.

Analiza e peshës specifike sipas kategori

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifatat me 43% dhe të ardhurat nga taksat me 40% të totalit.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive



Analiza e peshës specifike sipas zërave

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2018 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 26% të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me 18%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 14%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura 10%, tarifa për zënien e hapësirës publike 5%, tarifa e ndriçimit publik 5%, tarifa e gjelbrimit 3%, taksa e tabelës 3%, tarifa nga institucionet e varësisë me 3%, taksa e fjetjes në hotel 2%, gjobat 2%, taksa mbi truallin 2%, etj.


Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara për vitin 2018.



Cash Floë (Fluksi Monetar mujor) i të ardhurave të veta, viti 2018

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Grafiku i të ardhurave fluide paraqet në baze mujore të ardhurat gjatë vitit 2018.



Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Qershor, periudhë e përcaktuar për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi. Gjithashtu ka një rritje në fund të vitit fiskal, falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe ndjekjes së masave administrative shtyrëse të ushtruara ndaj subjekteve debitore.

Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin


mijë/lek

LLOJET E TË ARDHURAVE	Bashkia Shkoder		
	Plan 2018	Realizim 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	678.761	702.144	103%
TË ARDHURANGA TAKSAT VENDORE	287.333	280.071	97%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	4.725	7.762	164%
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	100	270	270%
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	129.988	142.472	110%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	97.611	124.462	128%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	21.736	4.492	21%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	10.641	13.518	127%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	11.514	14.402	125%
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	124.000	99.431	80%
Të ardhura nga taksa e tabelës	17.006	15.735	93%
TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA	79.021	81.214	103%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	64.860	69.677	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	8.500	11.490	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	61	47	77%
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	5.600		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	297.236	305.624	103%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	166.879	176.965	106%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	34.267	34.828	102%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21.509	22.574	105%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	74.581	71.258	96%
TË ARDHURA TË TJERA	14.864	30.811	207%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	307	4.424	1441%

Realizimi i planit të të ardhurave në total është me realizim 103%



Grafiku i mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimit të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.



Zërat kryesorë, që janë me tejkallim në krahasim me e planin e vitit 2018 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhurat nga taksa e e kalimit të drejtës së pronësisë, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik, ndriçimit, gjelbërimit, të ardhura nga tarifa e parkimit të mjeteve të licensuara dhe parkimeve të rezervuara, të ardhurat nga kamatvonesat për subjektet, të ardhurat nga gjambat e IMT-së, si dhe të ardhura nga detyrime të prapambetura.


Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkallim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguese si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe realizimit të 1.500 akt-kontrolleve, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore rreth 2.500 bllokime llogari bankare dhe të hipotekave, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të takapagueve nëpërmjet realizimit të mbi 35 dëgjësive dhe njoftimeve në media, nëpërmjet dërgimit të rreth 5.900 njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyren me 1 Ndalesë, rivlersimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Në tejkallimin e planit kanë ndikuar gjithashtu edhe donacionet, te cilat nuk janë parashikuar në planin fillestar buxhetor, dhe janë përfituar gjatë vitit 2018, në kuadër të Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, dhe Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021. Gjithashtu bashkia Shkodër është shpallur fituese e konkursit kombëtar të Praktikave më të mira të


organizuar nga Agjensia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore në muajin Nëntor 2018, duke fituar edhe çmimin prej 10.000 Euro.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksat e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ZRPP me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore, tarifa e zënies së hapësirës publike si rezultat i reflektimit të uljes së tarifave në zonat periferike ranore si dhe rënies së aplikimeve, taksat e ndikimit në infrastrukturë si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve për leje ndërtimi, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale që mblidhet nga agjenti tatimor DRT, si rezultat i mosplotësimit të kuadrit ligjor organik. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim.

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive.



Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave për secilën Njësi Administrative më vehte.



Tabelat ne vijim paraqesin në mënyrë të detajuar zërat e veçantë të të ardhurave të realizuara në lidhje me planin për vitin 2018, për secilën Njësi Administrative, në vlera mijë Lekë.

Njësia Qendër			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	476.556	526.577	110%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	213.120	206.748	97%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	4.375	7.762	177%
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	100	218	218%
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	74.668	96.018	129%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	68.775	87.797	128%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore			
Të ardhura nga taksa mbi truallin	5.893	8.222	140%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	1.500	1.773	118%
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	118.400	86.689	73%
Të ardhura nga taksa e tabelës	14.077	14.288	101%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	43.420	42.882	99%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	32.430	34.839	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	5.950	8.043	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	5.040		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	209.775	246.375	117%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	131.633	150.661	114%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	30.261	32.552	108%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21.076	21.816	104%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	26.806	41.346	358%
TË ARDHURA TË TJERA	9.934	26.150	263%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	307	4.424	1441%

Bërdicë			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	18.423	17.162	93%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	8.290	8.094	98%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)		26	
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	7.147	4.140	58%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	2.452	2.535	103%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	3.920	884	23%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	776	721	93%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400	3.631	908%
Të ardhura nga taksa e tabelës	743	297	40%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	3.989	4.291	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	3.567	3.832	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	305	412	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	61	47	77%
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	5.331	4.589	86%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	3.950	3.694	94%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	439	457	104%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	15	4	25%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	928	433	47%
TË ARDHURA TË TJERA	812	187	23%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	



Postrisë			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	12.647	11.013	87%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	3.695	3.056	83%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	50		
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	3.110	3.042	98%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	1.394	1.930	138%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	1.344	675	50%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	372	438	118%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400		
Të ardhura nga taksa e tabelës	135	14	10%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	4.203	4.525	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	3.892	4.181	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	255	345	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	4.409	3.235	73%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	3.129	2.816	90%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	368	166	45%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	912	253	28%
TË ARDHURA TË TJERA	341	196	58%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Guri i Zi			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	16.522	10.368	63%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	5.856	2.341	40%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	50		
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	4.281	2.271	53%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	1.659	1.546	93%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	2.422	415	17%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	200	311	156%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400	62	16%
Të ardhura nga taksa e tabelës	1.126	7	1%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	4.851	5.222	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	4.540	4.877	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	255	345	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	5.473	2.696	49%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	4.035	2.305	57%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	493	138	28%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	15	4	29%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	929	248	27%
TË ARDHURA TË TJERA	342	108	32%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Velipojë			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	89.399	93.564	105%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	35.004	48.559	139%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	250		
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	21.253	29.343	138%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	16.999	25.276	149%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	1.499	1.149	77%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	2.755	2.918	106%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	10.000	12.560	126%
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3.200	5.862	183%
Të ardhura nga taksa e tabelës	301	794	264%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	5.376	5.841	109%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	4.865	5.226	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	455	615	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	48.310	37.058	77%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	7.628	7.231	95%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	737	925	125%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	358	692	193%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	39.587	28.210	71%
TË ARDHURA TË TJERA	710	2.106	297%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Dajç			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	15.401	8.960	58%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	6.879	1.897	28%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	6.418	1.897	30%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	1.745	1.208	69%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	4.482	544	12%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	191	144	76%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400		
Të ardhura nga taksa e tabelës	61	0	0%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	4.527	4.874	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	4.216	4.529	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	255	345	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	3.654	2.130	58%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	2.411	1.895	79%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	309	110	35%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	933	126	13%
TË ARDHURA TË TJERA	341	59	17%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Ana e Malit			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	10.759	6.824	63%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	3.857	1.550	40%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	3.186	1.298	41%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	734	788	107%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	2.254	385	17%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	198	126	63%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400		
Të ardhura nga taksa e tabelës	270	251	93%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	3.230	3.480	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	2.919	3.135	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	255	345	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	3.331	1.764	53%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	2.134	1.593	75%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	264	97	37%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	933	73	8%
TË ARDHURA TË TJERA	342	31	9%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Rrethina			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	30.225	23.098	76%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	9.398	7.227	77%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)		26	
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	8.714	3.954	45%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	3.672	3.010	82%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	4.799	390	8%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	243	554	228%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	14		
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	400	3.164	791%
Të ardhura nga taksa e tabelës	270	83	31%
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	5.874	6.335	108%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	5.513	5.923	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	305	412	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	13.886	7.577	55%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	11.478	6.589	57%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	1.395	381	27%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	45	58	130%
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	968	548	57%
TË ARDHURA TË TJERA	1.067	1.959	184%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	



Pult			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	2.324	1.045	45%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	155	104	67%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	147	104	70%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	101	66	66%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	39	19	48%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	7	18	273%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja			
Të ardhura nga taksa e tabelës	8		
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	860		105%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	649	697	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	155	210	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	985	34	3%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	123	33	27%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik		1	
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	862	0	
TË ARDHURA TË TJERA	325	1	
TË ARDHURA NGA DONACIONET			

Shosh			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	3.009	1.350	45%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	558	74	13%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	550	74	13%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	59	37	63%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	489	20	4%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	3	17	558%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel			
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja			
Të ardhura nga taksa e tabelës	8		
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	1.184	1.255	106%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	973	1.045	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	155	210	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	942	21	2%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	80	17	22%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik		0	
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	862	4	0%
TË ARDHURA TË TJERA	325	0	0%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	



Shalë			
LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2018	Realizimi 2018	%
TË ARDHURAT E VETA	3.496	2.183	62%
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	522	421	81%
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël			
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	514	330	64%
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	21	270	1264%
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	489	13	3%
Të ardhura nga taksa mbi truallin	4	48	1325%
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel		68	
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		22	
Të ardhura nga taksa e tabelës	8		
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	1.508	1.603	106%
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	1.297	1.394	107%
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e	155	210	135%
Të ardhura nga taksa e rentës minerare			
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	56		
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	1.141	146	13%
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	278	129	47%
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	1	0	61%
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	862	16	2%
TË ARDHURA TË TJERA	325	13	4%
TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	0	

Realizimi i të ardhurave 2018, krahasuar me vitet e kaluara


<i>/000 Lekë</i>	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	<i>Rritja me v. 2017</i>
Totali	482.687	506.154	612.033	702.144	+ 90.111
Taksat vendore	244.549	195.811	278.096	280.071	+ 1.975
Taksat e ndara	57.500	54.448	57.207	81.214	+ 24.007
Tarifat vendore	171.122	239.277	241.838	305.624	+ 63.786
Të tjera	9.515	11.523	32.153	30.811	- 1.342
Donacione	0	5.095	2.739	4.424	+ 1.685

Krahasuar me vitin 2017, realizimi i të ardhurave ka një rritje të dukshme me rreth 90.111 mijë Lekë, ose **15 % më shumë se viti i kaluar**.

Krahasuar me vitin 2016, realizimi i të ardhurave ka një rritje të dukshme me rreth 195.990 mijë Lekë, ose **39 % më shumë se viti 2016**.

Krahasuar me të ardhurat e vitit 2015 (përfshirë realizimin nga ish-komunat), ka një rritje me rreth 219,457 mijë lekë, ose **45% rritje nga viti 2015**.

Paraqitja grafike e realizimit të të ardhurave në vite



Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë nga viti në vit
Taksa e Pasurisë



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor.

Taksa e ndërtesës, krahasuar me vitin e kaluar, ka rritur dukshëm nivelin e arketimit me +26% më shumë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me +17.139 mijë Lekë nga nga banesat, dhe 10.449 mijë Lekë ndërtesat për qëllime biznesi, me një total rritjeje prej +29.579 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.

Taksa e *truallit*, krahasuar me vitin e kaluar, ka rritur gjithashtu dukshëm nivelin e arketimit me +17% më shumë ose me + 1.977 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.


Taksa e *tokës bujqësore*, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje prej + 14 mijë Leke më shumë. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqësore është ulur me 30%, pra deri në nivelin e lejuar të refencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve.

Rritja e të ardhurave ka ardhur si efekt edhe i procedurave të verifikimit të kapaciteteve, të ndjekjes së detyrime, bashkrendimit të punës ndërmjet Nj.A, drejtorisë së bujqësisë, agjentit tatimor, zyrave me një ndalesë etj.

Në zgjerimin e bazës taksapaguese dhe realizimin e të ardhurave për taksën e pronës, ku përfshihet ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore, ka ndikuar ushtrimi i rreth 1.500 kontrolleve në subjekte, me efekt rivlersimin e sipërfaqeve të ndërtesave dhe truallit, si dhe saktësimin të aktivitetit të tyre. Janë përfshirë falë monitorimit të sistemit të Z1N në skemën e pagesave të taksave dhe tarifave familjare rreth 1.400 familje në qytet, dhe rreth 1.350 familje në Nj.A., në total rreth 2750 familje, të cilat janë faturuar në SiTTV e bashkisë.


Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arketimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë.

Tatim fitimit i biznesit të vogël



Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja



Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rënie në arkëtim me -29,635 mijë Lekë, si rezultat i kërkesave të ulta për ndërtime në territorin e bashkisë.

Taksa e hotelit



Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, dhe faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Gjatë sezonit turistik janë kryer rreth 1.300 verifikime faktike të shfrytëzimit të hoteleve për efekt të taksës së hotelit. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rënie të lehtë prej -58 mijë Lekë, ardhur nga rënia e numrit të pushuesve joditorë.

Taksat e ndara



Taska e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor. Taksa vendoset nga agjenti tatimor i cili ja tranferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me +3.480 mijë Lekë, ose +43%. Rritja e të ardhurave lidhet me rritjen e procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga individë dhe biznese që aplikojnë pranë agjentit.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezultojnë një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë +20.511 mijë lekë, ose +42%, që është krijuar si rezultat i rritjes së numrit të automjeteve që aplikojnë për regjistrim pranë zyrave të DRShtRr.

Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” nga agjenti tatimor DRT, rezultojnë me një rritje të të ardhurave nga viti i kaluar me një vlerë +16 mijë lekë, ose +52%.

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, grumbullohet nga drejtoria tatimore në rolin e agjentit tatimor që i kalon 2% bashkisë. Për arsye të mosplotësimit të kuadrit ligjor, gjatë vitin 2018 DRT Tatimore nuk ka kaluar vlera për këtë taksë.


Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar +24.004 mijë lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +42%

Taksa e Tabelës



Taksa e tabelës për qëllime reklamimi, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rënie të lehtë prej -1.119 mijë Lek, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, me efekt uljen e bazës së taksës referuar aneksit Nr. 7 të këtij Ligji.


Tarifa e Pastrimit



Tarifat vjetore të pastrimit, që janë arkëtuar nga biznesi për vitin 2018 arrijnë në total vlerën e 104.351 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +19.543 mijë Lekë më shumë (nga kjo 13.500 si rezultat i shtesë tarifë landfill), ose +23%, që vjen edhe si rezultat i zgjerimit të bazës taksapaguese, si dhe i nxitjes dhe ndjekjes së procedurave ligjore ndaj subjekteve debitore.


Gjithashtu edhe të ardhurat me vlerë 71.845 mijë Lekë nga tarifat vjetore të familjeve kanë një rritje krahasuar me vitin e kaluar me vlerë +24,153, (7.200 si rezultat i shtesës së tarifës landfill), ose +9%. Kjo rritje ka ardhur edhe si rezultat i krijimit të mundësive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore, nxitjes dhe sensibilizimit ndaj shlyerjes së detyrimit kundrejt politikave lehtësuese sociale dhe shërbimit të standartizuar referuar përkatësisht çdo tarife, etj.

Tarifa e Ndrçimit




Tarifat vjetore të ndrçimit, që janë arkëtuar për vitin 2018 arrijnë në total vlerën e 34.828 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +5.242 mijë Lekë më shumë (nga kjo 1.950 si rezultat i shtesës së tarifës në Nj.A.), ose +17%, që vjen edhe si rezultat i nxitjes dhe ndjekjes së procedurave ligjore ndaj subjekteve debitore, krijimit të mundesive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore, nxitjes dhe sensibilizimit ndaj shlyerjes së detyrimit kundrejt politikave lehtësuese sociale dhe shërbimit të standartizuar referuar përkatësisht çdo tarife, etj.

Tarifa e Gjelbrimit



Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi për vitin 2018 arrijnë në total vlerën e 22.574 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +947 mijë Lekë më shumë ose +4%, që vjen edhe si rezultat i nxitjes dhe ndjekjes së procedurave ligjore ndaj subjekteve debitore, krijimit të mundesive për shlyerjen e detyrimit pranë zonave të banimit, ndarjes së detyrimit në këste mujore, nxitjes dhe sensibilizimit ndaj shlyerjes së detyrimit kundrejt politikave lehtësuese sociale dhe shërbimit të standartizuar referuar përkatësisht çdo tarife, etj.

Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë



Pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave, nëpërmjet grumbullimit të tyre dhe gjetjen e burimeve të reja, ato lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve.

Edhe pse tarifat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë pasur tendencë uljeje ose zerimi kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studenë, grupe rinore etj., gjithsesi falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet i ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2018 janë krijuar rreth 71.258 mijë Lekë të ardhura.

Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar, kemi një rritje me vlerë +13.839 mijë Lekë më shumë ose +24%.

Tarifat e shërbimit administrativ, kontroll zhvillim territori, AMTP etj. kanë një realizim +9.965 mijë Lekë më shumë se vitin e kaluar, që vjen edhe si rezultat i numrit të lartë të aplikimeve për kontrolle fizike të ndërtesave të përfunduara, përfshirjes në sistemin elektronik të shërbimeve ndaj qytetarit, shpejtësisë së ndjekjes së procedurave, rritjes së numrit të aplikimeve për AMTP, etj.

Tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimet publike ka një rënie të lehtë -267 mijë Lekë, ose -6%, si rezultat i zbritjes së tarifës për vendqëndrim autobuzi sipas VKB nr. 84, dt. 26.12.2017.

Tarifat e shërbimeve që kryen MZSH kanë një rritje prej +830 mijë Lekë, si rezultat i rritjes së numrit të kontrolleve të ushtruara nga inspektorët dhe detyrimit ligjor të gjithë subjekteve për rinovim të akteve kundra zjarrit.


Tarifat për zënien e hapësirës publike që janë arkëtuar për vitin 2018 arrijnë në vlerën 34.926 mijë Lekë, me një rritje prej +2.894 mijë Lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +9%, si rezultat i rritjes së kërkesës, por edhe nxitjes së shfrytëzimit në zonat periferike nëpërmjet uljes së tarifës me VKB nr. 84, dt. 26.12.2017. Rreth 77% e të ardhurave nga kjo tarifë u realizua në Plazhin Velipojë.

Kjo e ardhur e konsiderueshme për bashkinë u arrit falë evidentimit të vazhdueshëm të potencialit të kapaciteteve dhe aseteve, formalizimit transparent të marrëdhënieve me bizneset taksapaguese,

krijimit të procedurave të sakta e të thjeshta, si dhe shfrytëzimit efikas të hapësirave publike kryesisht ranore

Tarifat nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj që janë arkëtuar për vitin 2018 arrijnë në vlerën 18.660 mijë Lekë, me një rritje prej +1.764 mijë Lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +10%, si rezultat i rritjes së vizitorëve në muzeume, dhe nga tarifat e grumbulluara nga kopshtet dhe çerdhet.

Të ardhura te tjera dhe donacione



Të ardhurat e tjera dhe doancionat burojnë nga gjobat, kamatvonesat, qira dhe donacione. Për vitin 2018 janë grumbulluar 35.235 mijë lekë.

Krahasuar me vitet e kaluar, të ardhurat kanë pasur rritje me vlerë +343 mijë Lekë më shumë, ose +1%, falë shtimit të kontrollit dhe monitorimit në terren, implementimit të sistemeve të kompjuterizuara që shpejtojnë dhe thjeshtojnë procedurat, shfrytëzimit me efikasitet i kapaciteteve të ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi.


Në tejkalimin e planit kanë ndikuar donacionet, te cilat nuk janë parashikuar në planin fillestar buxhetor, dhe janë përfituar gjatë vitit 2018, në kuadër të Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, dhe Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021.

Gjithashtu bashkia Shkodër është shpallur fituese e konkursit kombëtar të Praktikave më të mira të organizuar nga Agjensia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore në muajin Nëntor 2018, ku u vlerësua për modelin e ndërtuar të shërbimeve sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë duke fituar edhe çmimin prej 10.000 Euro.

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2018, të kategorizuar sipas klasifikimit Ekonomik në mijë lekë.

Realizimi i të Ardhurave, Viti 2018, sipas Nj.A.	Njësia Qendër	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina	Pult	Shosh	Shalë
TË ARDHURAT E VETA	526.577	11.013	10.368	17.162	93.564	8.960	6.824	23.098	1.045	1.350	2.183
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	206.748	3.056	2.341	8.094	48.559	1.897	1.550	7.227	104	74	421
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7.762										
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	218			26				26			
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	96.018	3.042	2.271	4.140	29.343	1.897	1.298	3.954	104	74	330
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	87.797	1.930	1.546	2.535	25.276	1.208	788	3.010	66	37	270
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore		675	415	884	1.149	544	385	390	19	20	13
Të ardhura nga taksa mbi truallin	8.222	438	311	721	2.918	144	126	554	18	17	48
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	1.773				12.560						68
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	86.689		62	3.631	5.862			3.164			22
Të ardhura nga taksa e tabelës	14.288	14	7	297	794		251	83			
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	42.882	4.525	5.222	4.291	5.841	4.874	3.480	6.335	906	1.255	1.603
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	34.839	4.181	4.877	3.832	5.226	4.529	3.135	5.923	697	1.045	1.394
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	8.043	345	345	412	615	345	345	412	210	210	210
Të ardhura nga taksa e rentës minerare				47							
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale											
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	246.375	3.235	2.696	4.589	37.058	2.130	1.764	7.577	34	21	146
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	150.661	2.816	2.305	3.694	7.231	1.895	1.593	6.589	33	17	129
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	32.552	166	138	457	925	110	97	381	1		
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21.816		4	4	692			58			
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	41.346	253	248	433	28.210	126	73	548		4	16
TË ARDHURA TË TJERA	26.150	196	108	187	2.106	59	31	1.959	1		13
TË ARDHURA NGA DONACIONET	4.424										

Sic shihet në grafikun bashkangjitur, pesha kryesore në realizimin e të ardhura për vitin 2018 mbulohet nga Njësia Administrative qendër (qytet) me 81% të totalit të të ardhurave, dhe nga Njësia Administrative Velipojë me 12%, dhe zënë së bashku 93% të të ardhurave të veta. Njësitë e tjera së bashku kanë arkëtuar rreth 7% të të ardhurave të veta të bashkisë.



P1 Programi i Administratës Vendore

Mbështetja e programit të Adminsitratës Vendore ka për qëllim krijimin dhe mbështetjen në vazhdimësi të një strukture menaxhuese sa më cilësore e funksionale, që të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë. Përthithja e burimeve njerëzore profesionale në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës ka qenë pjesë e rëndësishme e punës gjatë vitit 2018. Në fokus të Bashkisë së Shkodrës kanë qenë formalizimi dhe përmirësimi i punës dhe shërbimeve administrative, dhe rritja e transparencës.

Pershkrimi i funksioneve dhe objektivave

Funksion i programit të Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është :

F1. Administrata vendore

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2018 kanë qenë:

F1.01 Burime njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

F1.02 Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për mirëfunksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës

F1.03 Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre

Produktet për vitin 2018

Aktivitetet dhe projektet që u realizuan për v.2018 janë:

P1.F1.01.A1 Ndërtim i administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Shkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me 367 punonjës nga këto: 1 i zgjedhur, 15 të emëruar politikë, 24 punonjës të policisë bashkiake, 15 punonjës të njësisë së menaxhimit të qendrave komunitare, 12 punonjës IMT, 201 nëpunës civilë dhe 99 punonjës mbështetës dhe administrativë; Plotesim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, VKM nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore

dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; i ndryshuar. Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u bazua në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Ky aktivitet synonte rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve : personel i ri i rekrutuar (13 punonjës ne nivel ekzekutive Një ndër detyrat më të rëndësishme të programit Administrim, Menaxhim dhe Planifikim është plotësimi i strukturës organizative me staf të kualifikuar në përmbushje të detyrave dhe funksioneve përkatëse të çdo pozicioni të lirë pune. Numri i aplikuesve për vendet e shpallura ishte rreth 40 aplikues. Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit kane qenë punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Shkodër. Realizuar 13 procedura ne kategorine ekzekutive me nga dy eksperte te jashtem

P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës

Ky aktivitet synonte që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryenin trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar trajnime për 15 punonjës si: trajnime të vijueshme profesionale të audituesve të brendshëm, trajnim të punonjësve të saporekrutuar për detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës, për realizimin e objektivave të drejtorive përkatëse etj. Këto trajnime janë realizuar me mbështetjen e Bashkisë Shkodër dhe të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

P1.F1.O1.A4 Aktivitet social -kulturor për stafin administrativ të Bashkise Shkoder

Meqenëse Bashkia Shkodër gjatë vitit 2017 ka arritur disa suksese në fusha të ndryshme të veprimtarisë së saj, përmendim këtu çmimin për transparencën më të lartë në raport me publikun për të gjitha

bashkitë e vendit duke u vlerësuar me 9.9 pikë nga 10 të mundshme sipas kritereve që përmban Indeksi Kombëtar i përcaktuar nga INFOCIP.

Ky cmim, që iu dha bashkisë Shkodër, u shoqërua edhe me premion prej 5000 Euro, që e konvertuar përbën shumën 668,250 lekë; Kjo shumë u depozitua në fund të vitit 2017 në llogarinë e Bashkisë Shkodër.

Në raportin vjetor të Ministrisë së Financave, Bashkia Shkodër është vlerësuar në vend të parë për bashkitë e mëdha dhe e dyta në nivel kombëtar për performancën dhe menaxhimin financiar, duke marrë kështu 430 pikë, nga 450 pikë maksimale të mundshme. Gjithashtu për herë të dytë radhazi Bashkia Shkodër u zgjodh fituese në konkursin rajonal të praktikave më të mira, mundësuar nga DLDP Decentralization and Local development programme; Bashkia Shkodër kryesoi listen e 12 bashkive fituese në thirrjen e lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), duke u vlerësuar me 75 pikë. Ky program ishte një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga PNUD në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi është bërë duke u mbështetur në tre fusha kryesore të tilla si dokumentat strategjike, mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, bashkëpunimi me OSHC-të.

Të gjitha këto arritje janë rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të administratës së Bashkisë Shkodër, me qëllim ofrimin e shërbimeve në të gjithë territorin dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Sa më sipër, Bashkia Shkodër vlerëson performancën e administratës si një element kyç për arritjen e objektivave zhvillimore të saj. Rrjedhimisht performanca në punë është e lidhur me motivimin. Motivimi, performanca dhe lidhja ndërmjet tyre janë çelësi kryesor i produktivitetit në punë. Për këtë qëllim është parashikuar krijimi i një fondi të veçantë. Ky fond shihet si një instrument i përshtatshëm për të vlerësuar nëpunësit për punën e tyre të mirë si dhe për t'i motivuar ato në të ardhmen. Duke bërë këtë kemi menaxhuar burimet njëzëre në termat e promovimit të performancës, përshtatjes dhe angazhimit personal. Ky fond u përdor për organizimin e veprimtarisë me karakter social-kulturor vizite në Budapest për administratën e Bashkisë Shkodër

P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë
Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj.

P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Shkodrës
Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

P1.F1.O2.A3 Shërbim higjeno-sanitar për administratën e Bashkisë së Shkodrës
Janë krijuar dhe siguruar ambjentet e punës sipas standardeve higjeno – sanitare në funksion të përmbushjes së kushteve të punës.

P1.F1.O2.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, dhe pajisje të tjera shtesë) Gjatë vitit 2018 janë realizuar blerja e materialeve, elektrike dhe bojera, stuko etj për lyerje.

P1.F1.O2.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës. Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas

nevojave në qendër , njësi administrative etj . U realizua shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet, shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .Realizuar blerja e dy automjeteve te reja prodhim i vitit 2016 me zero km

P1.F1.O2.A6 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja

Shërbimi për organizimin e pritjeve përcjelljeve synonte garantimin e standartit të shërbimeve të pritjes dhe përcjelljes së delegacioneve për rreth 237 persona perfaqesues dhe institucione vendase dhe te huaja me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar dhe është realizuar në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Duke qenë shpesh herë inisiatorë të takimeve të ndryshme me qëllim forcimin e partneritetit, Bashkinë Shkodër e vizituan delegacione të shumta dhe përfaqësues të institucioneve homologe të nivelit lokal, rajonal, dhe ndërkombetar dhe u arrit realizimi i tyre sipas standarteve . Në këtë projekt ishte i përfshirë edhe organizimi i një darke tradicionale për rastin e festave fetare (Darka për Iftar), e cila u realizua me procedurë prokurimi.

P1.F1.O2.A7 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë. Shërbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë ishte i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësimit të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, ëorkshop-e brenda dhe jashtë vendi . Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon.Tek ky aktivitet është realizuar dhe blerja e dhuratave për personalitetet dhe delegacionet e ndryshme që kanë vizituar Bashkinë Shkodër.

P1.F1.O2.A8 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar blerja e paisjeve të reja si tavolina,karrike ,etazherë, grrila dhe kondicionerë në shërbim të administratës vendore.

P1.F1.O2.A9 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik. Janë siguruar 10 ndërtesat dhe inventari ekonomik për vitin 2018.

P1.F1.O2.A10 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës. Janë përmirësuar kushtet në zyrat administratës vendore. Është realizuar hidroizolim ,suvatime,vendosje dyer e dritare dhe lyerje në magazinën qendër

P1.F1.O2.A12 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake

Është realizuar pajisja me uniforma për Policinë Bashkiake për vitin 2018, bazuar në ligjin 8224 ,datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës, i ndryshuar dhe VKM nr. 333 datë 02.06.1998 për "Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë", i ndryshuar, dhe urdherat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake.

P1.F1.O2.A13 Është realizuar shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër projektuar nga Sektori i Aseteve pranë Drejtorisë Juridike, i cili synonte përmbushjen e detyrimeve që Bashkia Shkodër kishte për regjistrimin e pronave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr.421, datë 02.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Shkodër, në Qarkun e Shkodrës"

P1.F1.O2.A14 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës

Është realizuar ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje).

P1.F1.O2.A15 . Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise)

Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N) është i shtrirë në 10 njësi administrative si dhe në 5 Lagjet e bashkisë Qendër në territorin e bashkisë Shkodër. Tashmë shërbimet administrative mund t'i ofrohen qytetarëve dhe bizneseve gjithashtu, sipas kërkesave teknike të stafit TIK është realizuar mirëmbajtja e shërbimeve, azhurnimi i tyre në dokumentacion,format, delegime funksionesh te reja, etj.

P1.F1.O2.A16 Informimi I qytetareve permes mediave vizive per perfitimin e sherbimeve nga Bashkia Shkoder. Është realizuar shërbimi i Informimit të qytetarëve përmes mediave vizive per perfitimin e sherbimeve nga Bashkia Shkoder.

P1.F1.O2.A17 Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV) Është realizuar mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV

P1.F1.O2.A19 Mirëmbajtje 3-vjeçare Pajisje Informatike. Është realizuar mirëmbajtje 3-vjeçare pajisje Informatike për 5 paisje multifunkionale(Fotokopje)

P1.F1.O2.A20 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Janë siguruar pajisje TIK të reja në shërbim të administratës vendore në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative, si dhe paisje për mediat.kompjuteru 5(copë), paisje Multifunkisonale 7(copë), tableta monitorues 15(copë), Kamera2(copë), paisje regjistrimi Live etj.

P1.F1.O2.A21 Mirëmbajtje 3-vjeçare e faqes zyrtare ëeb ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj

Është ofruar shërbimi për hostimin dhe mirëmbajtjen teknike të faqes zyrtare të internetit dhe moduleve të integruara të saj. Mirëmbajtje përmbajtësore e vazhdueshme e faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër dhe moduleve elektronike të integruara të saj. Azhurnimi i informacioneve bëhet çdo ditë sipas nevojave dhe detyrimeve të publikimeve të bashkisë. Janë integruar platformat inovative për Transparencën e Buxhetit dhe Taksat e Mia në kuadër të bashkëpunimit me Programin për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal dldp. Janë integruar platformat elektronike komunikuese me qytetarët Raporto dhe Forumi Online në kuadër të Programit të Transparencës dhe Ambasadës Amerikane realizuar përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci.

P1.F1.O2.A22 Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App dhe mirëmbajtje

Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App dhe mirëmbajtje, për ofrimin e shërbimeve të Transparenca së Buxhetit, sipas kërkesave teknike të stafit TIK është realizuar mirëmbajtja e shërbimeve, azhurnimi i tyre, upgrade në Mobile App, etj

P1.F1.O2.A23 Detyrime dhe kompensime legale. Janë përmbushur detyrimet për kompensimet legale që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Realizuar detyrimet për vendime gjyqësore si dhe tarifat për njoftime dhe depozitime padie, ankimime dhe rekurse.

P1.F1.O2.A24 Riparim çatia e godinës së Bashkisë. Realizuar mirembajtja e 1520m2

P1.F1.O2.A25 Rikonstruksion kati perdhe, ish Hotel Sporti Shkoder.Rikonstruksion i 256 m2

P1.F1.O2.A26 Blerje automjete në funksion të administratës. Realizuar blerja e dy automjeteve te reja me zero km, në shërbim të administratës vendore.

P1.F1.O2.A30 Sistemi i Vëzhgimit i 15 Njësive Administrative me Bashkinë Qendër.Procedura e anuluar pas ankimimit ne KPP,dhe do te rishpallet pasi eshte pasqyruar ne regjistrin e prokurimeve te vitit 2019

P1.F1.O2.A32 Sistem Regjistrimi Video Full HD për Sallën e Këshillit të Bashkisë

Janë blerë paisje si kamera mikrofona për regjistrimin dhe transmetimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

P1.F1.O2.A33 Upgrade-im dhe mirëmbajtje për ofrimin e shërbimeve administrative përmes SiZ1N dhe taksave e tarifave vendore SiTTV permes faqes zyrtare ëebtë Bashkisë Shkodër dhe portalit e-Albania

Ofrimi i shërbimeve administrative me SiZ1N dhe i tarifave dhe taksave vendore me SiTTV përmes portalit zyrtar të internetit të Bashkisë Shkodër, portalit e-Albania si dhe të aksesueshëm përmes disa kanalesh, pajisjesh dhe formash të komunikimit elektronik

P1.F1.O2.A35 Upgrade-im i funksionaliteteve dhe mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale Menaxhim elektronik i bazës së të dhënave të shtresave në nevojë përmes një sistemi informacioni për shërbimet sociale (Realizuar)

P1.F1.O2.A36 Ndërtimi i Bazës së të Dhënave të Monitorimit të Shërbimit të Pastrimit

Menaxhim elektronik i bazës së të dhënave të shtresave në nevojë përmes një sistemi informacioni për monitorimin e shërbimit të pastrimit

P1.F1.O2.A40 Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative). Janë realizuar kryerja e pagesave dhe shpenzimeve për paga, sigurime,shpenzime operative sipas parashikimeve të funksioneve të deleguara për punonjësit e QKB dhe Gjendjes Civile

P1.F1.O3.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepletqë). U sigurua mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore. Është realizuar shpërblimi mujor ne menyre sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryepletqë e njësive administrative.

P1.F1.O3.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë Realizuar pagesa e kuotes se anetaresise ne shoqaten e Bashkive te Shqiperise konform marreveshjes

P1.F1.O3.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut. Realizuar transferimi dhe permbushja e detyrimit ne baze te ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore

Sektori Juridik

Gjatë këtij viti kalendarik ka siguruar dhënien e konsulences së nevojshme ligjore për të gjitha drejtorite dhe institucionet.

Ka perfaqësuar bashkinë Shkoder në proceset gjyqësore civile, administrative dhe penale, ku ajo ka qënë pale në proces,

Përfaqësuese e bashkisë shkoder referuar nenit 96 të Kr.P.Civile në procese gjyqësore për **237** raste civile/administrative me objekte gjykimi të ndryshem, konkretisht :

<i>Proçese në vijim në Gjykatën e shk.I, sh.II – të.</i>	<i>Proçese në vijim në Gjykatën e Lartë</i>	<i>Proçese të pushuara</i>	<i>Proçese të formës së prerë</i>
<i>148</i>	<i>10</i>	<i>26</i>	<i>53</i>

Ka marre pjese në disa komisione,

Ka hartuar urdhera të brendshem, urdheresave, projekt vendimeve, vendime, akt-marreveshjeve.

Ka ofruar asistencen juridike anëtare në grupin e punës në bashkëpunim me drejtorite e tjera për hartimin e rregulloreve të brendshme për funksionimin e tyre.

Ka hartuar projekt-vendime, referuar dispozitave ligjore në fuqi, mbështetur në relacionet përkatëse të drejtorive, për tu kaluar për miratim në Keshillin Bashkiak.

Ka qënë pjesëmarrëse në komisionin e vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik anetare në 3 (tre) komisione të shpronësimeve për interesin publik,

anetare në 60 (gjashtë dhjetë) raste në komisionet e privatizimit të banesave shtetërore,

dorezimi i dosjeve në 199 raste të komisionit për kalimin e pronësive mbi pasuritë që nuk kanë akt fitimi të pronësive sipas VKM nr.698 dt.05.09.201. Referuar VKM .442 dt.18.07.2018 kjo kompetence ka kaluar për trajtim ALUZNIT, bashkia Shkoder ka bërë transferimin e dosjeve pranë këtij institucion.

Ka hartuar vertetime të ardhurash ekonomike sipas kërkesave të bëra nga studentet që studiojnë jashtë shtetit.

Ka bashkërenduar punën me drejtoritë përkatëse (drejtorinë e të ardhurave, drejtorinë e financës etj..) për hartimin e kërkesave padive, në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH, Mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të Kontrollit të lartë të Shtetit, me nr.491/5 dt.30.11.2017.

II - Sektori Aseteve Gjatë këtij viti kalendarik ka ushtruar aktivitetin e tij, konkretisht:

1.Proçesin e regjistrimit të pronave të transferuara me VKM-në nr. 421, datë 2.6.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” pranë ZVRPP Shkodër.

Në ZVRPP Shkodër në zbatim të VKM-së së sipërcituar janë në proces regjistrimi në total 74 prona.

2.Në zbatim të VKM-së nr. 366, datë 13.5.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të Sherbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe për disa Ndryshime në Vendimin Nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Listës së Inventarit të pronave të Paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë

së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe nënprefektet, administratën e tyre, për drejtorinë e përgjithshme civile, (Drejtorinë e PMNZSH-së), të ndryshuar është dërguar për regjistrim pronave e transferuar në pronësi dhe është në proces regjistrimi.

3. Identifikimin dhe inventarizimin e pronave të NJA-ve, kjo në zbatim të ligjit 8744, datë 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001 dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

Në NJA Ana e Malit me VKM Nr 52, datë 16.1.2013 është e miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ana e Malit, të Qarkut të Shkodrës.

Për pronat me fushë përdorimi arsim janë përgatitur planimetri dhe plan rievime për të gjitha pronat me fushë përdorimi arsim, shendetësi duke plotësuar dhe të dhënat kadastrale në ato raste ku ato kanë munguar.

Në NJA Bërdicë me VKM Nr 859, datë 10.11.2010 është e miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës.

Është punuar në plotësimin e të dhënave kadastrale, janë identifikuar prona që nuk janë të përfshira në inventar, si shkolla e vjetër tek shkolla Agim Tafili, dhe Qendrat shendetësore Bërdicë e mesme, Qendra shendetësore Beltoje dhe Qendra shendetësore Mali Hebaj.

Janë përgatitur planimetri dhe plan vendosje për objektet me fushë përdorimi shendetësi, Ambulanca Bërdicë e Sipërme, Ambulanca Bërdicë e Mesme, Qëndër shendetësore Bërdicë e Madhe, Ambulanca Beltojë, Qëndër Shendetësore Trush, Ambulanca Mali Hebaj.

Në NJA Dajç, me VKM Nr 944, datë 17.11.2010 kemi të miratuar listen përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dajç, të Qarkut të Shkodrës.

Në NJA Dajç janë të regjistruara 23 prona

Në NJA Gur i Zi me VKM nr. 1088, datë 23.7.2008 kemi të miratuar listen përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gur i Zi, të Qarkut të Shkodrës.

Janë të regjistruara 107 prona.

Janë dërguar për regjistrim 8 objekte me fushë përdorimi Arsim

Janë përgatitur planimetri dhe plan rievime për objektet me fushë përdorimi shendetësi

Në NJA Postribë me VKM nr. 477, datë 29.6.2011 kemi të miratuar listen përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Postribë, të Qarkut të Shkodrës.

Është punuar në plotësimin e të dhënave kadastrale.

Janë përgatitur planimetri dhe plan rievime për objektet me fushë përdorimi arsi, shendetësi dhe shërbime publike.

Në inventarin e pronave të NJA Postribë trashëgojmë prona (ndertesa + truall), me fushë përdorimi zhvillim ekonomik, pa të dhëna kadastrale me shënimin të zëna forcërisht për të cilët po punohet për identifikimin e tyre, dhe pastaj për të vazhduar procedurat sipas dispozitave ligjore.

Në NJA Rrethina nuk ka të miratuar liste të pronave të paluajtshme publike, shtetërore me VKM.

Kemi listë të pronave të paluajtshme publike të miratuar me Vendim Nr. 6, datë 02.02.2011 të këshillit të Komunës, me mangësi e cila duhet të përsëritet.

Nga na e sektorit të aseteve janë përgatitur planimetri dhe plan rlevime për pronat me fushë përdorimi arsim dhe shendetësi.

Në NJA Velipojë nuk ka të miratuar liste të pronave të paluajtshme publike, shtetërore me VKM.

Sistemimi i pronave “Shkolla Dëshmoret e Prishtinës”, “Monumenti Prek Cali”.

Është ndjekë pranë ZVRPP Shkodër zbatimi I VKM-së nr. Nr. 623, datë 24.9.2014 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve” Ali Spahija”, “Nexhip Luli”, “Bujar Bishanaku”, “Stacioni I Trenit” “Rruga e Kalasë”, si dhe Sistemimi i bllokut të pallateve, “Qafë _Hardhi”, të Bashkisë së Shkodrës, duke dërguar në ZVRPP Shkodër dokumentacioni për rregjistrimin e këtyre pronave në favor të Bashkisë Shkodër, për të bërë të mundur vazhdimin e mëtejshëm të procedurave te mbetura.

2. Janë në proces 2 procedura si dhe shpronësimi për interes publik të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Bujar Bishanaku” për familjen Sejhan Baja, Familjen Nexhmedin Baja.

Dërguar për rregjistrim me shkresen nr. 5682 prot, datë 14.10.2014, duke kryer detyrimet ndaj ZVRPP Shkodër me faturen për arkëtim nr. 9130, datë 31.10.2014.

në procedurë për regjistrim është dërguar edhe shpronësimi për interes public të pronarëve të pasurive pronë private që preken nga rikonstruksioni I rrugës “Nexhip Luli” për familjen e Z. Hilmi Bashi, i papërfunduar nga ana e ZVRPP Shkodër dërguar me shkresen nr. 6614 prot, datë 27.11.2014 i jemi drejtuar ZVRPP Shkodër për vazhdimin e rregjistrimit.

Me shkresen nr. 14813 Prot, datë 11.4.2016 “Ridërgim dokumente për regjistrim” kemi përcjell në ZVRPP Shkodër Çertifikaten për vertetim pronësie me pronar Ilmi Bashi për pasurinë që preket nga shpronësimi për efekt investimi të “Rikonstruksionit të rrugës “Nexhip Luli”

Me shkresen nr. 1196 prot, datë 27.01.2017 “Ridërgim dokumente për regjistrim” kemi dërguar në ZVRPP Shkodër. Çertifikaten për vertetim pronësie origjinale për pronen me nr. 3/642 regjistruar në vol 25, faqe 94 me sipërfaqe totale 680 m² nga kjo truall 680 m² me pronar Ilmi Bashi , data e lëshimit të çertifikatës 13.05.2015, faturen për arkëtim nr. 9130, datë 19.11.2014.

Ridërguar për regjistrim me shkresen nr. 8132 prot, datë 31.5.2017 dhe nr. 8133 prot, datë 31.5.2017 dhe shkresen nr. 17082 prot, datë 14.11.2017 duke kryer të gjitha detyrimet ndaj ZVRPP Shkodër.

4.Në zbatim të VKM nr. 362, datë 20.06.2018“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “ Rikonstruksion i bllokut të pallateve në Xhabije”, Bashkia Shkodër”, është hedhur gjurma e projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar.

Është dërguar dokumentacioni për kalimin e pronësisë në favor të bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuara.

Janë regjistruar të gjitha pronat që preken nga shpronësimi në favor të bashkisë Shkodër.

Është përgatitur gjurma e Auditit për drejtorinë e financës dhe janë likuiduar të gjithë pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga shpronësimi I sipërcituar.

5.Në zbatim të Vendimit Nr. 474, datë 31.7.2013 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi I projektit “Ndërtimi i varrezave të reja”,

Bashkia Shkodër, me shkresen nr. 1677 prot, datë 3.10.2018 kemi dërguar gjurmen e projektit në hartën kadastrale sipas planim, etrisë së shpronësimit të miratuar.

Pronarët e pasurive që preken nga shpronësimi nuk kanë paraqit dokumentacion , për të bërë te mundur kalimin e pronësisë për –pasuritë e shpronësuara në favor të bashkisë Shkodër.

6.Në zbatim të Urdhërit të brendshëm nr. 676, datë 22.09.2017 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit paraprak të pasurisë pronë private që shpronësohet për efekt investimi publik për objektin “Rikonstruksion i rrugës Shkodër- Velipojë (segmenti harku i Berdicës- Baks)” dhe Urdhërit të brendshëm nr. 70, datë 22.1.2018 “Për një shtesë të urdhërit të brendshëm nr. 676, dt 22.08.2017 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit paraprak të pasurisë pronë private që shpronësohet për efekt investimi publik për objektin“Rikonstruksion i rrugës Shkodër- Velipojë(segmenti harku i Berdicës- Baks), Urdhërit të brendshëm nr.7525, datë 17.5.2018 “Për një shtesë të urdhërit të brendshëm nr. 676, dt 22.08.2017 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit paraprak të pasurisë pronë private që shpronësohet për efekt investimi publik për objektin“Rikonstruksion i rrugës Shkodër- Velipojë(segmenti harku i Berdicës- Baks), Urdhërit të brendshëm nr. 70, datë 22.1.2018, kemi hedhur gjurmen e projektit në hartën digjitale të ZVRPP Shkodër, duke përcaktuar sipërfaqen për çdo pasuri që preket nga rikonstruksioni i rrugës.

Kemi marrë informacionin nga ZVRPP Për pronarët pasurive pronë private që preken nga rikonstruksioni i rrugës.

Është përgatitur pasqyra paraprake e pasurive që preken nga rikonstruksioni i rrugës Shkodër – Velipojë(segmenti Harku I Bërdicës Baks), e cila përfshin në total 84 pasuri me sipërfaqe të përgjithme 63 207m²

7.Në kuadër të studimit të Bankës Botërore “Mbështetje për Zhvillimin e Mekanizmit të Financimit për zbatimin e Masave të Eficencës së Energjisë në ndërtesat Publike në Shqipëri” është përgatitur Inventari I ndërtesave publike për ndërtesat që janë në pronësi të Bashkisë Shkodër me modelin e bazës së të dhënave të dërguar nga ana e konsulentëve të Bankës Botërore.

8.Në kuadër të menaxhimit të Aseteve vendore, brenda kompetencave të caktuara kemi monitoruar kontratat e qerese të cilat bashkia ka me të trete.

9.Ndjekja me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të administruar dokumentacionin e kontratave Emfitioze të kontratës nr. 650 rep, nr.133 Kol, datë 24 Mars 2000 me objekt dhënien me qira të objektit “Kinema Millenium”, Shkodër pronë e Bashkisë lidhur ndërmjet ish- Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë “IDA” sh.a dhe Kontratës së qirasë Rep 2950 Nr., Kol 475 Nr., datë 19.Qershor 2000, për objektin “Shkolla M. Bujqësore” pronë e Bashkisë Shkodër.

9.Përditësimi i regjistrit të asetëve bazuar ne udhezimin 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” për të gjitha Njësitë e Bashkisë Shkodër.

1. Policia Bashkiake

Për periudhën 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2018, Policia Bashkiake e ka fokusuar veprimtarinë bazuar në detyrat dhe kompetencat e përcaktuara nga ligji për Policinë Bashkiake.Kryesisht kundravajtjet administrative kanë qënë në qëndër të vëmendjes, ku policia bashkiake nëpërmjet grupeve të organizuara në terren ka administruar të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke këshilluar qytetarët

për ndjekjen e rregullave të paracaktuara si dhe dënimin me gjobe për kundravajtësit. Janë kontrolluar tregjet informale, duke bërë të mundur pastrimin e trotuareve nga tregtarët ambulants dhe lirimin e hapsirave publike në zonat kryesore të qytetit, kryesisht në 5 rajonet e qytetit duke prekur kryesisht zonat problematike të qytetit.

Me hapjen e sezonit turistik në zbatim të akteve nënligjore të dala nga institucionet shtetërore janë marrë masat e nevojshme për rritjen e parametrave të sigurisë me qëllim evidentimin, përballimin e situatës që lidhet me zonën e Velipojës duke pasur parasysh fluksin e madh të pushuesve. Gjate këtij sezoni janë ushtruar kontrolle për parandalimin e mos cenimit të hapsirave publike, duke marrë masa administrative ndaj subjekteve private që kanë ushtruar aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2018 janë marrë masa për shkelje administrative në 1606 raste me vlerë të përgjithshme 2.579.000 lek, ku sipas rakordimeve me Drejtorinë e të Ardhurave është arketuar vlera **1,027,000** leke, shifër në rritje progresive për shkak se bankat marrin kohën e nevojshme për raportimin e arketimeve në vazhdimsi. Kryesisht këto shkelje administrative janë të kryera në kundërshtim me kodin rrugor, shkelje për shfrytëzimin e hapsirave publike nga tregtarët ambulants në kundërshtim me përcaktimet ligjore për ushtrimin e aktivitetit nga ana e tyre, subjekte tregtare që nuk respektojnë detyrimet ligjore etj.

Një punë e konsiderueshme është bërë për pastrimin e hapsirave publike, kryesisht trotuareve në Rajonin nr.3 nga Rusi tek Prek Cali dhe trotuarët përpara Spitalit Rajonal Shkoder ku si rezultat i punës së vazhdueshme është arritur të sistemohen njesitë tregtare, lokale dhe dyqane të cilat aktualisht ushtrojnë aktivitetin pa cenuar hapsirën publike, ambulancat dhe trotuarët të behen të shfrytëzueshme për kalim të lirshëm nga qytetarët, janë shmugur të gjitha rastet e trigtimit në rrugë etj.

Ka patur mbikqyrje të vazhdueshme të qendrës së qytetit, pedonale dhe zonës me impakt turistik kryesisht në qytetin e Shkodrës ku vazhdon nxjerrja e patrullave të policisë Bashkiake edhe në periudhën pas orës 16.00 ku prezencë ka qenë me dy patrulla në kembë. Për periudhën e analizuar prezencë e policisë bashkiake në qytet në funksion të zbatimit të detyrave funksionale ka qenë edhe në rastet e ditëve të pushimit apo rastet e festave .

Është punuar për marrjen e masave për shmangien e rasteve të pushimit të mjeteve në trotuare apo në rrugë e vende të ndaluara duke shmangur pengesat për levizjen e kembesoreve apo shkaqet që çojnë në përkeqësimin e trafikut në qytet.

Njësia e prokurimit publik

Proçesi i prokurimit në Bashkinë Shkoder për vitin 2019, është realizuar në përputhje me Urdhërin e brendshëm ku janë përcaktuar procedurat e prokurimit për vitin 2019.

Gjate periudhës 01.01.2018-31.12.2018 Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata ose ka shpallur fitues në rastin e procedurave të prokurimit Blerje me vlerë të Vogel në total për 202 procedura prokurimi nga të cilat 113 procedura prokurimi Blerje me Vlerë të Vogel, 63 procedura prokurimi Kerkese për propozim, 16 procedura prokurimi Procedure e Hapur, 7 procedura prokurimi Sherbim Konsulencë 1 procedure prokurimi Negocim Pa Botim Paraparak të Njoftimit të Kontrates) dhe 1 procedure amendament kontrate. Fondi limit në total në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit pa përjashtim ka qenë 680 230 814 leke pa tvsh nga të cilat 59 114 566 lekë pa tvsh financuar nga Buxheti i Shtetit. Vlera totale e prokuruar për këtë periudhë duke përfshirë të gjitha llojet e procedurave të prokurimit është 577 071 002 leke pa tvsh.

Fondi limit per procedurat e prokurimit Blerje me Vlere te Vogel ka qene 26 040 715 leke pa tvsh ndersa vlera e prokuruar e tyre eshte 20 542 897.02 leke pa tvsh.

Fondi limit per procedurat e prokurimit mbi 800 000 leke ka qene 670 900 932 leke pa tvsh ndersa vlera e prokuruar e tyre 556 528 105 leke pa tvsh.

Nga 63 procedurat e prokurimit mbi 800 000 leke pa tvsh 24 procedura prokurimi jane mallra, 37 procedura prokurimi jane pune publike, 19 procedura prokurimi jane sherbime, 7 procedura prokurimi jane sherbime konsulence.

10 procedura prokurimi mbi 800 000 leke pa tvsh jane zhvilluar si organ i deleguar dhe 4 procedura prokurimi jane zhvilluar si organ qendror bleres, 1 procedure prokurimi eshte zhvilluar e ndare ne lote.

6 procedura prokurimi jane mbartur nga viti 2017 ndersa 15 procedura prokurimi me vlere mbi 800 000 leke vazhdojne ne vitin 2019. 33 procedura prokurimi mbi 800 000 leke jane anuluar dhe jane rishpallur. Ne 15 procedura prokurimi te zhvilluara nga Bashkia Shkoder jane ankimuar nga ofertues te ndryshem nder te cilat kater jane percjellur prane KPP.

Të gjitha kontratat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Shkodër. Në asnje rast nuk ka patur anulim kontrate.

Problematikat kryesore gjatë zbatimit të kontratave janë janë hasur në kontratat e punëve publike, ku ka patur shtyrje të fillimit të punimeve për shkak të problemeve për lirim të sheshtit të ndërtimit nga ndërtimet pa leje ose si në një rast për vonesa të procesit të shpronësimit. Gjithashtu ka patur raste të shtyerjes së afatit të përfundimit të punimeve për problematika të ndryshme.

Fondet e financimit të programeve

- Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 35 dt 22.05.2018 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017 dhe të rishpërndarjes së fondeve të trashëguara të Bashkisë Shkodër” është bërë rishpërndarja e fondeve të trashëguara si më poshtë:

Shtesë : Projekti P1.F1.O1.A1 “Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve”, në vlerën 150 mijë lekë

Shtesë : P1.F1.O1.A4 “Aktivitete social -kulturore për stafin administrativ të Bashkisë Shkodër”, në vlerën 668.25 mijë lekë

Shtesë : P1.F1.O2.A7 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë ” ,në vlerën 700 mijë lekë

Shtesë : P1.F1.O2.A24 Riparim çatia godina e bashkisë ” në vlerën 3,942.025 mijë lekë

Është miratuar rialokimi i fondeve brenda programit si më poshtë:

Me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr.227, datë 22.10.2018 është bërë:

Pakësim prej 1,969.046 mijë lekë nga shpenzim operative tek **P1.F1.O2.A2 “Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës”**

Pakësim prej 104.985 mijë lekë nga shpenzim operative tek **P1.F1.O2.A5 “Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës”**

Pakësim prej 400 mijë lekë nga shpenzim operative tek **P1.F1.O2.A14 “Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës”**

Shtesë prej 2,074.031 mijë lekësh tek P1.F1.O2.A1 “Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës” A2.2 “Furnizim me energji elektrike i Bashkisë dhe njesive administrative

Shtesë prej 400 mijë lekësh tek P1.F1.O2.A1 “Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës” A2.3 Shërbime postare

Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2018 per programin e administratës vendore janë:

Fondi për « Paga dhe Sigurime shoqërore » u realizua në vlerën prej **214,860 mijë lekë**, nga totali 218,750 mijë lekë plani i korigjuar për vitin 2018 .Realizimi 98.2%

Shpenzime Operative janë realizuar në vlerën **49,226 mijë lekë**, nga 55,661 lekë plani i korigjuar 2018. Realizimi është 88.4 %.

Transferta janë realizuar në vlerën **16,545 mijë lekë**, nga 16,723 mijë lekë plani i korigjuar 2018. Realizimi është 92.3 %.

Investime janë realizuar në vlerën **24,376 mijë lekë**, nga 26,824 mijë lekë plani i korigjuar 2018 Realizimi 90.8 %.

Aktivitete/Projekte	Buxheti 2018 në mijë lekë	Plani Korrigjuar	Realizim 12-mujori 2018
P1.F1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	205,096	205,172	201,478
P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	150	300	260
P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	200	200	-
P1.F1.O1.A4 Aktivitet social -kulturor për stafin administrativ të Bashkisë Shkoder	-	668	660
P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	6,810	9,284	7,680
P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për	9,500	7,531	7,145

Administratën e Bashkisë së Shkodrës				
P1.F1.O2.A3	Shërbim higjeno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	300	300	223
P1.F1.O2.A4	Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj)	1,000	1,000	813
P1.F1.O2.A5	Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës	4,610	4,505	4,317
P1.F1.O2.A6	Organizimi i pritjeve të perfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja .	1,400	1,400	1,280
P1.F1.O2.A7	Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë	300	1,000	948
P1.F1.O2.A8	Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	800	800	800
P1.F1.O2.A9	Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës.	800	800	790
P1.F1.O2.A10	Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	700	700	518
P1.F1.O2.A12	Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	500	500	408
P1.F1.O2.A13	Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër	2,500	2,500	297
P1.F1.O2.A14	Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	2,100	1,700	1,176
P1.F1.O2.A15	Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N -Smart Processes Enterprise)	710	710	709
P1.F1.O2.A16	Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër	76	77	-
P1.F1.O2.A17	Mirëmbajtje 3-vjeçare e Sistemit të Integruar të Tarifave dhe Taksave Vendore (SiTTV)	550	550	544
P1 F1 O2 A18	Upgrade-im i SiTTV (Sistemi i Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore) në Mobile App dhe mirëmbajtje,për ofrimin e shërbimeve të taksave dhe tarifave vendore përmes smartphone ndaj biznese dhe qytetarëve	-	-	-
P1.F1.O2.A19	Mirëmbajtje 3-vjeçare Pajisje Informatike	306	306	270
P1.F1.O2.A 20	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	5,000	5,000	4,873
P1.F1.O2.A21	Mirëmbajtje 3-vjeçare e faqes zyrtare ëeb	300	300	288

ëëë.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj			
P1.F1.O2.A22 Upgrade-im i platformës Transparenca e Buxhetit në Mobile App dhe mirëmbajtje	980	980	980
P1.F1.O2.A23 Detyrime dhe kompensime legale	-	-	-
P1.F1.O2.A24 Riparim çatia godina e bashkisë	-	3,942	3,528
P1.F1.O2.A25 Rikonstruksion kati perdhe, ish Hotel Sporti Shkoder	5,744	5,744	3,529
	4,000	4,000	3,906
P1.F1.O2.A26 Blerje automjete në funksion të administratës	-	-	-
P1.F1.O2.A27 Blerje vegla pune	-	-	-
P1.F1.O2.A29 Implementimi i dokumentacionit të integruar i qendëruar për të gjithë Bashkinë Shkodër në platformën Microsoft 365, Azure Active Directory dhe Mail Server bazuar në Cloud.	-	-	-
P1.F1.O2.A30 Sistemi i Vëzhgimit i 15 Njësive Administrative me Bashkinë Qendër	3,000	3,000	2,997
P1.F1.O2.A31 Sistemi i Akses Kontrollit i 15 NjesiveAdministrative me Bashkinë Qendër	-	-	-
P1.F1.O2.A32 Sistem Regjistrimi Video Full HD për Sallën e Këshillit të Bashkisë	800	800	799
P1.F1.O2.A33 Upgrade-im dhe mirëmbajtje për ofrimin e shërbimeve administrative përmes SiZ1N dhe taksave e tarifave vendore SiTTV permes faqes zyrtare ëëb të Bashkisë Shkodër dhe portalit e-Albania	5,000	5,000	4,992
P1.F1.O2.A34 Upgrade-im i SiZ1N (Sistemi i Integruar të Zyrave me Një Ndalesë) në Mobile App dhe mirëmbajtje, për ofrimin e shërbimeve administrative smartphone ndaj qytetarëve	-	-	-
P1.F1.O2.A35 Upgrade-im i funksionaliteteve dhe mirëmbajtje e Sistemit të Informacionit të Shërbimeve Sociale	1,500	1,500	1,500
P1.F1.O2.A36 Ndërtimi i Bazës së të Dhënave të Monitorimit të Shërbimit të Pastrimit	675	675	660
P1.F1.O2.A37 Implementimi i Kioskave Informative në territorin e Bashkië Shkodër dhe integrimi me platformat inovative të saj në funksion të qytetarëve, bizneseve, vizitorëve, etj.	-	-	-
P1.F1.O2.A38 Sistem Informacioni GIS i tëdhenave vendore dhe i integruar me sistemet e tjera tëinformacionit si SiZ1N, SiTTV, Sistemin e Informacionit të Shërbimeve Sociale, etj...	-	-	-
P1.F1.O2.A39 Sistem i perkthimit simultan në Sallën e Këshillit të Bashkisë	-	-	-
P1.F1.O2.A40 Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative) & shpenzimet per	18,234	19,861	19,488

zgjehjet

P1.F1.O3.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepletë)	16,653	16,653	16,653
P1.F1.O3.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë	500	500	500
P1.F1.O3.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut	10,000	10,000	10,000
TOTALI	310,794	317,961	305,010

P2 Planifikimi urban

Shkodra është porta hyrëse e korridorit Veri-Jug (të transportit rrugor), që lidh Shqipërinë me zonën e rjetit të ardhshëm të korridoreve dhe lidhjeve të tyre të transportit rrugor për Europën Juglindore, ku përfshihen: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, etj. Territori i ri administrativ i Bashkisë së Shkodrës përmban potenciale të shumta zhvëllimore për shfrytëzimin e kësaj larmie në funksion të mirëqënies së qytetarit.

Programi i menaxhimit të territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me të gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore. Zhvillimi dhe menaxhimi territorial i Bashkisë Shkodër do të bazohet mbi parimet e bashkëpunimit ndërvendor dhe ndërkufitar për të siguruar rolin kyç që do të ketë bashkia në zhvillimin rajonal, si dhe në parimin e integritimit territorial të brendshëm, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të të gjithë territorit të administruar nga Bashkia e Shkodrës në kontekstin e zhvillimit ekonomik, mobilitetit, burimeve natyrore, duke ju përgjigjur dinamikave zhvëllimore demografike.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi:

F1. Planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.

F1.O2. Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit.

F1.O3. Hartimi i projekteve sipas prioriteteve të përcaktuara në planet e investimeve kapitale të Bashkisë Shkodër.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.

Me miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, është parashikuar të përgatiten Plane të Detajuara Vendore për zonat e parashikuara sipas PPV.

F1.O1.A2. Publikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor Përfundimtar nëpërmjet publikimit elektronik

dhe mjeteve tradicionale të informimit.

Gjatë vitit 2017 ka përfunduar hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër në përputhje me instrumentat e planifikimit. PPV është miratuar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, Prefekti i Qarkut Shkoder si dhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit. VKB Nr.19 date 24.03.2017 "Per miratimin e strategjise se zhvillimit te territorit dhe projekteve strategjike te zhvillimit te Bashkise Shkoder", Miratimi i Prefektit te Qarkut Shkoder date 06.04.2017 ne lidhje me VKB Nr.19. VKB Nr.27 date 20.04.2017 "Per miratimin e planit te zhvillimit te territorit dhe rregulloren e zbatimit te planit te pergjithshem vendor te Bashkise Shkoder", Miratimi i Prefektit te Qarkut Shkoder date 05.05.2017 ne lidhje me VKB Nr.27. Vendimi nr.5 datë 16.10.2017 i KKT "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër".Me shkresën nr. 766/3 prot. Datë 03.05.2018 të Agjencise së Zhvillimit të Territorit, e administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr. 1505 prot. Datë 30.01.2019,është dërguar/zbardhur vendimi nr.5 datë 16.10.2017 i KKT.

F1.02.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër.

Për qytetin dhe njësitë e përmendura, është realizuar azhurnimi i objekteve të reja të ndërtuara në vitet e fundit.Bashkia Shkodër aktualisht po përditëson sistemin hartografik elektronik të informacionit bazuar mbi verifikimin në territor.

Është realizuar projekt-zbatimi nga drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit te Investimeve.

Fondet e financimit të programeve

Plani i rishikuar së bashku më të ardhurat për këtë program për vitin 2018 është 11,485 mijë lekë.

Realizimi për periudhën 12-mujore është 5,396 mijë lekë në këtë program në masën 47 %.

Fondet për investime (projekte), sipas planit 2018 janë:

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për periudhën janar - dhjetor 2018, sipas projekteve kryesore paraqitet:

- 1) Projektim Rikonstruksion rruga "Ludertune"me shumën prej 598,000 lekë, është realizuar në masën 506,400 lekë.
- 2) Projektim Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"me shumën prej 101,000 lekë, është realizuar në masën 99,600 lekë.
- 3) Projektim degezime rruga e Shirokesme shumën prej 1,248,000 lekë, është realizuar në masën 1,200,000 lekë.
- 4) Projektim Rikualifikim Urban i Hyrjes se Qytetit te Shkodres dhe Parkut per Pushuesitme shumën prej 1,122,000 lekë, është realizuar në masën 1,020,000 lekë.
- 5) Projektim Rikonstruksion i rruges se Malesoreve te Mulliritme shumën prej 331,000 lekë, është realizuar në masën 288,000 lekë.
- 6) Projektim Rikonstruksion i rruges se Shirqitme shumën prej 663,000 lekë, është realizuar në masën 564,000 lekë.
- 7) Projektim Ndertim trotuari dhe Sistemim kanali Gomsiqeme shumën prej 422,000 lekë, është realizuar në masën 372,000 lekë.
- 8) Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe me shumën prej 637,000 lekë, është realizuar në masën 276,000 lekë.

- 9) Studime dhe projektme ne bashkefinansim me Fondin e Zhvillimit te Rajoneve (FZHR), në bazë të marrëveshjes ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Shkodër është bërë likuidimi i 1,069,720 lekëve për realizimin e projektit “Rikualifikimi i bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës”

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktiviteti/Projekte	Plani i korigjuar në mijë lekë	Realizimi në mijë lekë
P2.F1.O1.A1 Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.	4,250	-
P2.F1.O1.A2 Publikimi i Planit të përgjithshëm Vendor Përfundimtar nepermjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit	-	-
P2.F1.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër	-	-
P2.F1.O3.A9.Projektim Rikonstruksion rruga "Ludertune"	598	506.4
P2.F1.O3.A10.Projektim Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"	101	99.6
P2.F1.O3.A11.Projektim degezime rruga e Shirokes	1,248	1,200
P2.F1.O3.A13.Studime dhe projektme ne bashkefinansim me Fondin e Zhvillimit te Rajoneve (FZHR)	1,750	1,069.72
P2.F1.O3.A17. Projektim Rikualifikim Urban I Hyrjes se Qytetit te Shkodres dhe Parkut per Pushuesit	1,122	1,020
P2.F1.O3.A25. Projektim Rikonstruksion i rruges se Malesoreve te Mullirit	331	288
P2.F1.O3.A26. Projektim Rikonstruksion i rruges se Shirqit	663	564
P2.F1.O3.A27. Projektim Ndertim trotuari dhe Sistemim kanali Gomsiqe	422	372
P2.F1.O3.A28. Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe	637	276
P2.F1.O3.A30 Projektim Sistemim asfaltim I rruges Oblike-Lagja e re	339	-
Renta minerale	24	-
TOTAL	11,461	5,396

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12 mujorin 2018

Projektim Sistemim asfaltim i rruges Oblike-Lagja e re, është realizuar nga Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimt të Investimeve.

Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV. Nuk është realizuar për faktin sepse PPV është zbardhur nga AZHT me datë 03.05.2018 dhe ky konfirmim në anë zyrtare ka ardhur në Bashkinë Shkodër me datë 30.01.2019.

P3 Infrastruktura Rrugore

Shkodra është porta hyrëse e korridorit Veri-Jug (të transportit rrugor), që lidh Shqipërinë me zonën e rrjetit të ardhshëm të korridoreve dhe lidhjeve të tyre të transportit rrugor për Europën Juglindore, ku përfshihen: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, etj.

Krijimi i territorit të ri administrativ të bashkisë – shumë – qendërsh duke përfshirë qytetin e Shkodrës dhe fshatrat e 10 njësive administrative të tjera në programin e infrastruktures rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike të tij.

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore:

Përmirësimin e mjedisit urban me standartet e duhura në shërbim të komunitetit

Rritjen e cilësisë dhe sigurisë së jetës së banorëve.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi:

F1. Ndërtimi, rehabilitimidhemirëmbajtja e rrugëvevendore, trotuarevedhesheshevepublikevendore;

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve

F1.O2. Rikonstruksion rruge dhe sheshe urbane

F1.O3. Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës nëntokësore

F1.O4. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në qytet ka vazhduar sipas kontratës themelore 5-vjeçare, datë 11.06.2014, me sipërmarrje private. Përfundimi i fazës së dytë të kësaj kontrate ka shënuar edhe përfundimin tërësor të kësaj kontrate. Në përfundim të fazës parë dhe të fazës dytë janë realizuar këto punime: 1471m² mirëmbajtje e rrugëve dhe shesheve dhe 689m² trotuare.

F1.O1.A2. Riveshje e riparime me asfalt në rrugët kryesore dhe dytesore qytet. Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur kontrata me sipërmarrje private, datë 07.12.2018 me afat 60 ditë kalendarike. Punimet në këto kontratë janë në proces.

F1.O2.A2 Rikonstruksion rruga "Sami Repishti" (Faza II)

F1.O2.A4. Rikonstruksion rruga "Pjeter Spani" faza II

F1.O2.A9. Rikonstruksion Rruga "Bashej"

F1.O2.A10. Rikonstruksion Rruga "Kacelej"

F1.O2.A11. Rikonstruksion Rruga "Drishtej"
 F1.O2.A12. Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"
 F1.O2.A13. Rikonstruksion rruga "Karineve"
 F1.O2.A14. Rikonstruksion rruga "Lugoçesme"
 F1.O2.A15. Rikonstruksion rruga "Lodertune"
 F1.O2.A16. Rikonstruksion rruga "Vllaznimi"
 F1.O2.A20. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe" (tek Vasiejt)
 F1.O2. A21. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Europa" (tek ish Podgorica)
 F1.O2. A22. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare"(Xhabije)
 F1.O2. A23. Rikualifikim Urban blloqe banimi"Qemal Dracini" (tek Sahati)
 F1.O3.A24. Rikualifikim Urban I Hyrjes se Qytetit te Shkodres dhe Parkut per Pushuesit
 F1.O3.A25. Sistemim trotuari dhe gjelberimi rruga "Levizja e Postribes"
 F1.O2. A26. Rikonstruksion i Bllokut te pallateve 'Xhabije'
 F1.O2.A27.Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike

F1.O4.A1. Mirembajtja e rrugeve rurale

F1.O4.A1.1/1 Shërbime riparimi të akseve të rrugëve

Loti-I-rë Shërbime riparimi të shtresave asfaltike në njësitë administrative. Janë realizuar riparime të shtresave të asfaltit në Njësitë Administrative si më poshtë:

Njësia Administrative Postribë	m2 = 304
Nësia Administrative Rrethina	m2 = 1453
Njësia Administrative Guri i Zi	m2 = 309
Njësia Administrative Bërdicë	m2 = 1283
Njësia Administrative Ana e Malit	m2 = 223
Njësia Administrative Dajç	m2 = 528
Njësia Administrative Velipojë	m2 = 300

Gjithsejt janë realizuar 4'400 m2 riparime të shtresave asfaltike si dhe punimet përkatëse që shoqërojnë këtë proces pune mirëmbajtjeje.

Loti-II-të Mirëmbajtje rruga Qaf'thore-Thethe-Ndërlyaj. Janë realizuar pjesërisht punime mirëmbajtje për vitin 2018, ndërsa pjesa tjetër e punimeve do të realizohen në vitin 2019, pas hapjes së rrugës nga bora.

Loti-III-të Mirëmbajtje rruga Prekal-Kir-Mali Shoshit-Breglumi-Nderlyaj. Ky fond është kaluar për mirëmbajtjen e rrugës për periudhën janar - maj/2019 dhe mbajtjen hapur të saj.

Loti-IV-të Mirëmbajtje dhe riparime në rrugën Ura e Mesit-Prekal. Janë realizuar punime largimi të dherave në trupin e rrugës prej 500m3 të cilat kanë rënë nga skarpatat e sipërme të trupit të rrugës si dhe betonime në themelet dhe shpatullat e urës së Resekut të cilat kishin krijuar dëmtime serioze të saj nga vërshimet e lumit Kir.

Loti-V-të Shërbime riparimi Ura auto e Boksit në Plan-Gjuraj. Eshtë bërë riparimi i urës tip Bejli të dëmtuar nga rreshjet dhe amortizimi.

P3.F1.O4.A1.1/2 Blerje baze materiale.



Loti-I-re Blerje materiale inerte prej 1'274m3 (çakull dhe zhavor) për riparimin e rrugëve. Janë realizuar riparime të rrugëve në Njësitë Administrative si më poshtë:

Njësia Administrative Postribë	m3 =160
Njësia Administrative Rrethina	m3 = 220
Njësia Administrative Guri i Zi	m3 = 140
Njësia Administrative Bërdicë	m3 = 120
Njësia Administrative Ana e Malit	m3 = 184
Njësia Administrative Dajç	m3 =160
Njësia Administrative Velipojë	m3 = 140
Njësia Administrative Qytet	m3 = 150

Loti-II+III Blerje baze materiale për riparimin e urave këmbësore dhe vegla pune. Për arsye prokurimi dhe kushteve atmosferike realizimi i kësaj kontrate do të bëhet në muajt në vazhdim të vitit 2019. Janë planifikuar materiale ndërtimi si tuba çeliku, dërrasa, gozhda, litar çeliku, prajmer etj.

P3.F1.O4.A1.1/3 Shpenzime për MjeteTransporti

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për secilin mjet dhe është realizuar pagesa e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

P3.F1.O4.A1.1/4 Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve

Me VKB nr.55, date 19.07.2018 nga Rialokimet është akorduar fondi shtese per "Mirëmbajtje per rastet emergjente" si më poshtë:

Loti-I-rë Shërbime për mirëmbajtje të aksit Qaf'thore -Thethe e cila përfshin orë pune nëvdizpozicion për hapjen e rrugës në raste emergjente.

Loti-II-të Shërbime për mirëmbajtje të aksit Prekal- Kir-Breglumi - Ndërlytaj-Thethe e cila përfshin orë pune në dispozicion për hapjen e rrugës në raste emergjente.

P3.F1.O4.A1.1/5 Blerje bazë material (stabilizant)

Loti-III-të Blerje materiale inerte prej 377m3 (stabilizant) për riparimin e rrugëve dhe shesheve të Bashkisë Shkodër. Janë realizuar riparime të rrugëve dhe shesheve në Qendrën Sociale Perash dhe rruga e fushës së stërvitjes të ekipit të futbollit Vllaznia.

P3.F1.O4.A2/1 Sistemim asfaltim I rruges Oblike-Lagja e re

P3.F1.O4.A2/2 Rikonstruksion rruga Oblike-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Cunit-Kryqezim Lagjja Garuc)

P3.F1.O4.A3. Rikonstruksion i rruges se varrezave Beltoje

P3.F1.O4.A4. Rikonstruksion i rruges se Mushanit - Segmenti I

P3.F1.O4.A5. Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipoje

P3.F1.O4.A6. Sistemim asfaltim rruge "Dod Çarri", Shtoj i Ri

P3.F1.O4.A7. Sitemim asfaltim Rruga qender Mes - Qender Dragoc

P3.F1.O4.A8. Rikonstruksion Rruga "Hidrovorit - Dobraç" Loti 1

P3.F1.O4.A9. Rikonstruksion Rruga e Shirqit

P3.F1.O4.A10. Rikonstruksion i rruges se Malesoreve te Mullirit

P3.F1.O4.A11. Rikonstruksion i rruges Rragam - Sheldi Loti 1

P3.F1.O4.A12. Ndertim trotuari dhe Sistemim kanali Gomsiqe

P3.F1.O4.A13. Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe

Fondet e financimit të programeve

Plani i rishikuar për këtë program për vitin 2018 është 343,341 mijë lekë.

Realizimi për periudhën 12-mujore është 325,680 mijë lekë në këtë program në masën 95 %

Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2018 janë:

Plani i rishikuara për Shpenzime Operative është 37,541 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 33,767 mijë lekë, pra në masën 90 %

Plani i rishikuar për Investime është 305,800 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 291,912 mijë lekë, pra në masën 95 %.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivite/Projekte	Plani Korrigjuar	Realizimi
P3.F1.O1.A1. Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës	5,216	5,216
P3.F1.O2.A2. Riveshje e riparime me asfalt ne rruget kryesore dhe dytesore qytet	12,000	11,382
P2.F1.O2.A1. Investime ne bashkefinansim me Fondin Shqiptar te Zhvillimit (FSHZH) dhe Fondin e Zhvillimit te Rajoneve (FZHR)	5,000	-
P3.F1.O2.A2 Rikonstruksion rruga "Sami Repishti" (Faza II)	595	540
P3.F1.O2.A4. Rikonstruksion rruga "Pjeter Spani" faza II	492	481
P3.F1.O2.A9. Rikonstruksion Rruga "Bashej"	6,823	6,746
P3.F1.O2.A10. Rikonstruksion Rruga "Kacelej"	6,549	6,507
P3.F1.O2.A11. Rikonstruksion Rruga "Drishtej"	3,882	3,881
P3.F1.O2.A12. Rikonstruksion rruga "Rozar Dodmasej"	4,937	4,689
P3.F1.O2.A13. Rikonstruksion rruga "Karineve"	6,055	6,013
P3.F1.O2.A14. Rikonstruksion rruga "Lugoçesme"	20,000	19,605

P3.F1.O2.A15. Rikonstruksion rruga "Lodertune"	12,830	10,064
P3.F1.O2.A16. Rikonstruksion rruga "Vllaznimi"	21,115	20,682
P3.F1.O2.A18. Shpronësime	14,000	14,000
P3.F1.O2.A20. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe" (tek Vasiejt)	4,060	4,060
P3.F1.O2. A21. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Europa" (tek ish Podgorica)	8,183	7,980
P3.F1.O2. A22. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare"(Xhabije)	13,905	13,578
P3.F1.O2. A23. Rikualifikim Urban blloqe banimi"Qemal Dracini" (tek Sahati)	10,000	9,798
P2.F1.O3.A25. Sistemim trotuari dhe gjelberimi rruga "Levizja e Postribes"	1,700	1,664
P3.F1.O2. A25. Rikonstruksion i Bllokut te pallateve 'Xhabije'	19,409	19,407
P3.F1.O2.A27. Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike	12,326	12,326
P3.F1.O4.A1. Mirembajtja e rrugeve rurale	20,325	20,325
P3.F1.O4.A2. Asfaltim vazhdimi i rruges Oblike - Obot	8,747	8,747
P3.F1.O4.A2/1 Sistemim asfaltim I rruges Oblike-Lagja e re	6,829	6,400
P3.F1.O4.A2/2 Rikonstruksion rruga Oblike-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Cunit-Kryqezim Lagjja Garuc)	9,347	9,133
P3.F1.O4.A3. Rikonstruksion i rruges se varrezave Beltoje	2,937	2,856

P3.F1.O4.A4. Rikonstruksion i rruges se Mushanit - Segmenti I	2,745	2,745
P3.F1.O4.A5. Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipoje	4,926	4,890
P3.F1.O4.A6. Sistemim asfaltim rruge "Dod Çarri", Shtoj i Ri	823	823
P3.F1.O4.A7. Sistemim asfaltim Rruga qender Mes - Qender Dragoc	13,171	13,165
P3.F1.O4.A8. Rikonstruksion Rruga "Hidrovorit - Dobraç" Loti 1	7,591	7,584
P3.F1.O4.A9. Rikonstruksion Rruga e Shirqit	8,705	8,560
P3.F1.O4.A10. Rikonstruksion i rruges se Malesoreve te Mullirit	16,337	16,212
P3.F1.O4.A11. Rikonstruksion i rruges Rragam - Sheldi Loti 1	20,347	19,966
P3.F1.O4.A12. Ndertim trotuari dhe Sistemim kanali Gomsiqe	12,619	10,426
P3.F1.O4.A13. Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice eMadhe	18,815	18,386

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12 mujorin 2018

Mosrealizimi në vlerën 100% të buxhetit është për arsye të procedurave të prokurimit, pasi vlera e ofertuesve është më e vogël se ajo e parashikuar.

P4. Shërbimet Publike.

Ofrimi i shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë ka qënë një ndër prioritet kryesore të bashkisë.

Politikat e ndjekura gjatë 2018 janë bazuar në :

Ofrimin e shërbimeve publike cilësore për pëmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjise si dhe zgjerimin e shërbimit.

Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit, monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia mbështet shërbimet publike në këto funksione :

- F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane.
- F2. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbërta publike.
- F3. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pishëm.
- F4. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujrëve të ndotura.
- F5. Mbledhjen dhe largimin e ujrave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.
- F6. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e Varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit.
- F7. Shërbimi i dekorit publik.
- F8. Ndrichimi i mjediseve publike.
- F9. Shërbime publike vendore në Nj. Administrative.

Objektivat për secilin funksion janë:

- F1.01. Rritje e performancës së shërbimit të pastrimit, zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të përfituesve të këtij shërbimi.
- F2.01. Rritja e cilësisë së shërbimit për sipërfaqet e gjelbërta nëpërmjet përmirësimit dhe rikompozimit të sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese si dhe zgjerimi i tyre.
- F3.01. Garantimi i furnizimit me ujë të pishëm të popullatës pa ndërprerje.
- F4.01. Rritja e numrit të lidhjeve të shkarkimeve të ujrave të zeza të popullsisë urbane dhe rurale si dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues.
- F5.01. Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.
- F6.01. Rritja e performancës së shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së Varrezave publike dhe të dëshmorëve. Krijimi i kushteve për një shërbim funeral brenda standarteve.
- F7.01. Realizimi i një dekori urban duke krijuar një atmosfere të gëzueshme për aktivitete dhe festa.
- F8.01. Mbajtja në efijencë e rrjetit të ndrighimit publik si dhe zgjerimi i këtij shërbimi aty ku nuk ekziston në qytet dhe Njësi Administrative .
- F9.01. Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësëve të shërbimeve.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Në zbatim të kontratës themelore 5-vjeçare të Tetor 2013, vazhdon realizimi i shërbimit të pastrimit në qytet me sipërmarrje private. Për rritjen e performancës është përmirësuar sistemi i monitorimit të shërbimit si dhe është arritur që problematikat e krijuara të eliminohen në një kohë më të shpejtë.

F1.O1.A2. Shërbimi i pastrimit në Velipojë dhe Dajç, ka vazhduar sipas kontratës themelore të lidhur me 02.06.2017, kjo me afat deri më 30.09.2018.

Realizimi i kontratës u shoqërua me specifikime të reja teknike, skemë shërbimi më efikase dhe frekuenca më të shpeshta, sistemi i monitorimi më eficient, kjo e gjitha në funksion të një performancë më të mirë shërbimi gjatë sezonit turistik.

F1.O1.A3. Shërbimi i pastrimit në Rrethina, Postrinë dhe Shalë, ka vazhduar sipas kontratës themelore të lidhur me 02.06.2017, kjo me afat deri më 30.09.2018.

F1.O1.A4. Shërbimi i pastrimit në Guri Zi, Bërdicë dhe Ana malit, ka vazhduar sipas kontratës themelore të lidhur me 28.08.2017, kjo me afat deri më 30.09.2018

F1.O1.A5. Realizimi i depozitimit të mbetjeve urbane të të gjithë Bashkisë Shkodër në Landfillin Bushat, duke eliminuar një ndër problematikat më të mëdha, atë të ndotjes mjedisore.

F1.O1.A6. Vazhdimi i shërbimit të Pastrimit për periudhën e ngelur deri në fund të 2018, me firmat sipërmarrëse që e kishin në proces këtë shërbim, sipas kontratave ekzistuese.

F1.O1.A1.7/1. Ndërtimi i xhepave të kazanëve të mbeturinave, për eliminimin e kazanëve nga pikat e rrezikshme të trafikut. Ky shërbim u kry sipas kontratës së lidhur me 30.07.2018, kjo me afat deri me 30.08.2018.

F1.O1.A1.7/2. Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për shërbimin e pastrimit është realizuar blerja e kazanëve të mbledhjes të mbetjeve urbane, me të cilat plotësojmë 85 % të nevojave për të gjithë Bashkinë. Ky shërbim u kry sipas kontratës së lidhur me 27.02.2018, kjo me afat deri me 31.03.2018.

F2.O1.A1. Në zbatim të kontratës themelore 5-vjeçare, Janar 2013 vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta. Shërbimet janë kryer sipas kushteve teknike dhe grafikëve të përcaktuar të shërbimit.

F2.O1.A2. Fillimi i kontratës së re 3-vjeçare të Shërbimit të Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të Gjelberta për të gjithë Bashkinë, me kontrate të lidhur me 28.06.2018.

F3.O1:A1: Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësive administrative.

Situata e furnizimit me ujë në Bashkinë Shkoder paraqitet si me poshtë:

27,794 familje (nga te cilat 84% në Shkodër qytet) furnizohen me ujë të pijshëm;

2,859 biznese furnizohen me ujë nga ujësjellësi;

Gjatë stinës së dimrit, sasia e prodhuar e ujit është 650 litra/ sek;

Gjatë stinës së verës, sasia e prodhuar e ujit është 850 litra/sek;

Rreth 78% e banorëve në NjA Shkodër furnizohen me ujë të pijshëm;

Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për territore të pjesshme në Nj.A. mbulohet nga Nd.Ujësjellës Fshat. Bashkia Shkodër ka trashëguar detyrimet për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm dhe detyrime të tjera për: Nj.A. Ana a Malit-ujësjellësi Obot i Ri, në Nj.A Guri i Zi dhe Nj.A Velipojë-furnizimin me ujë i shatërvanit në plazh.

Janë realizuar mbi 368 ndërhyrje në rrugë e sheshe të asfaltuara urbane me riparime pjesore të segmenteve të çarë në linjat e amortizuara të sistemit të furnizimit me ujë, instalime matësa uji në objektet e banimit, biznesit dhe institucione që marrin shërbimin e FU nga sistemi ujësjellës si dhe instalime matësa uji në pus-shpimet private për faturimin e shërbimit për largimin e sasisë së matur të ujit të përdorur nëpërmjet sistemit të KUZ-it. Gjithashtu janë realizuar shumë ndërhyrje për përmirësimin e FU të objekteve të shkollave e qendrave shëndetësore të Bashkisë Shkodër në qytet dhe njësitë administrative

Pjesëmarrje aktive të UK Shkodër me specialistë të Bashkisë për problemet e ndryshme teknike gjatë zbatimit të projekteve.

F4. O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza.

Në qytet 22,013 familje, dhe 2,870 biznese janë të lidhur me rrjetin KUZ;

Rreth 70 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ janë zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike;

Gjatesia e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza në qytet është rreth 150 km;

Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërat të zeza (në Velipojë, dhe në Shirokë);

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Përdorura Shirokë bën trajtimin e ujërave të zeza dhe i shkarkon në liqen konform normativave ligjore. Ky stacion është në efijencë të plotë dhe mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme nga UK Shkodër sh.a;

15,000 banorë në Velipojë përfitojnë nga shërbimi i largimit të ujërave të zeza;

Shirokë, mbajtja në funksionim normal i impiantit të pastrimit të ujërave të zeza;

Në qytet rregjistrohen në muaj afërsisht: 525 raste të ndryshme zbllokimesh dhe pastrime të rrjetit KUZ, 792 cope puseta të pastruara, 29,610 ml rrjet KUZ i pastruar. Në rrugë të ndryshme të qytetit janë riparuar 68 puseta, janë zëvendësuar 10 kapake gize dhe 46 kapak betoni.

F5.O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit Shkoder (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza.

Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km

Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura

pjesa tjetër janë kanale të hapura

Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.

Gjatë vitit 2018 është kryer mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit KUB qytet. Janë hartuar plane pune për mirëmbajtjen rutinë të pastrimit të kanaleve të ujërave të shiut, gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje të paplanifikuara sipas situatave kritike që janë krijuar dhe që rrezikonin funksionimin normal në zona të caktuara. Kanalet kryesore të kullimit kanë nevojë për ndërhyrje në pastrimin e tyre me makineri të mëdha, për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre.

Gjate vitit 2018 eshte punuar, ne objektet si me poshte:

Pastrim kanali Tepe

Pastrim kanali UB L Dukagjini

Pastrim kuneta Rr. Bujar Bishanaku

Pastrim kanali Dajç

Pastrim kanali Velipoje Plazh

Pastrim kanali L Gjuhadol

Pastrim kanali UB Rr. Zef Jubani, Varrezat Skenderbeg

Pastrim kolektori Rr. N. Kryeziu

Pastrim kolektori Rr. Ndocej

Pastrim kanali L. Mark Lula

Pastrim kunetash Unaza Lindore

Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.

Përveç pastrimeve të kanaleve, është punuar edhe në zëvendësimin e gradelave dhe riparim pusetash të dëmtuara.

F6.O1.A1. Vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike në bazë të kontratës themelore të qershorit 2013. Një shërbim, brenda parametrave dhe kushteve të kontratës si dhe kryerje e shërbimeve funerale brenda standarteve.

F6.O1.A2 Fillimi i kontrates së re 3-vjeçare të Shërbimit të Mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve, me kontrate të lidhur me 15.05.2018.

F6.O1.A3. Blerje e karburantit për pajisjet e prerjes së barit dhe shkurreve, pajisje që i disponojnë të gjitha njësitë administrative, në funksion të mirëmbajtjes së varrezave publike të tyre.

F7.O1.A1. Blerje aksesor dekori për festat e fund vitit.

Janë blerë aksesorë zbukurues me të cilët janë dekoruar sheshet Parrucë, Nënë Tereza, rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno Zogu i Pare si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.

F7.O1.A2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin

Janë blerë materialet e domosdoshme për riparimet e aksesorëve gjëndje nga furnizimet e viteve të mëparëshme. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:

Kordon ndriçues dekorative (\varnothing 12 mm) gjithsej 900 ml;

Tel percjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm gjithsej 900 ml;

Lidhëse kabllosh plastike gjithsej 45 kuti;

Pistole saldimi plastik gjithsej 2 copë dhe elektroda saldimi plastike gjithsej 480 copë;

F7.O1.A3. Blerje flamuj

Janë blerë flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.

F8.O1.A1.1. Ndërhyrje rehabilituese dhe mirëmbajtje

Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të ndriçimit publik janë realizuar në bazë të preventivave të hartuar për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet e banimit dhe lulishtet.

Materiale për ndërhyrje rehabilituese. Këtu përfshihen zëvendësimi i ndriçuesve dekorativ dhe zinkat, të dëmtuar: Pedonale "13 Dhjetori – 28 Nëntori" (zëvendësim koka ndriçuesish dekorativ) 12 copë dhe shtylla 8 – 10 m me ndriçues SMART 25 copë.

Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit

Këtu përfshihen shpenzimet për materiale e domosdoshme për riparimin e difekteve të mundshme të ndriçuesve. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:

Automat të madhësive të ndryshme 10 A deri 63 A gjithsej 800 copë. Këto automate do i përdorim për riparim e difekteve gjatë viti si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit , ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,

Drosel ndriçuesi 250 ë dhe 150 ë, gjithsej 1 620 copë

Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5, 2x4, 2x6, 3x6,4x4,4x6, 2x6 koksial, mm² , gjithsej 10 850 ml për eliminimin e difekteve nga dëmtimet gjatë viti

Lëshues të kapacitetit 25A deri 40A, gjithsej 430 copë.

Llampa SAP 150 ë, gjithsej 1 530 copë dhe 250 ë, gjithsej 270 copë

Llampa fuoriesçente 22 ë gjithsej 430 copë,

Rele krepuskolare modulare, 16/30 gjithsej 115 copë

Rele krepuskolare për shtyllë, 12/25, gjithsej 115 copë

Portollampa për llampa SAP 150 ë, gjithsej 100 copë

Portollampa porcelani për llampa elektronike 22 ë, gjithsej 170 copë

F8.O1.A1.2. Pagesa e konsumit të ndriçimit

Janë realizuar pagesat për konsumin e energjisë elektrike për ndriçimin publik qytet dhe njësitë administrative.

F8.O1.A1.3. Blerje veglash për elektriçista

Janë realizuar blerjet vegla pune për punonjësite sektorit të ndriçimi publik si për shembull:(sonda, pinca, shkallë, dalta etj)

F8.O1.A1.4. Pjesë këmbimi dhe Mirëmbajtje

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

IVECO

NISSAN ,

për të cilët në bazë të preventiva përkatës janë realizuar këto shpenzime. Në zërat kryesor mund të përmendim: pjesë këmbimi si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, ndërrim vaj hidraulik, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe naftë, saldimi i koshit.

F8.O1.A1.5. Shpenzime për karburant

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për secilin mjet.

F8.O1.A1.6 Pagesa për dokumentacionin

Për secilin mjet është realizuar pagesa e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

F8.O1.A1.7. Investime

Në zbatim të buxhetit të 2018, është realizuar ndriçimi i rrugës kryesore: rruga "Fermentim – Ura e Bardhajve"

Në zbatim të buxhetit të 2018, lekë është realizuar ndriçimi i 23 rrugëve dytësore:

Bulevardi Zogu i I

Rruga "Zenelej",

Rruga "Kucej",

Rruga "Paqes",

Rruga "Lek Dukagjini"(te ish rajoni Nr 2),

Rruga "Lek Dukagjini (te blloku i pallateve),

Rruga "Anton Mazreku"j,

Rruga "Inxh Gjovalin Gjadri (palatet te parku)",

Rruga "Anton Ashta"

Rruga "Komiteti i Kosovës"



Bulevardi Skenderbeu (blloku i pallateve te ish rajoni nr.4)
Rruga "Mehmet Shpendi",
Rruga e "Martireve"
Rruga Samrisht (Nj.A Dajç),
Rruga Bërdicë e Sipërme (Nj.A Bërdicë),
Rruga Mes (Nj.A Postribë),
Rruga Ura e Shtrenjtë (Nj.A Postribë),
Rruga Kullaj (Nj.A Postribë),
Rruga Guci e Re, (Nj.A Rrethina),
Rruga Shtoj i Ri, (Nj.A Rrethina),
Rruga Shkodër - Mjedë, (Nj.A Gur i Zi).
Rruga Oblike (blloku i pallateve), (Nj.A Ana e Malit).

F9.O1. Përmbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.

Përmes funksionimit të njësisë së ofrimit të shërbimeve publike në Bashkinë ë Shkodrës, punonjësit janë angazhuar në punë dhe:

Është realizuar ofrimi i shërbimit të pastrimit në Nj.A.

Është realizuar mbajtja në efikasitet rrjeti i ndriçimit publik në qytet dhe NjA.

Është realizuar punime të mirëmbajtja sinjalistikës horizontale dhe vertikale.

Është realizuar punime mirëmbajtje e objekteve në administrim të Bashkisë.

Të tjera sipas nevojës për punë publike në territor.

Është realizuar paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve

Është realizuar blerja e mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve, si për shembull: (Gur fleksibël, motorsekë, Indikator valor, Sopatë, Kit – Trapon matrapik me bateri, etj)

Për pagesën e një pjese të pagave janë përdorur fondet e trashëguara në vlerën 8,884 mijë lekë

Fondet e financimit të programeve

Me VKB nr.35, dt 22.05.2018 për rishpërndarje të fondeve të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 45,000 lekë me tvsh për aktivitetin:

Blerje aksesor dekorori per festat (shtesë e vlerës së planifikuar).

Fondet e miratuara për këtë program janë 393,331mije lekë.

Realizimi për periudhën 12 mujore është 377,983 mije lek në masën 96% ndaj planit vjetor.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018, paraqitet si më poshtë:

Shpenzime Operative janë realizuar në masën 298,793 mijë lekë nga 304,818 mijë lekë që ka qenë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 98 %.

Transferta jane realizuar ne mase 15,621 mije lek nga 15,889 mije leke qe ka qene e parashikuar.

Realizimi ne mase 98%

Investime janë realizuar në masën 37,169 mijë lekë nga 41,256 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 90 %.

Pagat janë realizuar në masën 26,400 mijë lekë nga 31,368 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 84 %.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P4.F1.O1.A1. Shërbimi i pastrimit qytet deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim)	74,434	74,434	74,434
P4.F1.O1.A2. Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Velipoje – Dajçderi 1.10.2018 (kontratë vazhdim)	11,150	11,150	11,110
P4.F1.O1.A3. Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Rrethina, Postribe Shale deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim)	10,106	10,106	10,105
P4.F1.O1.A4. Shërbimi I pastrimit Nj. Ad. Guri Zi, Berdice, Ana Malit deri 1.10.2018 (kontratë vazhdim)	5,284	5,284	5,284
P4.F1.O1.A5. Depozitim i mbetjeve në landfill gjithë Bashkia, deri 1.10.2018	31,697	31,697	31,432
P4.F1.O1.A6. Shërbimi i pastrimit për gjithë Bashkinë nga 1.10.2018 (5-vjeçare me vlerë limit 979,218 mije/leke)	48,961	48,961	48,137
P4.F1.O1.A7.1 Ndertim xhepa kazanesh për mbeturina.	1,200	1,200	1,016
P4.F1.O1.A7.3 Pajisje Elektronike monitorimi	450	450	446
P4.F1.O1.A8.Shpenzime për mjete transporti	1,280	1,280	1,110
P4.F2.O1.A1. Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në qytetin e Shkodrës (deri me 24 Janar 2018)	1,686	1,686	1,686
P4.F2.O1.A2 Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës	34,844	34,844	34,839
P4.F2.O1.A3 Investime	1,749	1,749	-
P4.F3.O1.A1 Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësive administrative	-	-	-
P4.F3.O1:A2:Rikonstruksion I rrjetit kryesor te ujesjellesit dhe ndertim I rrjetit te brendshme te ujesjellesit ne fshatrat Kullaj,Guci,Shtoj I ri,Shtoj I vjeter, Vinoteka dhe Fshati Ri(Pularia),Hot I Ri,Grude e Re-(Projekt+Zbatim+Supervizor+Koaludim)	-	13,909	13,743
P4. F4. O1. A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza	-	-	-
P4.F5.O1.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB)	15,000	15,000	15,000
P4.F6.O1.A1: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe	10,009	10,009	6,816



varrezave të dëshmorëve.			
P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike	1,971	2,016	1,840
P4.F8.O1.A1: Mirëmbajtja e Sistemit të Ndriçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative	90,167	90,167	87,617
P4.F9.O1.A1:Shpenzime per pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Shërbimeve Publike	33,517	33,517	28,036
P4.F9.O1.A2. Hartimi i planeve të veprimit per sherbimet publike	540	540	-
Programi RDPA Investime (Rikonstruksion i lulishtes “Vaso Kadia”)		5,332	5,332
TOTALI	374,045	393,331	377,983

P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithë fushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës. Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave.

Bashkia mbështet shërbimet e saja në funksione:

F1. Transporti publik vendor

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë.

F2.O1. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A.1.2 F.V Kufizues shpejtësie (bumpe gome).

Janë vendosur 105 ml bumpe për rritjen e sigurisë rrugore, kryesisht në akset kryesore në afërsi të shkollave

F1.O1.A.1.4. Blerje materiale për sinjalitikë horizontale + vertikale

Për vitin 2018 janë realizuar blerja e materiale për sinjalitikë horizontale + vertikale

Bojë rrugore bikoponente sprajt gjithsej 2500 kg

Bojë e verdhë gjithsej 150 kg

Mikrosfera qelqi gjithsej 150 kg

Tabela rrugore të ndryshme gjithsej 97 copë

Rula bojatisje gjithsej 20 copë

F1.O1.A.1.5. Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit

Janë realizuar këto shpenzime për mirëmbajtje: shërbim motori, pastrim injektorësh

F1.O1.A.1.6. Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për makinën e vijëzimit

F1.O1.A.1.7 Blerje paisje sinjalizuese për punime në rrugë

Ky objekt është realizuar

F1.O1.A.1.8 Blerje paisje sinjalizuese për punime në rrugë (Paisje për sinjalistike ujore plazhi Velipojë). Është realizuar blerja e bovave për kufizimin e lëvizjes në thellësisë së ujit në detë për rritjen e sigurisë për pushuesit

Fondet e financimit të programeve

Me vendim të Kryetares së Bashkisë, nr 154, dt 26.06.2018, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 900,000 lekë për aktivitetet e mëposhtme:

Blerje paisje sinjalizuese për punime në rrugë (Paisje për sinjalistike ujore plazhi Velipojë)

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018, paraqitet si më poshtë:

Fondet e miratuara për këtë program janë 13,712 lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 6,943 në masën 51 % ndaj planit vjetor.

Shpenzime Operative janë realizuar në masën 3,228 mijë lekë nga 3,512 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 92 %.

Investime janë realizuar në masën 3,715 mijë lekë nga 7,200 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 51.6 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P5.F1.O1.A1 Lëvizshmëria dhe sinjalistika	10,712	10,712	6,943
P5.F2.O1.A1 Shërbimi i Transportit Urban	3,000	3,000	-
TOTALI	13,712	13,712	6,943

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2018

P5.F1.O1.A.1.1 Investim në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale.

Investim në përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale nuk është realizuar pasi ky investim ishte parashikuar në funksion të studimit të sinjalistikës dhe lëvizshmërisë urbane. Për arsye të përsëritjes së procedurës studimi i sinjalistikës dhe lëvizshmërisë urbane, nuk është realizuar në afat për të mundur realizimin e investimit brenda vitit 2018.

P5.F1.O1.A.1.4 Vendqëndrimet e dedikuara për biçikleta. Nuk është realizuar

P5.F2.O1.A1 Shërbimi i Transportit Urban. Nuk është realizuar akt – marrëveshja me operatorin që kryen shërbimin.

P.6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuësve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lire dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

Pershkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018 ka fokusuar përpjekjet e saj në 6 funksione zhvillimi:

F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal

F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë

F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike

F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.

F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

F6. Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.01. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.

F2.01. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.

F3.01. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

F4.01. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

F5.01. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

F6.01. Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve. promocionale-informative.

F6.02. Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.

F6.03. Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

F6.O4. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.

F6.O5. Zhvillim i produkteve të reja dhe përmirësimi i infrastrukturës së produkteve turistike ekzistuese.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

P6.F1.O1.A4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë. Qëllim është të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të matë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara

P6.F1.O1.A3. Hartimi i plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër

Menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Bashkia Shkodër ka një shtrirje gjeografike e cila fillon nga Veriu i Alpeve Shqiptare deri në Bregdetin Adriatik duke përfshirë një sërë resurcesh. Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore. Menaxhimi i duhur i aseteve ka shumë rëndësi për menaxhimin e mirë financiar vendor. Menaxhimi më i mirë i aseteve mund të përmirësojë drejtpërdrejt zhvillimin ekonomik, duke ulur humbjet dhe kostot e panevojshme operative dhe duke identifikuar mundësitë e reja të zhvillimit. Është bërë analiza dhe vlerësimi i gjendjes faktike të një grupi asetesh, për sa i përket ndërrimit të destinacionit të fushës së përdorimit për këto asete.

P6.F1.O1.A4. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLOad)

Pjesëmarrja në Programet Europiane është projektuar për t'u mundësuar shteteve, njohjen me metodat dhe politikat e Bashkimit Europian (BE). Anëtarësimi në Bashkimin Europian (BE) konsiderohet si një sfidë, por gjithashtu integrimi evropian është prioriteti kryesor për Shqipërinë dhe një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Shqipëria përfiton nga Programet Europiane dhe në këtë kuadër edhe njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njërive vendore në këtë proces. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde evropiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen e lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e

Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi do të programohet i ndarë në dy vite buxhetore për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020. Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë. Thirrjet do të realizohen mbi bazën e dokumentave strategjike dhe prioriteteve që Bashkia Shkodër ka. I gjithë procesi do të konsultohet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Për tre thirrjet e organizuara do të zbatohet Metodologjia LOD. Në përfundim të procesit të vlerësimit të projekteve të thirrjes së parë dhe shpalljen e listës së fituesve u konstatua se vlera totale e buxhetit për 3 projektet fituese është 7,926,500 lekë. Nga të cilat 1,831,022 lekë janë kontribut i Bashkisë Shkodër, duke kaluar kështu vlerën e bashkëfinancimit (1,474,000 lek) të parashikuar në buxhetin e vitit 2018. Në mbështetje të marrëveshjes financiare prot nr. 331/30, datë 17.05.2018 kontributi financiar është përcaktuar të paguhet në përputhje me planin e mëposhtëm:

Datat e përcaktuara për pagesë	Shuma (lekë)
21 Maj 2018	1,474,000 lekë
Deri me 17 Dhjetor 2018	357,022 lekë

Me Vendim nr. 209, datë 27.09.2018 "për miratimin e rishperndarjes së fondit të zerave të shpenzimeve korrente brenda të njejtit program për vitin 2018" është bërë me kalimi i vlerës së mbetur 357,022 lekë nga fisha P6.F1.O1.A5., në mënyrë që të plotësohet vlera e likuidimit për tre projektet e parë të shpallura fituese gjatë thirrjes së parë.

P6.F1.O1.A5. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndëkomëtare.

Procesi i integritit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE-së në nivel vendor varet nga angazhimi i njërive vendore në këtë proces. Prandaj është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE-së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE-së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafuara europiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE-së dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Europian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE-së. Në këtë kuadër lind e nevojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

Nga kjo fische me urdhër nr.782, datë 26.09.2018 është bërë likuidimi i pagesës për tarifën e pranimit të 3% të grantit për çdo partnerë të PARK4SUM me vlerë 112.807 leke

P6.F2.O1.A3. Rehabilitim mirëmbajtje e merkatos në Rus (faza II)

Merkato Rus nuk funksionon me kapacitetin e saj te plote si rezultat i gjendjes se saj jo te mire. Një vëzhgim i bërë në tregjet publike, vihet re se hapësirat e posaçme që Bashkia ka vënë në dispozicion nuk shfrytëzohen e gjitha sepse kane patur nevojë për përmirësime te vazhdueshme. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e merakos do sjelle jo vetëm tregtimin në kushte të përshtatshme që do të rriste edhe vetë cilësinë e produkteve por mbi te gjitha do të nxisë formalizimin e këtij sektori. Aktualisht në tregjet ekzistuese, që janë tregje publike, eshte bërë një plan rehabilitimi për këta. Është bërë analiza e infrastrukturës ekzistuese të merkatos Rus dhe evidentim i nevojës për rehabilitim. Janë realizuar dëgjesa publike për shtesë fondi të projektit. Me VKB nr. 65 datë 30.10.2017 “Për rishpërndarje të fondeve të buxhetit të vitit 2017”, është miratuar rritja e vlerës së planifikuar për aktivitetin në fjalë në 11,672,485 leke për ndërtim, mbikqyrje dhe kolaudim të objektit. Gjate punimeve ka dale nevoja dhe per disa nderhyrje te tjera te vogla. Vlera e ketyre nderhyrjeve eshte shtuar me VK nr. 184 date 23.07.2018 me nje vlere 1.484.879 leke.

Gjithashtu është realizuar hartimi i projektit për rehabilitimin e saj dhe është kryer procedura e tenderimit, jane perfunduar punimet dhe eshte kryer provedura e likujdimit.

P6.F2.O1.A3. Përcaktimi i hapësirave dhe ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores për funksionimin e tregjeve të lëvizshme

Prodhuesit e Bashkisë Shkoder ankohen sepse një sasi e konsiderueshme e prodhimit të tyre nuk po arrin në treg për arsye të largësisë me tregun.

Për fermerët është i nevojshëm përcaktimi i një hapsire publike tregtimi të përkohshme. Krijimi i zonave te veçanta për tregje ditore mund te behet në lagje që e kanë të nevojshëm një treg, por kjo shërben edhe si ide për fillimin e tregjeve ne NJ.A tona. Ne ketë mënyre do të krijojmë një pamje me te rregullt tregtimi dhe një imazh me pozitiv për qytetin. Eshtë bërë rregullorja e funksionimit të tregjeve të lëvizshme, është bërë analiza e situatës dhe evidentim i nevojës për tregje ditore dhe të levizshme. Gjithashtu është realizuar hartimi i projektit të tregjeve të lëvizshme, është kryer procedura e tenderimit dhe është lidhur kontrata. Nuk eshte likujduar akoma per faktin se eshte ne proces prodhimi i stendave te levizshme.

P6.F3.O1.A1. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktiviteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër, ashtu si vitin e kaluar, ka realizuar panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të

përmendim Zyren Rajonale të Punesimit Shkoder, Qendren e Formimit Profesional, Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë. Në këtë panair, bizneset patën mundësinë të promovonin produktet e tyre, si një mundësi për tu njohur në tregun rajonal e më gjerë si dhe u njohën me potencialin e fuqisë punëtore të kualifikuar. Kishte rreth 55 pjesëmarrës në këtë panair, standat e të cilave u vizituan nga një numër i konsiderueshëm studentësh. Këtë vit ky aktivitet u mbështet nga projekti Seed Step II si dhe House of Europe. Bashkia Shkoder në bashkëpunim me programin **SEED Step II** synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis autoriteteve vendore, institucioneve, partnerëve socialë dhe të sektorit privat, në një partneritet lokal të qëndrueshëm për punësim. E vecanta e këtij aktiviteti ishte dhe lancimi i Platformës Virtuale “Tregu i Punës Shkodër”. Këtë vit vlera e parashikuar nga ne për aktivitetin në fjalë nuk u shpenzua, pasi u mbuluar teresisht nga donatorët.

P6.F3.O1.A2. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të mëdha për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse u organizua panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair u prezantuan të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional, secila ngriti në panair standin e saj. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vendase.

P6.F3.O1.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzorë përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj. Në këtë kuadër janë realizuar panairë në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkoder. Aty u prezantuan pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional.

Keto panaire u vlerësuan si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyre që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktiviteteve kulturore e më shumë prodhime vendase. Ky aktivitet konsistoi në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit. Ne dy prej këtyre panaireve gjetem edhe suportin financiar të projektit CEED Albania me qëllim promovimin e zhvillimit të agriturizmit në zone.

P6.F4.O1.A1. Ribotimi i profilit të Bashkisë

Bashkia Shkodër e përbërë tashmë nga 11 njësi administrative ka realizuar procesin e hartimit të profilit të ri të Bashkisë, një dokument informativ në të cilin në mënyrë të përmbledhur jepen të dhëna statistikore dhe informacion përshkrimor në lidhje me zonën dhe komunitetin e saj, duke përfshirë të dhëna gjeografike, historike, demografike dhe social ekonomike. Ky material prezanton në mënyrë të përmbledhur të gjithë territorin dhe tendencat e zhvillimit të saj. Këtë herë Profili i Bashkisë prezantohet në gjuhën angleze. Profili është botuar dhe janë përfunduar procedurat e likuidimit.

P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes ëeb të Bashkisë

Bashkia Shkodër nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe ëeb është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes në Shkodër. P6.F4.O1.A3. Ribotim i broshures informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër. Gjatë viteve, në funksion të zhvillimit lokal janë hartuar një sërë materialeve si strategji, plane dhe informacione të ndryshme të botuara në formë fletpalosje dhe broshurash për promovimin e territorit në funksion të zhvillimit ekonomik. Shumë prej këtyre materialeve promovuese janë tashmë të tejkaluara në lidhje me ndryshimet e shumta për sa i përket kuadrit ligjor në lidhje me të bërit biznes. Botimi i broshurës informative për tërheqjen e investimeve është i rëndësishëm për promovimin e të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër. Kjo broshurë përmban informacion të përgjithshëm për territorin, kuadrin ligjorë për të bërit biznes në Shkodër, rregullat e tregut të punës, sistemin e taksave dhe tarifave kombëtare dhe lokale, etj. Broshurë e ribotuar përmban informacion që do të promovojë të gjithë territorin administrativ të Bashkisë së re të Shkodrës. Janë kryer dhe procedurat e likuidimit

P6.F4.O1.A4. Profili i bizneseve të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Profilit të Bizneseve të Bashkisë Shkodër synon të ofrojë një përmbledhje të historive të suksesit të këtyre bizneseve, duke bërë një historik të shkurtër që nga krijimi i tyre e deri në ditët tona, e gjitha kjo e pasuruar edhe me llojet e produkteve që këto ndërmarrje prodhojnë. U zgjedhën biznese me një historik të konsoliduar në sektorin prodhues. Nga hartimi i këtyre profileve u botua një katalog, i cili ofron një panoramike të sipërmarrjeve lokale dhe produkteve të tyre, duke i dhënë mundësinë

çdokujt të njohë më mire prodhimet apo shërbimet që ato ofrojnë, kapacitetin e prodhimit etj. Profili i bizneseve është botuar dhe procedurat e likuidimit janë përfunduar.

P6.F5.O1.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet permirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së permirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfitojnë rreth 120 biznese. Në zbatim të programit të bashkëpunimit, me qëllim zhvillimin dhe permirësimin e klimës së biznesit në zonë është rinovuar marrëveshja për vitin 2018 dhe në kuadër të saj, Shoqata BID ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitesh kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Edhe për këto aktivitete është kryer procedura e likuidimit.

P6.F5.O1.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese.

Qytetet si qendra investimesh janë motorët e rritjes së zhvillimit ekonomik. Shkodra ka nevojë për rritjen e numrit të sipërmarrjeve, Start Up dhe SME-ve, si një mundësi për rritjen e zhvillimit ekonomik të 11 njësive administrative të saj. Vihet re një rritje e numrit të këtyre sipërmarrjeve pas krijimit të programeve të ndryshme të ofruara përmes AIDA-s, por mungesa e burimeve njerëzore profesionale për përfitimin e burimeve të financimit nga këto programe sjell barriera që sipërmarrjet të përftiojnë nga këto fonde. Me qëllim nxitjen e investimeve dhe rritjen e aksesit për përfitimet e këtyre fondeve nga ndërmarrjet, Bashkia Shkodër ka krijuar paketa informuese për subjektet e interesuara dhe ofron shërbimin e informacionit dhe këshillimit të tyre.

P6.F5.O1.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.

Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Në këto kuadër bashkia shkodër jep asistencën e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte që kanë nevojë.

P6.F6.O1.A1. Hostim, mirëmbajtje e faqes ëeb për turizmin e rajonit të Shkodrës.

Promocioni online ofron avantazhe të shumta në marketingun e territorit. Mundësia që ka ëeb-i për të bashkuar shumë elementë në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një ëeb-site zyrtar që i dedikohet turizmit. Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Turizmit ka krijuar ëebin e dedikuar: **ëëë.visitshkodra.gov.al** Është bërë hostimi, blerë domani bashkë me 8 modulet shtesë. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vinë në Shkodër. Kontrata është lidhur me operatorin në 2017 me një afat 1 vjeçar (deri 31 dhjetor 2018) dhe si rezultat i kësaj, buxheti i parashikuar për mirëmbajtjen e faqes në 2018 nuk ka qënë i nevojshëm të përdoret. Ky zë në buxhet do të përdoret në 2019 si shtesë e të njëjtit zë buxheti për shtim modulesh extra, duke pasur parasysh tendencat e vazhdueshme për produkte të reja dhe azhurnim të informacioneve të faqes ëeb për turizmin e Bashkisë Shkodër.

P6.F6.O1.A2.Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smartphonë që shërben për informimin dhe orientimin e vizitoreve.

Zhvillimi i teknologjisë dhe numri i lartë i përdoruesve të internetit, ka sjellë evolimin e metodave të marketingut, duke i kushtuar një vëmendje parësore marketingut online. Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, gjatë 2018 është krijuar aplikacioni për smartphone dhe android: **visitshkodra**. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, ëeb-it, aksesit për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit, do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

P6.F6.O1.A3. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. I gjithë territori karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore te ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e tre zyrave të informacionit në Shkodër, Velipojë dhe Theth, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promocionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë e rëndësishme. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të ribotohet herë pas here. Gjatë vitit 2018 është realizuar përditësimi i informacionit dhe botimi i guidës turistike në gjuhën shqipe (1200 kopje).

P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë.

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Nevoja për të pasur një hartë turistike të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër, për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë, ka qënë i domosdoshëm. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit gjatë vitit 2018, ka realizuar shërbimin e konsulencës (me fond të trashëguar 2017) dhe ka përfunduar hartën turistike dixhitale në format PDF për të gjithë territorin e bashkisë Shkodër, hartën dixhitale për qytetin e Shkodrës; Rajonin e Thethit, plazhin e Velipojës dhe liqenit të Shkodrës. Harta turistike e Bashkisë Shkodër, është publikuar gjithashtu në 1550 kopje. Hartat e botuara janë vënë në dispozicion të vizitorëve nga Zyra e Informacionit Turistik të Bashkisë.

P6.F6.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktiviteteve social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre organizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Në dhjetor 2018, Drejtoria e Turizmit ka realizuar ribotimin e kalendarit të ngjarjeve dhe eventeve për vitin 2019. Është realizuar publikimi i këtij kalendari në gjuhën shqipe dhe angleze (147 kopje)

P6.F6.O1.A6. Prodhimi i materialeve promociionale te tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmake etj.

Materiale të ndryshme promociionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj, janë materiale që kanë kosto të lirë por ndikim të madh në promovimin e një destinacioni të caktuar. Për të promovuar turizmin në destinacion, janë mjaft me vlerë edhe materialet promociionale, të cilat në shpërndarjen e tyre lënë një imazh të destinacionit. Është e rëndësishme që prezantimet apo takimet që do bëhen nga stafi i drejtorisë së turizmit, të kenë mjetet e nevojshme identifikuese. Në këtë kuadër, gjatë 2018, Drejtoria e Turizmit ka realizuar prodhimin e këtyre materialeve promociionale: çanta kartoni me logo të Bashkisë Shkodër (150 copë); Stilolapsa me ngjyra me logo të gdhendur (650 copë); axhenda me logo (25 copë); kartvizita (800 copë); kartolina të dizenuara (1000 copë);

P6.F6.O1.A7. Pergatitja dhe publikimi I itinerareve turistike

Një itinerar turistik është një nga komponentet kyç për të qëndruar i organizuar dhe i aftë për të maksimizuar kohën e cdo vizitori gjatë pushimeve të tyre. Veçanërisht për ata që duan të bëjnë një udhëtim vetëm, itinerari shërben si një udhërrëfyes që përmban informacion të hollësishëm dhe themelor rreth destinacionit. Planifikimi i itinerarit duhet të bëhet me kujdes, pasi janë shumë detaje që duhet të konsiderohen sic janë; koha, ushqimi, moti, akomodimi, shëtitja etj. Si një mënyrë lehtësimi dhe organizimi për turistët që zgjedhin Shkodrën si destinacionin e tyre turistik, Drejtoria e Turizmit, gjatë 2018 ka realizuar dizenjimin dhe publikimin e 5 (pesë) itinerareve turistikë (2500 kopje). Materialet promociionale janë vënë në dispozicion të vizitorëve nga Zyra e Informacionit Turistik të Bashkisë.

P6.F6.O2.A1. Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.

Një pikë e fortë e ofertës turistike të Bashkisë Shkodër me të cilën mund të konkurojmë denjësisht edhe në nivele ndërkombëtare, është artizanati. Në një situatë në të cilën zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies po çojnë dalëngadalë drejt humbjes së interesit për punimet artizanale dhe zbehjen e rëndësisë së tyre si aktivitete ekonomike, për shkak të rritjes së interesit të vizitorëve dhe të turistëve të shumtë që vizitojnë qytetin për punimet artizanale dhe suvenirët, lind nevoja që këto zeje dhe zanate të promovohen dhe të mbështeten si një element tërheqës dhe burim turistik. Punimet e qytetit të Shkodrës dhe të zonave përreth mbeten një suvenir i mrekullueshëm sapo viziton këtë qytet. Panairi është një instrument i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejtë në promovimin e këtyre vlerave që ka territori. Bashkia Shkodër, si çdo vit, organizoi me datë 10 qershor 2018 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Artizanatit: “Panairi i Artizanatit” me qëllim rritjen e interesit për prodhimin e produkteve artizanale vendase dhe rritjen e atraktivitetit të territorit.

P6.F6.O2.A3. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, gjatë 2018, Bashkia Shkodër mori pjesë në 2 panairë ndërkombëtare: “Panairi Ndërkombëtar i Turizmit”- Budva- Mal i Zi (22-24 mars 2018) dhe “Panairi Ndërkombëtar Mediterran i Turizmit”- Tiranë (06-07 prill 2018). Në kuadër të pjesëmarrjes në panairë,

jane prodhuar këto materiale promocionale: broshura e Thethit (1000 copë) dhe broshura e Velipojës (1000 copë) të cilat përmbajnë hartën përkatëse dhe informacionet e nevojshme për një vizitor në këto zona; Spila me foto të Shkodrës (100 copë); Manikin për ekspozitorë (2 copë); Flamunj me bazament promocionalë (2 copë); Blerje revista "Travel Magazinë" (50 copë).

P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit

Bashkia Shkodër tashmë për të disatin vit rradhazi, ka zhvilluar edhe këtë vit Festën e Liqenit me datë 23 qershor 2018. Ky është një aktivitet promovues social kulturor dhe sportiv që organizohet me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë dhe shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të Liqenit të Shkodrës

P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit.

Zhvillimi i turizmit ka ecur me hapa të shpejtë në vitet e fundit. Bashkia Shkodër, duke kuptuar rëndësinë e zhvillimit të turizmit, i ka dhënë përparësi të veçantë zhvillimit të tij, duke forcuar kuadrin institucional që punon në këtë drejtim. Gjithashtu për të ndërgjegjësuar edhe më shumë komunitetin dhe biznesin, për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, Bashkia Shkodër organizon çdo vit në ditën botërore të turizmit me datë 27 Shtator, aktivitete të ndryshme me qëllim evidentimin dhe promovimin e vlerave dhe potencialeve turistike që ka territori i Bashkisë Shkodër. Këtë vit, me datë 27.09 2018, në bashkëpunim me shkollën e mesme profesionale "Hamdi Bushati", në ambjentet e Muzeut Historik të Shkodrës, u organizua një aktivitet promocional, i cili konsistoi në prezantimin e aftësive të fituara nga nxënësit e kësaj shkolle. Organizimi i këtij aktiviteti kishtë si qëllim promovimin e figurave profesionale dhe afrimin e tyre me tregun e punës. Pjesmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të bizneseve turistike dhe insitucionet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë.

P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë.

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit shqiptar me vlera dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla, që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë në kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Këtë vit, ky aktivitet u realizua me datë 1 maj dhe konsistoi në organizimin e një koncerti të madh festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga artistë të qytetit të shkodrës si edhe nje grup valltarësh, lojra sportive (volejball, futboll dhe hemboll dhe gara me varka me vela dhe kanoe.

P6.F6.O3.A4. Festa e Thethit

E kthyer tashmë në traditë, edhe këtë vit u organizua hapja e sezonit turistik në Theth me datë 09 qershor 2018. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i zonës si destinacion i veçante turistik me vlera kulturore dhe natyrore, krijimi i eksperiencës unike gjatë qëndrimit në Theth dhe shembullit pozitiv dhe inspirues tek mikpritësit e zones. Në këtë aktivitet kishte koncert me këngë dhe valle folklorike lokale me pjesmarrjen e grupit Treva dhe këngëtarë të tjerë lokal. Këngët majë krahut, këngët me çifteli, këngët

me lahutë, rapsodi të ndryshme u performuan nga të ftuarit duke kënaqur publikun dhe në të njëjtën kohë kishin si qëllim ndërgjegjësimin dhe dëshirën e vendasve për ti ripërtërirë traditat e zonës.

Kostumografia u realizua nga kostumografja lokale File Strugaci. Përfaqësues të rreth 40 bujtinave të zonës së Dukagjinit dhe 500 vizitorë morën pjesë në këtë festë. Aktiviteti u moderua nga znj. Kozeta Bruci (gazetare) dhe Z. Zef Bari i cili prezantoi gjatë gjithë programit historinë e të jetuarit dhe traditat e zonës, tradita këto të cilat u reflektuan me pikën kulmore të festës gjatë vënies në skenë të “ Gjamës së Burrave për vdekjen e Skëndërbeut” – një ritual mortor dhe një traditë e lashtë që ka përcjell popullin shqiptar për disa shekuj në veçanti në Veri të Shqipërisë. Realizimi i ekspozitës me fotografi të lashta u mundësua nga mbështetja e Giz dhe ADZM.

P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave.

Bashkia Shkodër me qëllim promovimin e vlerave të përdorimit të biçikletës si një mjet për transport më ekonomik, më i shëndetshëm dhe tradicional në qytetin tonë, organizoi me datë 20 shtator 2018 “Dita e biçikletave”. Kjo festë synon që të promovojë shërbimet e bicikletave nga bizneset vendase, identifikimin e njerëzve simbol në përdorimin e saj si dhe të angazhojë qytetaret në aktivitetet që do të realizohen me këtë rast. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me organizatën “The Door”. Pjesë e këtij aktiviteti ishte shkolla verore- një mujore, e cila startoi me 20 gusht për të rinj dhe të reja, artistë të qytetit për realizimin e një bicikle monument, vepër artistike. 15 pjesmarrësit e kësaj shkolle u ndoqën individualisht nga prof. Petrit Bilali, njëkohësisht dhe specialist skulptor pranë DRKK-Shkodër për të krijuar skicë-idetë e tyre etapë pas etape. Ekspozita e skicave të punimeve më të mira në realizimin e monumentit të bicikletës, u realizua në formën e bluzave të stampuara “të njejuna në tel” ditën e aktivitetit, u zhvillua konkursi dhe panairi i bicikletave, në rrugën Kole Idromeno. Elementë të tjerë ishin performanca kllounit në bicikletë, xhiroja demonstrative, dhe laboratorit kreativ për fëmijë dhe të rinj me temë bicikleta.

P6.F6:O3:A6. Triathlon

Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të zonës së mbrojtur të Liqenit të Shkodrës dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit, Bashkia Shkodër organizoi me datë 8 shtator 2018: “Triathlon Labeat”- 2018. I kthyer tashmë në traditë, ky aktivitet shënoi dhe 6 vjetorin e festimit të tij. Triatlone është një aktivitet tre-garësh në tre disiplina sportive të ndryshme, si gara e notit, ciklizmi dhe vrapimi, për të cilat ne jemi shumë krenarë për traditën dhe rezultatet e shkëlqyera që sportistët tanë profesionistë dhe amatorë kanë dhënë ndër vite. Aktiviteti u zhvillua në një nga zonat më të bukura të Bashkisë Shkodër, që shtrihet në të gjithë gjatësinë e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës: Shirokë - Zogaj. Në këtë garë të Triathlonit, pati një interes të shumtë për pjesmarrje jo vetëm nga Shkodra, por dhe nga qytete të tjera të Shqipërisë. Inteses të madh kishte këtë vit dhe nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Europës. Duke qenë se është një garë në 3 disiplina, u mendua që këtë vit të pranohen në garë jo më shumë se 50 persona, për arsye mirë organizimi dhe sigurie. Fituesit e garave u ndanë në katër kategori: Meshkuj të rritur; femra të rritura, junior dhe fëmijë. Qëllimi i zhvillimit të aktivitetit ishte: Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive ujore; Të ndërgjegjësojë komunitetin për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive ujore si Liqeni i Shkodrës.

P6:F6:O3:A7.Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë

Ornitologjia është fusha shkencore e dedikuar për studimin e zogjve. Në 2016, u zhvillua në Tiranë për herë të parë në Shqipëri, “Festivali i Zogjve”. Në 2017 u zhvillua edhe në Shkodër panairi i zogjve të kafazit me pjesmarrjen e ornitologëve nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Mali Zi dhe Maqedonia. Duke qënë se ky aktivitet pati një vëmendje të veçantë dhe solli një numër të madh të personave që merren me mbarështimin e zogjve, Drejtorja e Turizmit vendosi ta mbështesë organizimin e këtij aktiviteti gjatë 2018 duke pasur parasysh që qyteti njihet për një numër të madh dashamirës të zogjve dhe mbarështues të tyre. Aktiviteti u zhvillua në datat 10-11 nëntor 2018, në ambjentet e kompleksit “Ulaj”. Gjatë këtyre ditëve u bë prezantimi i zogjve të kafazit në disiplina të ndryshme, të njohura ndërkombëtarisht.

P6:F6:O3:A8. Lojra Popullore Fest

“Lojra Popullore Fest” është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë, i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është të promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes trupave pjesëmarrëse. “Lojra popullore fest” gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike kombëtare e ndërkombëtare. Këtë vit, aktiviteti u realizua në datat 20-21 prill 2018. Ditën e parë në sheshin para Bashkisë Shkodër, mbas takimit me titullarët e institucionit, trupat e ftuara nga të gjitha trevat shqipfolëse, performuan me valle dhe këngë duke vazhduar më tej me sfilata të kostumeve popullore gjatë gjithë rrugës “ 28 Nëntori” & “ Kolë Idromeno”. Të nesërmen aktiviteti u spostua në amfiteatrin natyror Ana e Malit, Oblikë, në fermën eko sociale me pjesmarrjen jo vetëm të trupave folklorike por dhe të qytetarëve të Shkodrës.

P6.F6.O4:A2. Termoizolim dhe blerje paisjesh për mobilimin e Zyrave të informacionit turistik

Zyra e informacionit turistik në Shkodër është vënë në funksion në muajin korrik të vitit 2017. Kjo zyrë është frekuentuar nga një numër i madh turistësh. Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj zyre në dhënien e informacionit për orientimin e turistëve që vizitojnë Shkodrën. Për krijimin e një ambjenti komod që të plotësojë të gjitha kushtet, ka rezultuar shumë i nevojshëm ndërhyrja me disa punime shtesë që lidhen me termoizolim të kësaj zyre. Konkretisht, gjatë 2018 është realizuar zëvendësimi i vetratave të xhamit me dopio-xham, muret e jashtme janë izoluar me material kundër shiut dhe erës dhe është kryer blerja e disa pajisjeve mobilare, të nevojshme për mirëfunksionimin e ZIT (tavolinë; karrige: raft)

P6.F6.O5:A2. Hartimi i planit të sinjalistikës turistike të Bashkisë Shkodër.

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Meqënëse numri i vizitorëve në rajonin e Shkodrës po rritet nga viti në vit, është e nevojshme vendosja e sinjalistikës turistike me qëllim orientimin e rezidentëve dhe turistëve në këtë rajon. Mungesa e saj mbetet një handicap për Bashkinë dhe në kuadër të reformës së re territoriale me zgjerimin e territorit të saj, hartimi i planit të sinjalistikës turistike mbetet një ndër nevojat kryesore për tërheqjen e vizitorëve në rajonin e Shkodrës. Ky zë buxheti ishte parashikuar që në 2017 dhe kaluar si fond i trashëguar në 2018. Gjatë 2018, Drejtorja e Turizmit nuk arriti ta finalizonte studimin për Planin e Sinjalistikës si produkt për arsye të anulimit të tenderit 3 herë për mospjesmarrje të operatorëve ekonomikë në tender. Buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2019 në fondet e trashëguara.

P6.F6.O6:A2 Trajnime të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Shkodrës.

Në një turizëm bashkohor një tour guide ka një rol mjaft të rëndësishëm në shumë aspekte. Performanca e një tour guide matet nga kompetenca e tij, e cila varet gjithashtu nga trajnimi dhe të mësuarit. Trajnimi është një pjesë e rëndësishme për t'i dhënë çdo vizitori një eksperiencë të madhe dhe për të siguruar sigurinë e tyre. Është e rëndësishme për një destinacion turistik konkurues që turistët të marrin shoqërinë e guidave turistike profesionale që i ndihmojnë ato me përvojat e tyre. Për këtë arsye lind nevoja për një trajnim më të specializuar të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Shkodrës dhe përgatitja e tyre në marrjen e licencës për ushtrimin e këtij profesioni. Gjatë vitit 2018, Bashkia Shkodër kishte të planifikuar zhvillimin e trajnimit të të rinjve për guida turistike në mbështetje të operatorëve turistikë. Gjatë 2018, Drejtoria e Turizmit nuk arriti ta realizonte këtë aktivitet, duke qënë se në Shqipëri ekzistonte vetëm një shoqëri e licensuar për trajnimin e guidave turistike dhe konkurenca për shpalljen e fituesit të operatorit ekonomik fitues nuk mund të ishte e hapur. Duke qënë se Ministria e Turizmit arriti të përfundojë procesin e licensimit të institucioneve të tjera të pavaruara për realizimin e këtij lloj trajnimi, buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2019 në fondet e trashëguara.

P6.F6.O7:A1. Vendosija e tabelave orientuese dhe informuese për ecje në Theth.

Zona e Thethit, e gjendur në zemër të Alpeve shqiptare përbën sot një ndër destinacionet më të frekuentuara të turizmit malor në Shqipëri. Ai frekuentohet nga një numër gjithnjë në rritje turistësh kryesisht europiano perëndimor të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe thjeshtë kuriozë për mënyrën autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonës së Thethit ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje është e nevojshme të jenë më të identifikueshme dhe të pajisen me sinjalistikë të përshtatshme, pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar dhe pa guida turistike për të vizituar Thethin. Ky aktivitet si rezultat i anulimit disa herë të procedurës së studimit për planin e sinjalistës turistike, nuk arriti të realizohej pasi tabelat duhen të vendosen sipas planit të miratuar nga KB. Buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2019 në fondet e trashëguara.

P6.F6.O7.A3. Vendosija e tabelave orientuese dhe informuese

Shkodra është kryeqendra nga mund të nisë udhëtimi për të vizituar veriperëndimin e Shqipërisë. Një numër i konsiderueshem i turistëve vinë në Shkodër në mënyrë të paorganizuar. Një rrjet i përhapur i informacionit lejon të arrihet shpejt dhe me siguri në destinacionin e dëshiruar. Prania e një shenje me drejtime të avancuara, shenja të konfirmimit dhe bordeve të informacionit është thelbësore për të arritur në destinacion pa mundim. Për këtë arsye, një zgjerim dhe përditësim i vazhdueshëm i tabelave orientuese dhe informuese, qofshin këto për automjete, biçikleta ose këmbësorë, është me rëndësi të madhe për të ofruar komoditetin e domosdoshem vizitorëve dhe udhëtarëve. Ky aktivitet si rezultat i anulimit disa herë të procedurës së studimit për planin e sinjalistës turistike, nuk arriti të realizohej pasi tabelat duhen të vendosen sipas planit të miratuar nga KB. Buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2019 në fondet e trashëguara.

P6.F6.O7:A4. Përmiresimi i vizitueshmerisë së ballkonit jugperëndimor të kalasë nëpërmjet pastrimit të vegetacionit dhe ngritjes së një strukture të lëvizshme (që mund të çmontohet në çdo moment) prej druri ose metalike

Ballkoni jugperëndimor i kalasë është ndër pikat më të bukura të qytetit, me një panoramë të jashtëzakonshme të bashkimit të 3 lumenjve dhe ku fillon e hapet fusha e nënshkodrës. Ngritja e një strukture të përshtatshme dhe në përputhje me normat në fuqi për ndërhyrjet në objektet monument kulture do të përmirësonte aksesin dhe do të rriste atraktivitetin e Kalasë Rozafa. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit, gjatë 2017 ka realizuar analizën e gjendjes faktike, studimin e vendit dhe të pozicionit të vendosjes së strukturës së lëvizshme. Është hartuar projekti teknik dhe është aplikuar pranë Këshillit Kombëtar të Restaurimit pranë Ministrisë së Kulturës për marrjen e lejes për ndërhyrje dhe është në pritje të miratimit të lejes. Fondi në dispozicion për këtë zë buxheti, ka kaluar si fond i trashëguar në 2018 por nuk ka arritur të realizohet as gjatë 2018 pasi nuk është miratura leja për ndërhyrje nga Këshilli Kombëtar për Restaurimin pranë Ministrisë së Kulturës.

P6.F6.O7:A6. Përmiresim i aksesit se shpelles se Gajtanit nepermjet venies ne kushte sigurie te shtegut qe te con ne kete shpelle.

Shpella e Gajtanit është ndër monumentet natyrore më të veçanta në rajonin e Shkodrës për vlerat e saj shkencore (gjeomorfologjike, arkeologjike e speleologjike), didaktike e turistike. Përfaqëson një shpellë karstike të formuar në shkëmbinj gëlqerorë. Për të arritur një vizitueshmëri të madhe nga vizitorët vendas dhe të huaj, për shkak edhe të hyrjes se saj, është i rëndësishëm përmirësimi i aksesit të kësaj shpelle. Nevoja e herëpashershme për pastrim, mirëmbajtje, dhe vënie në kushte sigurie të shtegut që të orienton drejt kësaj shpelle mbetet ndër nevojat primare. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit, gjatë 2018 ka realizuar analizën e gjendjes faktike, studimin e vendit dhe aksesin e vizitueshmerise se saj. Pas vizitave dhe rievimeve në pozicion si edhe pas konsultimeve me ADZM rezulton se shpella ka shembje të vazhdueshme dhe nuk ofron siguri për vizitorët.

P6.F6.O7.A8. Bashkëfinancim i projektit "Rigjenerimi I zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodrës përmes forcimit të qeverisjes lokale.

Në kuadër te projektit Re-Lake ("Rigjenerimi I zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodrës") që Bashkia e Shkodrës po implementon në bashkëpunim me shoqërinë e zhvillimit urban të qëndrueshëm "KALLIPOLIS – Trieste, zëri i buxhetit parashikuar si bashkëfinancim të këtij projekti për ndërhyrje dhe ndërtime për rikualifikimin mjedisor të siteve dhe rehabilitimin e parkut, nuk është shfrytëzuar pasi në rregjistrin e prokurimit ky zë është parashikuar si transferim, ndërkohë që duhej parashikuar si investim. Për këtë arsye, buxheti i parashikuar për këtë zë, do të kalojë në 2019 në fondet e trashëguara dhe realizimi i këtij zë buxheti do të kryhet përmes procedurës së tenderimit si investim.

Fondet e financimit te programeve

Me vendim " nr 184 date 23/07/2018 për "Miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2018", është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 1.484.879 lekë me tvsh për aktivitetin "Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus(faza e II)"

Me Vendim nr. 209, datë 27.09.2018 "për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zerave të shpenzimeve korrente brenda të njejtit program për vitin 2018" është bërë me kalimi i vlerës 357,022 lekë nga fisha P6.F1.O1.A5 tek aktiviteti P6.F1.O1.A4 "Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLOad)"

Me VKB 35 date 22.05.2018 " Per miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017 dhe të rishpërndarjes së fondeve të trashëguara të bashkisë Shkodër" është shtuar vlera 2,000,000 Leke ne fishen P6.F1.O1.A5. "Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European dhe Organizata të tjera ndërkombëtare"

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

Fondet e miratuara sipas planit të korrigjuar, për këtë program janë 16799 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 12357 mije në masën 73.56 % ndaj planit vjetor të korrigjuar.

1. Shpenzimet Operative janë realizuar në masën 3815 mije lekë nga 6293 mije lekë sipas planit vjetor të korrigjuar Realizimi 60.62%.
2. Transferta janë realizuar në masën 6821 mije lekë nga 7521 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 90.7 %.
3. Investimet janë realizuar në masën 1721 mije lekë nga 2985 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 57.65%.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Plani Korrigjuar	Realizimi 12-mujori 2017 në mijë lekë
P6.F1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Shkodër	-	-	-
P6.F1.O1.A3. Hartimi i plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër	-	-	-
P6.F1.O1.A4. Krijimi i instrumentit financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve nëpërmjet aplikimeve në bazë projekti për ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet (ReLOad)	1474	1831	1831
P6.F1.O1.A4. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European dhe Organizata të tjera ndërkombëtare.	2000	1643	113
P6.F2.O1.A2. Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus (faza II)	-	1485	1470
P6.F2.O1.A3. Përcaktimi i hapsirave dhe	-	-	-



ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores për funksionimin e tregjeve të lëvizshme

P6.F3.O1.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	300	300	-
P6.F3.O1.A2. Panairi i produkteve agroperpunuese sipas njësive administrative	700	700	659
P6.F3.O1.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	1440	1440	1340
P6.F4.O1.A1. Ribotimi i profilit të Bashkise	400	400	389
P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi i faqes ëeb të Bashkise	-	-	-
P6.F4.O1.A3. Ribotim i broshures informative për terheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër	300	300	241
P6.F4.O1.A4. Profili i bizneseve të Bashkise Shkodër	-	-	-
P6.F5.O1.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori	1600	1600	1600
P6.F5.O1.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese.	-	-	-
P6.F5.O1.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	-	-	-
P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes ëeb për turizmin e rajonit të Shkodrës	80	80	-
P6.F6.O1.A2. Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smartphone që shërben për informimin dhe orientimin e vizitorëve.	350	350	239
P6.F6.O1.A3. Ribotimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër (gjuha shqipe).	350	350	275
P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turistike së	-	-	306



territorit të Bashkisë (shërbim konsulence-2017)			
P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë (printim)	350	350	341
P6.F6.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë	120	120	114
P6.F6.O1.A6.Prodhimi i materialeve promovionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmake etj.	200	200	99
P6.F6.O1.A7. Pergatitja dhe publikimi i itinerareve turistike	200	200	140
P6.F6.O2.A1.Panairi i artizanatit ne ditën nderkombetare te artizanatit.	350	350	250
P6.F6.O2.A3. Pjesëmarrje në panairë kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës	550	550	328
P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit	300	300	300
P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit	250	250	191
P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje	400	400	400
P6.F6.O3.A4. Feste e Thethit	400	400	400
P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave	350	350	350
P6:F6:O3:A6. Triathlon	350	350	350
P6:F6:O3:A7.Mbeshtetje per Panairin e Ornitologjisë	150	150	132
P6:F6:O3:A8. Lojra Popullore Fest	250	250	250
P6.F6.O4.A2. P6.F6.O4:A2. Termoizolim dhe blerje paisjesh per mobilimin e Zyrrave te informacionit turistik	300	300	251
P6.F6.O5:A3.Ngritja e bordit keshillimor te perhershëm me perfaqesues te te gjithë aktoreve te interesuar ne zhvillimin e turizmit	-	-	-
P6.F6.O6:A2Trajnime të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Shkodrës.	200	200	-
P6.F6.O7:A1.Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese për ecje në Theth.	250	250	-
P6.F6.O7.A3. Vendosja e tabelave orientuese dhe	350	350	-



informuese ne Shkoder			
P6.F6.O7:A6.Permiresim i aksesit se shpelles se Gajtanit nepermjet venies ne kushte sigurie te shtegut qe te con ne kete shpelle.	400	400	-
P6.F6.O7.A8. Bashkefinancim i projektit "Rigjenerimi I zonës së mbrojtur të liqenit të Shkodrës përmes forcimit të qeverisjes lokale.	600	600	-
TOTAL	15,314	16,799	12,053

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Hostimi dhe mirëmbajtja e faqes ëeb për turizmin e rajonit të Shkodrës: Procedura për realizimin e këtij zëri buxheti nuk ishte e nevojshme të realizohet, duke qënë që vonesa e lidhjes së kontratës për hostim dhe mirëmbajtje, e parashikuar në 2017 dhe e realizuar në 2018 me afat një vjeçar (deri 31 dhjetor 2018).
- Trajnime të guidave turistike që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Shkodrës: Nuk u arrit të kryhej prokurimi publik për shkak të mungesës së konkureshmërisë së operatorëve që ofrojnë këtë shërbim (vetëm një operaor i licensuar nga Ministria). Ky zë buxheti do kalojë si fond i trashëguar në 2019 dhe do të realizohet me procedurë prokurimi, duke qënë se tashmë në territor ka disa institucione të licensuara nga Ministria për ofrimin e këtij shërbimi.
- Plani i Sinjalistës së territorit të Bashkisë (me fon të trashëguar nga 2017) nuk u arrit të realizohej si rezultat i anulimit disa herë të prokurimit publik për arsye të mos pjesmarrjes në prokurim të operatorëve ekonomikë. Mungesa e Planit të Sinjalistikës solli si rrjedhojë dhe mos realizimin e aktiviteteve të parashikuara në buxhet për vendosjen e tabelave orientuese dhe informuese në Theth dhe në Shkodër, pasi këto tabela ishin vendosur të viheshin sipas planit të miratuar nga KB.
- Përmirësim i aksesit se shpelles se Gajtanit nepermjet venies ne kushte sigurie te shtegut qe te con ne kete shpelle: Gjatë 2018, Drejtoria e Turizmit ka realizuar analizën e gjendjes faktike, studimin e vendit dhe aksesin e vizitueshmërisë së shpellës. Pas vizitave dhe rievimeve në pozicion si edhe pas konsultimeve me ADZM ka rezultuar se shpella ka shembje të vazhdueshme dhe nuk ofron siguri për vizitorët dhe ndërhyrja teknike nuk eviton rrezikshmërinë që paraqet vizita në brendësi të saj.
- Bashkefinancim i projektit "RE-LAKE": Parashikimi jo i duhur në zëra buxhetorë (i parashikuar si transferim dhe duhej si investim) ka sjellë trashëgimin e këtij fondi në përdorim gjatë vitit 2019 me rregullimin e këtij zëri në buxhet.

P.7 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë. Synimi afatgjatë kryesor është racionalizimi i modelit të fshatrave përsa i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

Rreth 43% e popullsisë së Bashkisë Shkodër jeton në zonat rurale. Numri i fermave bujqësore është rreth 11,200 me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 ha/fermë e ndarë në 2-3 parcela. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokë subargjilore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV. Me delegimin e funksioneve të reja Bashkia Shkodër ka trashëguar 213 km kanale ujitëse, nga këta 37 km janë funksionale dhe 176 km janë jo funksionale, ndërsa kanale kulluese janë gjithsej 622.7 km prej të cilave 142.7 km janë kanale të dyta dhe 480 km janë kanale të treta kulluese.

Sot problemi kryesor mbetet fragmentarizimi i tokës, gjë e cila krijon probleme në adoptimin e skemave të subvencioneve dhe futjes së teknikave të reja (modernizimit për të qenë me konkurent në tregjet e brëndshme), prandaj është domosdoshmëri përfundimi i procesit të rregjistrimit të tokës dhe krijimin e tregut të saj.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018 ka fokusuar përpjekjet e saj në 3 funksione zhvillimi:

- F1. Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- F2. Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.
- F3. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit.

Objektivat për secilin funksion janë:

P7.F1.O1 Permirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit

P7.F2.O1 Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore. Plotesimi i dokumentacioneve përkatëse të pronësive private

P7.F3.O1 Krijimi i databazës së informacionit bujqësor. Krijimi i strukturës këshillimit bujqësor

P7.F4.O1 Perthithja e granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural

Produktet për vitin 2018

F1.O1.A5 . Pastrim kanalesh ujitesë dhe kulluese për NjA

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore (si institucion varësie) ka ushtruar veprimtarinë në realizimin e objektivit të parë :Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit:

Hartimi i projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të Kanaleve Kulluesë bazuar në Planifikimin e miratuar në Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit , ndërhyrje pastrimi dhe vendosje në gjëndje funksionale të K.K. të dyta dhe të treta.

Gjatë vitit 2018 është arritur të mirëmbahen dhe rehabilitohen gjithsejt 18 km KU. (KUll) me një sipërfaqe të përmirësuar ujitjeje prej 350 Ha tokë bujqësore.

Për realizimin e ketyre ndërhyrjeve janë evidentuar në terren dhe hartuar projektet teknike për pastrimin e 2 kanaleve ujitëse (Prekal-Ura e Shtrenjtë , Nj.A. Postribë) me një volum pastrimi prej 2250 m³.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave, vazhdon të jetë prioritet i Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë.

Mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2018 janë hartuar projektet teknike për 126 kanale kulluese dhe përfunduar ndërhyrja e pastrim/mirëmbajtje për 112 kanale kullues të dytë dhe të tretë. Gjatësia totale e ndërhyrjes prej 105.9 km me një sipërfaqe të përmirësuar kullimi prej 3003 Ha dhe volum punimesh prej 113.262 m³, si dhe blerja dhe vendosja e 96 tombinove.

Më saktësisht ndërhyrjet gjatë vitit 2018 për çdo Njësi Administrative janë si vijon:

Nj.A. Ana e Malit

Gjithsejt KK pastruar - 20.28 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 834 Ha
Volume gërmimi : 18,542 m³

Nj.A. Bërdicë

Gjithsejt KK pastruar 20.9 km nga
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 548 Ha.
Volume gërmimi : 21,770 m³

Nj.A. Dajç

Gjithsejt KK pastruar 18.6 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 503 Ha
Volume gërmimi : 15,690 m³

Nj.A. Guri i Zi

Gjithsejt KK pastruar 32.1 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 838 Ha.
Volume gërmimi: 33,690 m³

Nj.A. Rrethina.

Gjithsejt KKII pastruar 14.1 km
Sipërfaqe gjithsejt përmirësuar kullimi - 280 Ha
Volume gërmimi : 23,570 m³

F1.O1.A6- Mirembajtje e skemes ujitese

Janë hartuar projekte teknike në Nj.A. Rrethinat për sistemin ujitës i cili përfshinte fshatrat Grudë e Re dhe Guci e Re në gjatësi ndërhyrjeje prej 8 km , projekt i cili parashikonte vendosje portash, ura dhe pastrim të një rrjeti krejtësisht të amortizuar.

F2.O1.A1-Krijimi i kadastres bujqesore dhe arshives se saj dhe futja ne sistem e zonave te parilevuara Të dhënat në regjistrin e pronave bujqësore rezultojnë të jenë me mangësi dhe informacione të pjeshme në lidhje me të dhënat kadastrale.

Në këtë kuadër është krijuar sektori i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës. Është siguruar rreth 80% e listës së familjeve përfituese të tokës në pronësi (Formulari 06) të Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, gjithashtu është siguruar lista e pronarëve të trojeve dhe shtëpive (Formulari 01), Harta kadastrale 1: 5000 të Njësive Administrative malore etj.

Është krijuar dhe vazhdon procesi i përditësimit të regjistrit elektronik të listave të familjeve përfituese të tokës në pronësi sipas ligjit nr. 7501 dhe VKM nr. 452, datë 17.10.1992, si dhe ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 për Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër. Listë kjo e realizuar nëpërmjet krahasimit dhe verifikimit të Formularit nr. 06 me listen e banorëve kryefamiljar të vitit 1991.

F2.O1.A3-Mbeshtetja e regjistrimit te pronave me shpenzimet e Bashkise

Në zbatim të ligjit Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” , VKM nr 994 datë 09/12/2015 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore , Drejtoria e Bujqesise që në krijimin saj ka nisur dhe vazhduar punën për proceduarat e kalimit në pronësi të tokës bujqësore për ish kooperativat bujqësore dhe ish ndërmarrjet bujqësore.

Puna për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve funksionale ka konsistuar në:

Verifikim i kërkesave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore dhe dërgim pranë Z.V.R.P.P. për regjistrim të pasurisë , arkivimi i kopjes së praktikës , regjistrimi në sistem i praktikës A.M.T.P. së përpunuar për cdo subjekt kërkues që ka kryer aplikimin nëpërmjet Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).

Krijimi, regjistrimi dhe azhurnimi i përditshëm i një database të të gjitha aplikimeve për verifikimin dhe përcjelljen e praktikave për regjistrimin në pronësi të tokës bujqësore pranë Z.V.R.P.P. Shkodër.

Për vitin 2017 numri i praktikave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore të përpunuara nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP është:

-aplikime të përpunuara 774 praktika
nga të cilat:

-përcjellë pranë Z.V.R.P.P. Shkodër për regjistrim - 443 praktika

-Kthyer përgjigje për plotësim të mëtejshëm dokumentacioni - 331 praktika

Për sa i përket zbatimit të ligjit Nr 171/2014 “Për përfundimin e Procedurave Ligjore të Kalimit të Tokës Bujqësore të Ish-Ndërmarrjeve Bujqësore në Pronësi të Përfituesve” janë mbledhur 609 kërkesa të përfituesve të cilët nuk janë paisur me A.M.T.P. pranë Njësive Administrative.

Ka vazhduar puna me tej me plotesimin e dokumentacionit te nevojshem, kërkesat institucioneve sipas percvaktimeve ligjore per secilin aplikant si dhe afishimin 15 ditor prane qendrave te Njesive Administrative.

F3.O1.A4-Promovim produktesh bujqesore dhe blegtorale nepermjet panaireve

Në përmbushje mbështetjes së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale te prodhuesve lokalë Bashkia Shkodër ka organizuar Panairin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë aktivitet pjesëmarrësit, prodhues të produkteve lokale dhe autoktone bujqësore dhe blegtorale promovuan aktivitetet e tyre prodhuese.

F4.O3.A1-Promovim dhe asistence teknike ne hartim projekte, plan biznese per perthithje te granteve.

Në bashkëpunim me projektin " Agro-Tourism Albania" janë organizuar dy takime informuese për transformimin e fermave me potencial të lartë në ferma agro-turistike. Është arritur të eviodentohen dhe ka filluar mbështetja në Bashkinë Shkodër për dy ferma, sipas planit të përbashkët me " Agro-Tourism Albania". Bëhet fjalë për dy ferma model të ndodhura njëra në Nj.A. Ana e Malit, fshati Muriqan dhe tjetra në Nj. A. Guri i Zi, fshati Ganjoll. Gjithashtu nga programet e Agjensise se Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) kanë përfituar 91 fermere.

F4. O4.A1 Trajtimi veterinar i kafsheve te rruges. Ngritja dhe funksionimi i strehezes per kafshet e rruges.

Në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale të përcaktuara me ligj shërbimi veterinar i Bashkisë Shkodër ka si detyra kontrollin e thertoreve dhe tregjeve të tregtimit të bagëtive dhe plotësimin me çertifikata shëndetësore veterinare.Për këtë është ushtruar monitorim dhe kontrole te vazhdueshme në tregjet e gjësë së gjallë dhe thertoreve. Janë kontrolluar, vulosur dhe shoqëruar me çertifikatë shëndetësore veterinare 6205 therje në thertoren në Dobraq. Gjithashtu ka pasur bashkëpunim me A.K.U. për kontrollin e dyqaneve te mishit dhe peshkut.

Fondet e financimit të programeve

Fondet e vitit dhe të trashëguara të miratuara për këtë program janë 86,128 mije lekë, 19.3 % paga dhe sigurime, 38.3 % shpenzime operative dhe 42.1 % investime, pergjate vitit buxhetor plani eshte rishikuar ne masen 2,213 mije lekë.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

Fondet totale te programit jane realizuar 59,806 mije leke ose ne masen 69.4 %, te ndara si me poshte: Paga e sigurime janë realizuar në masën 11,242 mije lekë nga 16,635 mije lekë e parashikuar në planin e korigjuar. Realizimi 67.6 % nga plani i korigjuar.

Shpenzime Operative janë realizuar në masën 27,699 mijelekë nga 33,009 mije lekë që ka qënë e parashikuar në planin e korigjuar. Realizimi 84 % nga plani i korigjuar.

Investimet jane realizuar ne masen 20,670 mije lek nga 36,287 mije leke qe ka qene e parashikuar ne planin e korigjuar. Realizimi ne masen 57 % nga plani i korigjuar.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korigjuar	Realizimi
P7.F1.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P	13,501	15,714	13,153
P7.F1.O1.A3-Nxitja e krijimit te Shoqatave te perdoruesve te ujit ne çdo Nj.A dhe trainimi i tyre	306	306	-
P7.F1.O1.A5-Pastrim kanalesh kulluese dhe ujtese ne Nj.A.	12,229	12,229	12,229
P7.F1.O1.A6- Mirembajtje e skemes ujtese	7,346	7,346	6,721
P7.F1.O1.A7- Zbatimi i projekteve teknike prioritare per sistemin e ujitjes ,kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni	-	-	-
P7.F2.O1.A1-Krijimi i kadastres bujqesore dhe arshives se saj dhe futja ne sistem e zonave te parilevuara	902	902	-
P7.F2.O1.A3-Mbeshtetja e regjistrimit te pronave me shpenzimet e Bashkise	510	510	-
P7.F3.O1.A1-Krijimi i informacionit bujqesor			
P7.F3.O1.A2-Sigurimi i mbeshtetjes se fermerëve per agroindustrine, treg dhe marketing	-	-	-
P7.F3.O1.A3-Promovimi dhe krijimi i SHBB ose grupeve prodhuese e tregtuese			
P7.F3.O1.A4-Promovim produktesh bujqesore dhe blegtorale nepermjet panairëve			
P7.F4.O1.A1-Promovim dhe asistence teknike ne hartim projekte, plan biznese per perthithje te granteve.			
TOTALI	34,794	37,007	32,103
Të trashëguara	49,121	49,121	27,723
TOTALI (Viti + Të trashëguara)	83,915	86,128	59,826

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

Vështirësitë e paraqitura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

Në paisjen me materiale dhe dokumentacione kadastrale nga ana e institucioneve përkatëse. Me gjithë angazhimin tonë dhe kërkesave të vazhdueshme pranë Z.V.R.P.P. Shkodër, materialet nuk janë vënë në dispozicion, në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe administrative.

- Në krijimin dhe mbështetjen e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (O.P.U) për shkak të mungesave në akteve ligjore që mbulojnë këtë sektor.

P8. Mjedisit dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

Programi i mbrojtjes së mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe reduktimit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes akustike. Ky program ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe afësisë ripërtitëse të tyre, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Për hartimin dhe zbatimin e planeve nëpërmjet forcimit të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore që synon parandalimin e krijimit të hotspotëve të reja, ndërmarrjes së veprimeve për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithëpërfshirës. Në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për të bashkëpunuar për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta.

Politikat e këtij programi kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe aftësisë ripërtitëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës. Një politikë shumë e rëndësishme e programit është shfrytëzimi racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Duke analizuar në formë analitike programin buxhetor për “Mjedisin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave”, realizimi i këtij programi referuar objektivave specifike dhe aktiviteteve/projekteve për periudhën Janar - Dhjetor 2017, të paraqitura edhe në Matricën e Buxhetit të Vitit 2017 miratuar me VKB, paraqitet si vijon:

- F1. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme të mjedisit dhe të përbërësve të tij.
- F2. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.
- F3. Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëntokësore etj, nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.
- F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat për secilin funksion janë:

- F1.O1. Zbatimi i masave të propozuara të VSM-ve, PPV Bashkia Shkodër, si dhe VNM-ve për projektet e propozuara.
- F1.O2. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet hartimit të planit të veprimit të zhurmave
- F1.O3. Promovimi i energjisë zero në objektet publike.

F2.O1. Forcimi i pjesëmarrjes publike në takimet për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje të tij.

F2.O2. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit parauniversitar mbi promovimin e zhvillimit e qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Shkodër.

F3.O1. Ndërtimi i kadastrës ujore në bashkinë Shkodër

F4.O1. Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të bashkisë.

F4.O2. Hartimi/rishikimi i Planeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullësor në bashkinë Shkodër.

F4.O3. Rehabilitimi dhe pyllëzimi i siperfaqeve pyjore/kullësore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni (Projektim/Investim).

Produktet për vitin 2018

Gjatë periudhës që raportohet nga ana e Drejtorisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave është punuar me përkushtim për realizimin e objektivave specifike në funksion të realizimit të Funksioneve kryesore.

F1.O1.A1 Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme të mjedisit dhe të përbërësve të tij .

Bashkia Shkodër në kuadër të zbatimit të Deklaratës mjedisore ku përcaktohen detajimet e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e dispozitave ligjore në funksion të tij, në zbatim të detyrës funksionale për zbatimin e të objektivave mjedisore të VSM të PPV janë dhënë 5 opinione për VNM e paraqitura prej të cilave 3 publike dhe 2 private, si edhe 25 opinione për Leje Mjedisore tip C..

F1.O2.A1. Krijimi i Hartës së zhurmave si edhe shpalljen e zonave të qeta. Qyteti Shkoder/ NJA Velipoje. Hartëzimi i hotspoteve të zhurmave në qytetin e Shkodrës kjo bazuar në Ligjin nr 9774 datë 12.07.2007 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë vitit 2018 është përgatitur drafti i Planit Lokal të veprimit të Zhurmave në mjedis dhe është bërë përpunimi hartografik i matjeve të zhurmave në qytet , është përgatitur edhe harta e zhurmave.

Ky material ndodhet i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

F1.O3.A1. Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficientë të energjisë në objektet publike , prone e Bashkisë Shkodër.

Në kuadër të Ligjit nr 124/2015 “ Për eficientësinë e energjisë” si edhe akteve nënligjore në zbatim të tij nisur edhe nga objektivat e Qeverisë Shqiptare për ulje të konsumit të energjisë, mbledhjen e të dhënave teknike për realizimin e materialit studimor mbi auditimin energjetik në objektin “ Shkolla e mesme Jordan Misja”. Ky material përbën bazën për auditimin përfundimtar energjetik si edhe rekomandimet përfundimtare. Është realizuar Drafti përfundimtar i raportit Studimor mbi auditimin energjetik në objektin “ Shkolla e mesme Jordan Misja” dhe ky material është i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

F2.O1.A1. Realizimi i 4 takimeve për sensibilizimin e banorëve të Bashkisë Shkodër mbi çështjet mjedisore dhe mbrojtjen e tij.

Gjatë vitit 2018 janë organizuar 4 takime , keshtu ne kuader te promovimit te pyjeve takim per aplikim per projekte per mbrojtjen e pyjeve dhe rritjen e pyllzimeve. U prezantuan aktivitetet e subjekteve ndikimet që këto veprimtari kanë në mjedis si dhe u kërkua që banorët të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit në vazhdimësi.

F2.O2.A1.Realizimi i 4 takimeve për sensibilizimin e banorëve të Bashkisë Shkodër mbi çështjet mjedisore dhe mbrojtjen e tij.

Takim sensibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës" 05 Qershor - Dita botërore e mjedisit 22 Shtator - Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër 11 Dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve – Pyllëzimi

Gjatë vitit 2018jane realizuar disa takime sensibilizuese me arsimin parauniversitar sipas datave të përcaktuara :

Jane realizuar takime ne kuader te "dites se tokes" organizuar me nxenesit e klases 10 dhe 11 dega piktore e shkolles artistike " Prenk Jakova" Shkoder. Nga Drejtoria ne emer te Bashkise Shkoder u shperndane edhe 3 cmime .Aktivitet ne kuader te dites se mjedisit , me femijet e kopshtit mbjellje peme ne lulishte " Vaso Kadia" . Aktivitet me nxenesit e shkolles në Postribë ne kuder te dites se pyjeve.

F3.O1.A1.Mbledhja dhe azhurnimi i informacionit për subjektet ndotëse dhe shrytëzuese të burimeve ujore të pellgut ujëmbledhës, Bashkia Shkodër.

Gjatë vitit 2018jane identifikuar 86 subjektet te cilet jane perdorues uji me impakt ndotes ndaj burimeve ujore në njesine Berdice dhe Dajc.

F3.O1.A2. Organizimi dhe hartimi I draftit përfundimtar të databases së përdoruesve së burimeve ujore ne Bashkinë Shkodër.

Gjatë vitit 2018është realizuar harta Berdice dhe Dajc me subjektet perdorues te ujrave dhe qe shfrytezojne pellgun ujembledhes.

Shkodra është e rrethuar me liqen, lumenj dhe det dhe ndikimi i tyre në jetën urbane është shumë i madh, si me ndikim pozitiv ashtu edhe me ndikim negativ, përmendim këtu rastet e përmytjeve.

U bashkëpunua me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujrave, Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe u realizua grumbullimi i informacionit elektronik dhe hard copy, e cila u përkthye në formatin GIS. Sot kemi një informacion fillestar i cili na jep të dhëna të rëndësishme siç është pellgu ujëmbledhës Drin–Bunë, vija bregdetare që administron Bashkia Shkodër, vija lumore apo edhe sipërfaqja liqenore.

F3.O1.A3.Ndërtimi i hartës së kadastrës ujore.

Te gjitha të dhënat e mësipërme janë hedhur në një hartë e cila përditësohet me cdo të dhënë në vijimësi të procesit.

F4.O1.A1.Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullosore/sherbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.

Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor për këtë gjatë vitit 2018 janë realizuar Kontratat e Punës për 10 Vrojtues të cilët mbulojnë Ekonomitë Pyjore si më poshtë : 1 vrojtues NJA Shosh për EP Shosh 1,2, 2 vrojtues NJA Pult për EP Brucaj, Ugina e Kirit, 3 vrojtues për NJA Postribë ,EP Ura Shtrenjt, Prekal, DrishtNdermolla,

Lodërtunë ,Vilzë , 2 vrojtues NJA Shalë , EP Shalë1dhe Shalë2 , “ Vrojtues për NJA Guri i Zi për EP Pruemos-Sheldi , Rosek-rrjoll Shllak1.

Janë ngritur njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve pranë NJA Guri i Zi, Postrribë, Pult, Shosh , Shalë. Gjatë muajve të verës si rezultat i një bashkeveprimi të mirë të të gjithë strukturave nuk patëm raste zjarri në me djegie masive në sipërfaqet pyjore dhe kullosore.

Në funksion të këtij shërbimi u ble një automjet i cili u vu në dispozicion të këtij aktivitetit.

F4.O1.A2 Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër.

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Shkodër, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislationit në fuqi.

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018 ka punuar për konsolidimin i shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave nëpërmjet formimit të strukturës për administrim dhe menaxhim të këtij fondi pyjor.

Eshtë plotësuar struktura e Sektorit të Pyjeve pranë DSHBP me specialiste/teknike në funksion të konsolidimit të shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave

Specialistët e këtij sektori për çdo konstatim të paligjshëm në zonat pyjore/kullosore kanë njoftuar ISHMP Shkodër, kanë ndjekur Kontratat e punimeve që janë kryer në sipërfaqet pyjore nga subjektet e autorizuara, Punimet në investimet për ndertimin e Leravetë ujit , punimet në pastrimin e sipërfaqeve pyjore apo edhe ankandet e frutave të pyllit .

Shërbimi i administrimit të fondit pyjor kullosor nëpërmjet miradministrimit të tij dhe menaxhimit të pronave bëri që Drejtoria të realizojë të ardhurat në vlerën 3.690.872 leke .

F4.O2.A1 Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hatimit të Planit të menaxhimit për NJA Postrribë.

Gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me kadastrën e sektorit të pyjeve pranë DSHBP janë evidentuar zonat pyjore të cilat nuk kanë qene pjese e Planit të menaxhimit të ish Komunes Postrribë si edhe problematikat verejtura. Kështu është bërë gati informacioni për të rishikuar/hartuar Planin e ri të menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave të kësaj NJA.

F4.O2.A2. Realizimi i regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave bashkiake.

Jane rishikuar kufijte e zones pyjore NjA Pult dhe NJA Shale si edhe zones se Mbrojtur.

Regjistrimi i pronave Pyje/Kullota referuar shkreses nr 5548/1 dat 06.07.2018 të K/Regjistruesit Tirane , do të kryhet në kuader të Projektit të BB për Shërbimet Mjedisore.

Jane përpunuar hartat për 50 ngastrat të NjA Pult

F4.O3.A1.Hartim i projektit " Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve në malin e Traboshit

Eshtë realizuar projekti i Rehabilitimit Mjedisor të Gurores e cila ndodhet përballë Urës së Re të Bunës.(vazhdim i projektit rehabilitues të realizuar vitin e kaluar). Rehabilitimi mjedisor i gurores ul rrezikshmërinë e rrëshqitjeve masive të dheut, shton sipërfaqet e gjelbërta duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe duke krijuar edhe një fasadë të gjelbër për zonën.

Është hartuar Projekti i Zbatimit për “ Rehabilitimin mjedisor të Gurores Tarabosh” i cili përmban punime të tilla si , hapje gropa me matrapik për mbjellje pemë kacavjerrëse ndërtim mure dekorative , vendosje rrjete peshku për instalimin e bimëve kacavjerrëse si nga poshtë edhe nga lart etj.

F4.O3.A2. Ndertim prita malore ne Prroi i Kapresë dhe përroi Shehu i bardhë në (NJA Shale, NJA Shosh)

Ne vijimesi të punës për luftimin e erozionit u ndërtuan prita me mur guri të thatë, të cilat u ndërtuan kryesisht në përrenj. Realizimi i projektit do të beje ruajtjen e tokes nga erozioni dhe ka ndikim ne permiresimin e situates mjedisore e sociale.

Realizuar Projektim /Ndertim Prita Malore ne Perroi i Grykave me nje volum 550m3 e cila mbron nje siperfaqe pyjore mbi 250 ha.

Janë kryer projektet/ është realizuar procedura e tenderit është lidhur Kontrata e Zbatimit të Punimeve.

F4.O3.A3 Hartim projekte teknike për Pyllëzim në siperfaqet pyjore në Rrethina , Guri i Zi dhe Postribe. (sipërfaqet e djegura)

Gjatë vitit 2018u hartuan projektet për Pastrim/Pyllëzim/ripyllëzim të sipërfaqeve pyjore të cilat u përshkuan nga zjarri në vitin 2017. Ky projekt konsiston në pëstrimin e sipërfaqes pyjore kryesisht me pishë ,ky pastrim ndihmon vegjetacionin të rigjenerohet dhe njëkohësisht e ruan sipërfaqen nga zjarret e mundshme. Ky projekt është i gatshëm për tju ofruar subjektve private të cilët janë të interesuar për zbatimin e këtij projekti.

F4.O3.A4 Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore ne NJA Shalë dhe NJA Shosh.

Eshte zbatuar kontrata e punimeve per realizimin e projektit te pastrimit ne NJA Shosh-EP Shosh 2 dhe NJA Shale, EP .Lugina e Shales.gjithesej 10 ha . Me ane të permiresimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, ruajtja e filizerisë së re , si edhe përmirësimi i pyjeve të gështenjës për të përfituar banorët nga përmirësimi i këtij fruti pyjor.

F4.O3.A5 .Sinjalistike pyjore ne NJ Shale, dhe Postribe

Gjatë vitit 2018 janë realizuar materiale në funksion të shërbimit të sinjalistikës pyjore , janë plotësuar veshjet më shenjat e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të Bashkisë Shkodër , janërealizuar 2 tabela informuese mbi sipërfaqet qe ka në administrim Bashkia , llojin e pyjeve/kullotave etj.

F4.O3.A6.Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne NJA Shalë e NJA Postribë.

U realizua Projektim/Investim pastrim i parcelave pyjore ne , Nja Shalë dhe NJA Postribënë një sipërfaqe gjithesej 25 ha .Nderhyrja ne kohe per luftimin e semundjes se kancerit te geshtenjes , do te sjelle permiremiresimin e situates duke rritur fuqine vegjetative te drurit si edhe prodhimin e geshtenjes.

F4.O3.A7. Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Guri i Zi, dhe Nja Shosh

Gjatë vitit 2018 u realizua projektim/ndertim i 2 lervea per grumbullim dhe mbajtje uji te pijshem per blegtorine me kapacitet 205m3 , per te cilat sigurohet uji per nje numer prej rreth 163 krere te imta dhe

15 krere te trasha. Këto lera u realizua në zonën e Gurit të Zi dhe në atë të Shoshit. U kryen punimet në dy lera ekzistuese të cilat ndodheshin në këto zona.

Fondet e financimit të programeve.

Për përmbushjen e plotë të detyrimit ligjor për Administrimin e fondit pyjor kullosor, referuar edhe pamjaftueshmërisë financiare të dhënë me transfertën specifike, Bashkia Shkodër akordoi në Buxhetin e vitit 2018 një fond shtesë në funksion të këtij shërbimi, me shumë totale **13,698 mije lekë**

Fondet e miratuara për këtë program në total për vitin janë **18,099 mije lekë**.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018.

Realizimi për periudhën 12 mujore është 13,698 mije lek në masën 75.6% ndaj planit vjetor 18,099 mije lek

Shpenzime per paga jane realizuar 7,236 mijeleke nga 10,098 mije leke qe ka qene e parashikuar ne fillim te vitit. Realizimi 72 %

Shpenzime Operative janë realizuar në masën 2,373 mije lekë nga 2,574 mijelekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 100 % diferencat ne fond si rezultat i tenderimit.

Shpenzime per investimet jane realizuar ne masen 3,965 mije nga 5,282 mije leke qe ka qene e parashikuar ne fillim te vitit. Realizimi i investimit 100% diferencat ne fond janë si rezultat i tenderimeve

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Korrigjuar	Realizimi
P8.F1.O1.A1. Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.	-	-
P8.F1.O2.A1. Krijimi i Hartes se zhurmave si edhe shpalljen e zonave te qeta. Qyteti Shkoder/ NJA velipoje	-	-
P8.F1.O3.A1. Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficente të energjisë në objektet publike , prone e Bashkise Shkoder.	-	-
P8.F2.O1.A1. Realizimi i 4 takimeve	-	-
P8.F2.O2.A1. Takim secibilizues për 22 prill "Ditën e Tokës" 05 Qershor - Dita botërore e mjedisit 22 Shtator - Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i paster 11 Dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve - Pyllëzimi	-	-
P8.F3.O1.A1. Mbledhja dhe azhurnimi I informacionit per subjektet ndotese dhe shrytëzuese të burimeve ujore të pëllgut ujëmbledhës, Bashkia Shkodër	-	-
P8.F3.O1.A2. Organizimi dhe hartimi I draftit perfundimtar të databases së përdoruesve së burimeve ujore ne Bashkinë Shkodër.	-	-
P8.F3.O1.A3. Ndërtimi I hartës së kadastrës ujore	-	-
P8.F4.O1.A1.Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullosore/sherbimi pyjor	3,076	2,071
P8.F4.O1.A2 Administrimi i sherbimit te pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Shkoder	9,209	6,450
P8.F4.O2.A1 .Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hatimit te Planit te menaxhimit për NJA Postribe. (Gjithesej 8500 ha)	-	-
P8F4O2A2: Përgatitje e materialeve per Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake.	-	-
P8.F4.O3.A1.Hartim i projektit " Rikualifikimi mjedisor/social i guroveve ne malin e Traboshit.	-	-



P8.F4.O3.A2. Ndertim prita malore ne NJA Shale .	3,060	2,008
P8.F4.O3.A3 Hartim projekte teknike per Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Rrethina dhe Guri i ZI, Postrribe. (siperfaqet e djegura)	-	-
P8.F4.O3.A4 Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore NJA Shale, Shosh	1,020	1,011
P8.F4.O3.A5 Pyllezim i objektit Kodra e Tepes	-	-
P8.F4.O3.A5 .Sinjalistike pyjore ne zonat pyjore te NJA .	204	50
P8.F4.O3.A6..Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne NJA.	510	414
P8.F4.O3.A7. Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota ne NJA	1,020	817
Totali	18,099	12,821

P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Bashkia Shkodër duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 11 njesitë administrative. (90 shkolla, 60 kopshte, 2 konvikte dhe 1 shkollë speciale), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (Parashkollor dhe të Qendrës Kulturore), punonjësit e shërbimeve mbështetëse të Arsimit të Mesëm dhe konviktet.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 ka fokusuar përpjekjet e saj në 6 funksione zhvillimi:

F1. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar

F2.

F3. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë së Shkodrës.

F1.O2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor

F2.O2. Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor, të sigurtë konform standarteve ligjore

F3.O1. Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese për fëmijë.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

P9.F1.F2.O1.A1. Pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e arsimit

Llogaritje e pagave për vitin 2018 është bërë mbi bazën e vendimit nr. 205 dt.19.06.2017 "Për miratimin e Strukturës së Administratës dhe të Institucioneve të Varësisë të Bashkisë Shkodër, për vitin 2017" dhe në bazë të Vendimit të K.M nr 175, datë 8.3.2017". Kështu shërbimi në arsimin parauniversitar për 222 punonjës drejtues, edukatorë/kujdestar dhe personel mbështetës me burim financimi nga transfertat specifike dhe të ardhurat e veta. Kryerje e rregullt e pagesave për paga, sigurime shoqërore dhe shëndëtsore të punonjësve, në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparence.

Nr	Pershkrimi	Nr punonjës
1	Punonjës për zyrën e arsimit	37
2	Punonjës të konvikteve	41
3	Punonjës mbështetës të arsimit para shkollore dhe 9 - vjeç	76
4	Punonjës mbështetës të arsimit të mesëm	43
5	Punonjës mbështetës zevendësues për sistemin e arsimit parauniversitare	25

P9.F1.O1.A21 Mbështetje për mirëmbajtjen e infrastrukturës, shërbimet mbështetëse për nxënësit dhe stafin mbështetës në shkolla

Gjatë vitit 2018 Drejtoria Ekonomike e Arsimit administron 90 shkolla dhe 2 konvikte. Nga këto 28 shkolla në qytet dhe 62 në Njistë Administrative. Numri i nxënësve që përfitojnë nga ky shërbim është rreth 17 200 nxënës nga të cilët 7 830 vajza. Në konvikte përfitojnë nga ky shërbim 120 nxënës, 70 në konviktin e shkollës Industriale dhe 50 nxënës në konviktin e shkollës Artistike nga të cilët 4 janë vajza. Për krijimin e kushteve sa më të favorshme të akomodimit sipas standarteve në konvikte të nxënësve që mësojnë në shkollat profesionale të Bashkisë Shkodër, kemi bërë blerjen e materialeve mbështetëse në shërbim të konvikteve me materiale.

Në këtë kuadër gjatë qëndrimit të nxënësve në konvikte dhe tek shkolla Speciale 3 Dhjetori ku ofrohet shërbimi i mensës për 120 nxënës të konvikteve dhe 81 nxënës , 31 vajza të shkollës Speciale 3 Dhjetori kemi bërë blerjen e materialeve mbështetëse për kuzhinën (tenxhere të ndryshme, tepsi, pirunj pjata porcelani, gota qelqi tabaka grirëse, mbajtëse enësh, etj

Për mirëfukcionimin e procesit mësimor Bashkia mundëson këtë proces dhe me anë të ofrimit të mjeteve të kancelarisë për të gjitha shkollat. Është bërë blerja dhe shpërndarja në bazë të një grafiku të materialeve të kancelarisë të domosdoshme vetëm për shkollat e qytetit Shkodër. Furnizimi me këto materiale është realizuar përveç shkollave të qytetit edhe të atyre të njësive administrative duke ruajtur si kriter kapacitetet e shkollave që na dërgohen zyrtarisht nga Drejtoria Rajonale Arsimore.

Gjatë gjithë vitit 2018 Bashkia Shkodër ka punuar për ndërhyrjet dhe riparimet në shkolla , kjo për krijimin e kushteve sa më të favorshme në procesin edukativo- mësimor. Për realizimin e ndërhyrjeve janë përdorur materiale si: Brava dyer druri , reflektor gazi (për shkollat në qytet dhe në njësitë administrative kryesisht, konviktin e shkollës Industriale dhe për pak shkolla të qytetit) dryj, tuba dhe kthesa shporetit me dru, mjete pune të ndryshëm dhe një shumë rezervë për probleme të pa parashikuara të blerjeve nga shkollat dhe konviktet si furnëla gatimi, rafte metalike, pasije të ndryshme për riparim soba dhe reflektorëve me gaz, kërkesa të tjera për tuba kthesa të shporetëve, brava të modeleve të ndryshme për dyer dualumini. Gjithashtu, materiale hidraulike: Pompa uji copë , rubinete , problem që shfaqet vazhdimisht në shkolla nga dëmtimet e nxënësve, mishilatorë të ndryshëm, për tu përdorur në 2 konviktet, rezistenca dushi, shkarkues banjo, tuba të ndryshëm fleksibël (element që konsumohet nga të gjitha shkollat), vegla punë (çels hidraulik, pincë hidraulike)

për shkollat, konvikti Industriale, konvikti Artistike, rubinëte të natyrave të ndryshme, pjesë ndrimi për pompa uji dhe pompa që digjen nga përdorimi kur mungon uji në rrjet, tuba të ndryshëm fleksibël . Gjithashtu materiale elektike si: llampa të thjeshta, neon, portollampa e aksesori të tjetër të nevojshëm për përmirësimin e kushteve në ambientet e shkollave dhe konviktete.

Për të krijuar një situatë sa më normale të kushteve higjienike kemi vlerësuar nevojën e atyre materialeve që do mundësojnë mbajtjen në kushte higjienike normale ambientet shkollorë. Në realizimin e shpenzimeve për materiale pastrimi është marrë parasysh numri i fëmijëve dhe i klasave për çdo shkollë, 90 shkolla dhe 2 konvikte Nga këto 28 shkolla në qytet dhe 62 në Njësitë Administrative në mënyrë proporcionale.

Bashkia Shkodër, ka siguruar shërbimin e ngrohjes në shkolla. Një nga burimet me të cilat bashkia ofron këtë shërbim është ai me dru zjarri. Është realizuar ngrohje me dru zjarri, në 58 shkolla nga të cilat 5 shkolla në qytet dhe 53 shkolla në njësitë administrative. Përfitojnë këtë shërbim rreth 4311 nxënës nga të cilët 812 nxënës në shkollat qytete dhe 3499 nxënës në shkollat në njësitë administrative.

Nisur nga të dhënat e marra nga DAR për numrin e klasave, janë parashikuar shpenzimet për konsum gaz, për ngrohje. Sasia e llogaritur është bazuar në një konsum mujor për çdo ambient mësimor, me 15 kg (një bombol gaz) për 4 muaj në vit.

Gjithashtu Bashkia Shkodër ka ofruar dhe mbështetur gaz për gatim në 2 konvikte me 120 nxënës atë të shkollës Industriale me 70 nxënës dhe atë të shkollës Artistike me 50 nxënës, si dhe për shkollën Speciale 3 Dhjetori me 81 nxënës. në për një periudhë 9 mujore.

Burimi tjetër alternativ që Bashkia Shkodër ka ofruar për ngrohje është ai me naftë për kaldajat. Bashkia Shkodër ofron shërbimin e ngrohjes nëpërmjet sistemit të kaldajës për 6 shkolla dhe 1 konvikt. Shkolla Ali Laçej Shkolla Prenk Jakova Konvikti i Shkollës Prenk Jakova Shkolla Xheladin Fishta Shkolla Oso Kuka shkollës Speciale 3 Dhjetori,

Për automjetin është bërë grafiku i udhëtimit ditore dhe mbi bazën e gjatësisë së rrugës së përshkruar është bërë një përdhogeritje e konsumit për km. Duhet theksuar se automjeti është i prodhimit 1995. Është parashikuar shpenzime për mirëmbajtje ku do të përfshihen riparime të pjesëve xhenerike, aksesori si motorinë, pompë ujë, naftë, probleme elektrike dhe probleme të tjera që mund të dalin gjatë kryerjes së shërbimeve vjetore.

Për të kryer dokumentacionin e nevojshëm si siguracion, kolaudim dhe taksat e tjera përkatëse .

Është bërë pagesa për energjinë elektrike të konsumit për 90 shkolla nga të cilat 28 shkolla në qytet dhe 62 në Njësitë Administrative.

Është bërë pagesa për konsumin e ujit për 90 shkolla nga të cilat 28 shkolla në qytet dhe 62 në Njësitë Administrative.

Është bërë pagesa për internetin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, Konviktit të shkollës Prenk Jakova si dhe për Shkollën Speciale 3 Dhjetori.

Gjatë gjithë vitit Bashkia Shkodër ka punuar për ndërhyrjet dhe riparimet në shkolla , kjo për krijimin e kushteve sa më të favorshme në procesin edukativo- mësimor. Mirëmbajtja e ambienteve shkollorë, për të krijuar kushte normale në institucionet shkollorë

Shkolla Mati Logoreci me 282 nxënës, ku 135 janë femra. Amortizimi i tualeteve dhe nyjeve sanitare në tualetet e mësuesve

Shkolla Azem Hajdari Shkolla Pashko Vasa, Shkolla Ismail Qemali Shkolla Ruzhdi Daca , Shkolla Mati Logoreci, Shkolla 28 Nëntori

Rikonstruksioni I pjesshëm I tualeteve të shkollës Tring Smaili , Njësinë Administrative Rrethina

Shkolla Kullaj, Njësia Administrative Postribë

Shkolla Kuç Shkolla At Gjon Karma, Njësia Administrative Guri Zi

Shkolla Agim Tafili, Shkolla Sait Tagani, Tursh Njësinë Administrative Berdicë

P.9. F1.O2.A9 Ndërtim i dhomave të zhveshjes dhe tribunës pranë fushës sportive shkolla 28 Nëntori

Mungesa e dhomave të zhveshjes për zhvillimin e rregullt të edukimit fizik pranë kësaj shkolle, ishte një domosdoshmëri për realizimin e këtij projekti, meqense u realizua dhe ndërtimi I fushës sportive pranë kësaj shkolle. Mungesa e kësaj infrastrukture për 666 nxënës , nga të cilët 441 janë vajza. Shfrytëzimi i ambjenteve sportive të shkollës do të jetë jo vetëm gjatë orarit mësimor, por dhe jashtë tij. Krijimi i një ambjenti të ri prej 60m2

P.9.F1.O2.A10 Vendosja e radiatorëve dhe montimi/instalimi i kaldajës së shkollës Shejnaze Juka

Projekti parashikon instalimin i një centrali termik me dy kaldaja me fuqi 200kë secila. Instalimin e radiatorëve, në të gjithë objektin, të cilët nuk ishin të përfshirë në rikonstruksionit e përfunduar në vitin 2012. Ky projekti është në proces zbatimi dhe do të eliminojë ngrohjen dhe përdorim e gazit. Ngrohja do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 4159 m2.

P.9. F1.O2.A11 Vendosja e radiatorëve dhe montimi/instalimi i kaldajës së shkollës 28 Nëntori

Projekti parashikon instalimin i një centrali termik . Instalimin e radiatorëve, në të gjithë objektin,. Ky projekt është në proces zbatimi dhe do të eliminojë ngrohjen dhe përdorimin e gazit. Nga ky investim përfituan 666 nxënës , nga të cilët 441 janë vajza. Ngrohja do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 2750 m2

P.9. F1.O2.A12 Rikonstruksioni i çatisë shkolla Veli Tela Muriqan , NjA Ana Malit

Është realizuar rikonstruksioni i kapriatës prej druri i çatisë së objektit, dhe rivendosja e tjegullave betonike ekzistuese me qëllim largimin i pranisë së lagështirës në ambjentet e shkollës. Krijimi i një ambjenti me të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit për 82 nxënës nga të cilët 43 janë të gjinisë femërore. Ndërhyrja është realizuar në një sipërfaqe prej 675 m2.

P.9. F1.O2.A13 Rikonstruksioni i çatisë shkolla Haxhi Hajdari Golem NjA Rrethina

Realizimi I këtij projekti bëri të mundur shmangien e amortizimit të përgjithshëm të godinës si rrjedhojë e dëmtimit të plotë të terracës dhe çatisë së shkollës si dhe prania e lagështirë në ambjentet e brendshme nga dëmtimi i ulluqeve horizontale dhe vertikale , dhe shtresave hidroizoluese. Humbjet energjetike për shkak të mungesës së termoizolimit të soletës.

U realizuan, rikonstruksioni i plotë i shtresave hidroizoluese të terracës.

Zëvendësimi i plotë i ulluqeve ekzistuese dhe largimi i lagështirë anësore në muret e klasave të objektit.

Zevendësimi i çatisë prej llamarine me terracë me 2 shtresa katrama. Krijimi i një ambjenti me të përshtatshëm për zhvillimin e mësimin për 156 nxënës nga të cilët 75 janë të gjinisë femërore.

Ndërhyrja totale në një sipërfaqe prej 440 m².

P9.F2.O1 .A1. Mbështetja personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor

Me Ligjin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2018, janë akorduar fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit e Sportit të Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2018, të parashikuara me transfertë specifike. Numri i personelit gjithsej pranë Drejtorise kopshte çerdhe është 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) punonjës. Me transfertë specifike, numri i punonjësve të transferuar është 163 (njëqindgjashtëdhjetë e tre), me të ardhurat e bashkise 9 punonjës.

P9.F2.O2 .A1 Mbështetja për mirëmbajtjen e infrastruktures, shërbimet mbështetëse për fëmijet dhe stafin edukues në kopshte personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor

Në 6 kopshtet me drekë ("Bep Tusha", "Ton Alimhilli", "I.S.Bruçaj", "Guerrilie", "1 Qershori" dhe Edit Durham) frekuentohen nga 350 fëmijë. Për furnizimin me ushqime të këtyre kopshteve bazuar në fondin i planifikuar për shpenzime për ushqime është lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues e cili ka furnizuar me artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe blektoral kopshtet.

Për të patur ambjente sa më higjienike në kopshte janë shpenzuar për të blerë materiale pastrimi (detergjente të ndryshëm) për pastrimin dhe dizinfektimin e ambjentëve.

Sigurimi i bazës materiale në kopshte është domosdoshmëri për mbarevajtjen e punës. Për këtë arsye duke konstatuar situatën në kopshte është bërë e mundur blerja dhe furnizimi me karrige, tavolina për fëmijë, çarçafe, peshqire dhe batanije dhe enë kuzhine. Furnizimi është bërë në kopshtin 1 Qershori me karrige dhe krevata 30 cope krevata druri dhe 20 cope karrige druri. Në kopshtin "Bep Tusha", "Tom AliMhili" Kopshti "Shiroke", "Bahçallek" dhe "Ajasem" janë furnizuar me karrige dhe tavolina buke për fëmijë. Në kopshtet me drekë janë furnizuar me enë kuzhine, batanije, çarçafe e peshqire.

Për të bërë sa më të favorshëm qëndrimin e fëmijëve në kopshte janë shpenzuar për të blerë dru zjarri 195.mst për arsimin parashkollor me të cilat janë furnizuar kopshtet e qytetit dhe të fshatit: për kopshtin "Ton Alimhilli" 18.mst, për kopshtin "16 Shtatori" 18.mst, "1 Qershori" 12.mst, "Guerrile" 12 mst, "Veterinare" 6.mst, "Edit Durham" 14.mst, "Fetah Barbulushi" 7.mst, "Ajasem" 3.5.mst, "Zogaj" 3.5.mst dhe në rrethina 101.mst.

Po kështu është shpenzuar për të blerë naftë për kaldajën që është instaluar tek kopshti "Bep Tusha" me të cilën ngrohen fëmijet e këtij kopshti.

Faturat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë për godinat e kopshteve si më poshtë: "16 Shtatori", "Bep Tusha", "Ton Alimhilli", "Ismet Sali Bruçaj", tek "Veterinarja", "Shiroke" dhe "Guerrile" të cilat janë me linje dhe mates të veçanta janë likuiduar plotësisht..

Problemi kemi patur me faturimin e energjisë elektrike tek kopshti "Bep Tusha" 2 muajt e fundit i cili ka ardhur me një vlerë të madhe por të cilën e kemi ankimuar dhe jemi duke e ndjekur.

Meqenese ne disa kopsht per te gatuar perdoret gaz,per kete qellim eshte shpenzuar per te blere gaz gatimi.

Ndertesat e sistemit arsimor parashkollor per te qene sa me te pershtatshme dhe komode per arsimimin dhe edukimin e femijeve kane nevojë per mirembajtje, si lysterje me boje dhe riparime te ndryshme. Per kete qellim jane shpenzuar per te mirembajt kopshtin "Edit Duram" ku eshte bere hidroizolimi i tarraces se kopshtit.Eshte bere riparimi i rrjetit elektrik te Kopshtit "Bep Tusha", eshte bere mirembajtja e Kopshtit "Bahçallek : si vendosje çatije, hidroizolim dhe ulluk shkarkimi dhe eshte bere lysterja e disa kopshteve si kopshti Bep Tusha 350.m2 te lysterja kopshti "Azem Hajdari 170m2 te lysterja brenda dhe " 16 Shtatori" 272.m2 te lysterja brenda.

Per te pasur ambjente sa me higjenike, dhe te mbrojtura ndaj infektiveve te ndryshme eshte shpenzuar per dizinfektimin e ambjenteve te godinave .

Per mjetein i transportit qe furnizon me ushqime Çerdhet dhe Kopshtet jane shpenzuar per blerje karburant dhe shpenzime te tjera te tipit si siguracion,kolaudim, taksa dhe te tjera shpenzime transporti. P9.F2.O1.A4."Blerje paisje dhe orendi per arsimin parashkollor"

Jane blere paisje si frigorifere,fshesa me korrent,shporet per ngrohje,pompa uji,buliera dhe lavatrice per kopshtet si me poshte "Tom Ali Mhilli " 1 frigorifer,2 fshesa me korrent dhe 1 shporet per ngrohje.. Kopshti "1 Qershori" 1 fshese me korrent dhe 1 pompe uj,Kopshtit "Ismet Sali Bruçaj " 2 fshesa me korrent dhe 1 ariston.Kopshti "Guerrile 2 boliera uji dhe 1 pompe uji." Kopshti "Fetah Barbullushi 1 shporet per ngrohje. Kopshtit "Shiroke 1 ngrohës. Kopshtit "Bep Tusha 1 lavatrice 7 kg dhe 2 fshesa me korrent dhe 2 aristona etj.

P9.F2.O2.A2 "Rikonstruksion i pjesshem i kopshtit "Ismet Sali Bruçaj"

Eshte bere rikonstruksioni i kopshtit "Ismet Sali Bruçaj" si punime brendshme si sovitime punime tarrace, punime bojatisje dhe sistemim i jashtem.

P9.F2.O2.A4.Blerje furgoni per kopshte.

Sipas vendimit nr.55 dt.19.07.2018 "Per miratim shtese plani dhe rishperndarje te fondeve te buxhetit te Bashkise Shkoder" eshte bere e mundur blerja e furgonit te ri meqenese furgoni qe ka furnizuar me ushqime kopshtet dhe Çerdhet ishte shume i amortizuar dhe eshte nxjerre jashte perdorimit.

P9.F3.O1.A.1" Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë",

Festivali i zërave "Bilbilat e vegjël këndojnë" është iniciativë e QKF në Shkodër, 20 vjet më parë, në prill të vitit 1996 dhe lindi si shprehje e nevojës së fëmijëve të Shkodrës për të shpalosur talentin e tyre në fushën e interpretimit. Kjo veprimtari që në nisje angazhoi një numër shumë të madh fëmijësh, mësuesit e muzikës së tyre si dhe specialistë të vokalit të qytetit e më gjerë. Kjo veprimtari rezultoi e suksesshme, pasi formati i saj, në shkallë kombëtare u bë burim i disa veprimtarive të mëdha televizive. Bilbilat e vegjël, përveç talenteve ka shërbyer për promovimin e muzikës shqiptare për fëmijë duke u mundësuar mësimin e këtyre këngëve fëmijëve të mbarë qarkut Shkodër, përmes transmetimit televiziv, për një periudhë mjaft të gjatë, janar – prill.

Bilbilat e vegjël i shton çdo vit dhjetra zëra të rinj skenave lokale e kombëtare, si rrjedhojë ka nevojë për pasion, përkushtim, investim të përditshëm deri në detajet e vogla.

Edicioni i 23-të do të zhvillohet në katër faza ku do marrin pjesë rreth 2500 fëmijë nga të gjitha shkollat që administrojnë Bashkia Shkodër. Shkollat do paraqesin fëmijë që kanë talent e dëshirë, pa kufizim në numër të cilët do i nënshtrohen punës përgatitore dhe fazave seleksionuese nën udhëheqjen e specialistëve.

P9.F3.O1.A.2 Festivali 56-t Kombëtarë për fëmijë

Shkodra, djepi i këngës qytetare, më 10-11 maj 1963 me angazhimin e forcave krijuese të qytetit, organizoi festivalin e parë të këngës për fëmijë. Ditët e festivalit u bënë ditët e “gjallesës” të një “sedre tradicionale kulture” të qytetit, kurse jehona e tij i shtyu organizatorët të vazhdonin rrugën e nisur.

Festivali u bë kombëtar në vitin 1966. Me të u plotësua një boshllëk i ndjeshëm në edukimin muzikor të fëmijëve. Por krahas muzikës, Festivali u dha fëmijëve mundësinë të qëndronin së bashku. Shkodra u bë edhe një nga vendet më të dashura për fëmijët nga e gjithë Shqipëria. Emocionët e konkurimit i takonin skenës. Jashtë saj lindën njohje dhe miqësi të reja.

Vitet '90 shënuan risi të tjera. Edicioni i 31-të, në vitin 1992, përfshiu krijuesit dhe interpretuesit nga të gjitha trojet shqiptare, duke e kthyer Festivalin në Festival Mbarëshqiptar të Këngës për Fëmijë. Ai vijoi të jetë ngjarja artistike më e rëndësishme për fëmijë. Kënga iu përgjigj ndryshimeve, por ruajti veçantinë, fizionominë kombëtare dhe vlerat artistike.

Festivalet patën ngritje cilësore edhe në organizim: u rrit hapësira skenike me dekore të mëdha, u realizuan librete të zgjedhura e prezantime origjinale ; arti regjizorial synoi daljen në pah të lirshmrisë në interpretim dhe talentit të ekzekutuesve të vegjël.

Skena e këtij festivali në vite u bë rrugë për një shumicë këngëtarësh që u bënë të shquar dhe fushë veprimtarie për kompozitorë, skenaristë, autorë tekstesh, regjisorë, koreografë, skenografë, dirigjentë, instrumentues, orkestrues, mjeshtra vokali, etj.

P9.F3.O1.A3 Veprimtari masive, sportive, artistike e shkencore të Qendrës Kulturore të Fëmijëve

Qendra Kulturore e Fëmijëve organizon gjatë vitit, sipas kalendarëve të përcaktuar. disa veprimtari masive sportive, artistike e shkencore, mbi bazën të platformave që ndërton dhe ua shpërndan shkollave 9 vjeçare. Këto veprimtari gjallërojnë dukshëm sheshet, fushat sportive, palestrat dhe sallat që ka qyteti ynë. Nga më kryesoret veçojmë:

Kampionati i shahut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)

Kampionati i pimpongut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)

Kampionatet pranverore në Basketboll, Volejboll dhe Minifutboll femra dhe meshkuj në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 20 shkolla)

Zbavitimi me gjuhët e huaja

Kampionati i vrapimit në natyrë në mes shkolla 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)

Konkursi i fjalës artistike në mes shkolla 9 vjeçare (rreth 27 shkolla)

Konkursi zhvillohet në tre faza sipas kalendarit të përcaktuar.

Garë me biçikleta në mes kopshteve të qytetit

Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyre të cilët stimulohen.

Këto veprimtari ndiqen me shumë interes nga drejtuesit dhe tekniket e klubit shumësportesh “Vllaznia” që shënojnë dhe seleksionojnë, për të afruar në ekipet e këtij klubi më të talentuarit.

P9.F3.O1.A4 Veprimtaria me rrethet artistike sportive e shkencore

Q. K. e Fëmijëve e mbështetur nga Bashkia pjesë e së cilës ajo është tashmë, u organizua dhe me dashamirësinë e një grupi instruktorësh pasionantë në punën me fëmijët arriti të ruaj traditën gati 70 vjeçare të punës me disa nga rrethet jashtëshkollore më të kërkuara, me rezultate dhe të dashura nga fëmijët. Kjo veprimtari funksionon që me krijimin e këtij institucioni dhe ka përfshirë në çdo vit rreth 500 fëmijë të Shkodrës të talentuar në fushat respektive të cilët argëtohen, aftësohen dhe stërviten pranë kësaj qendre nga një grup specialistësh të artit, sportit e shkencës nga më të mirët që zhvillojnë aktivitetet në qytetin tonë. Nga kjo veprimtari e suksesshme në vite kanë dalë figura të spikatura të artit e sportit dhe shkencës që kanë shkëlqyer në skenat dhe fushat sportive kombëtare e më gjërë.

P9.F3.O1.A5 Mbremja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 – vjeçare

Mbrëmja tradicionale e vitit të ri ka një traditë më shumë se 60 vjeçare, realizuar pa ndërprerje çdo vit nga QKF në fund të muajit dhjetor, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër. Ajo stimulon nxënësit e talentuar pa dallime, që zgjidhen nga shkollat, DAR-i dhe stafi i QKF.

Kjo mbrëmje shërben si premierë e talenteve të humorit, këngës, baletit dhe aerobisë së QKF dhe si stimulim i nxënësve më të mirë të qytetit; (stimulohen rreth 70 nxënës të dalluar të ciklit të ulët të shkollave 9 vjeçare dhe 130 artistë dhe sportistë të vegjël).

Fondet e financimit të programeve

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

Fondet e miratuara sipas planit të korigjuar, për këtë program janë 369520 mije lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 359 053 mije në masën 97 % ndaj planit vjetor të korigjuar.

Shpenzimet Operative janë realizuar në masën 86774 mije lekë nga 93433 mije lekë sipas planit vjetor të korigjuar Realizimi 93%.

Transferta janë realizuar në masën 8316 mije lekë nga 8447 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 98 %.

Investimet janë realizuar në masën 24473 mije lekë nga 30608 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 80%

Pagat dhe sigurimet shoqerore janë realizuar në masën 232703 mije leke nga 237622 mije leke të planifikuara, realizimi është në masën 98%

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Plani korrigjuar	Realizimi VITI 2018 në mijë lekë
P9.F1.O1.A1 Pagat dhe sigurime shoqerore per punonjesit e arsimit	130867	118664	116634
P9.F1.O1.A2 Blerje materialesh (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve.	100	100	83
P9.F1.O1.A3 Blerje ene kuzhine per konvikte dhe shkoillen Speciale	80	80	57
P9.F1.O1.A5 Blerje materiale kancelarie per sistemin arsimor parauniversitar	850	850	826
P9.F1.O1.A6 Blerje materiale te ndryshme per sherbimet mbeshtetese per sistemin arsimor parauniversitar	710	710	515
P9.F1.O1.A7 Blerje pjese kembimi per mirembajtjen e sistemeve hidraulike te sistemit arsimor parauniversitar	560	361	319
P9.F1.O1.A8 Blerje materiale pastrimi ambientesh	1,880	1,788	1788
P9.F1.O1.A9 Blerje dru zjarri per ngrohje per sistemin e arsimit parauniversitar.	13400	13400	9551
P9.F1.O1.A9 Blerje gaz te lengshem per ngrohje per sistemin arsimor parashkollor dhe sistemin arsimor parauniversitar.	5900	3100	2417
P9.F1.O1.A10 Blerje lende djegese karburante per ngrohje dhe per mjete transporti(nafte +benzine).	2090	1408	1378
P9.F1.O1.A11 Riparim paisje orendi	100	100	80
P9.F1.O1.A12 Mirembajtje e mjeteve te transportit per sherbimet mbeshtetese te sistemit arsimor parauniversitar dhe sistemit arsimor parashkollor.	200	100	67
P9.F1.O1.A13 Furnizim me energji elektrike, uje, Sherbime postare , Sherbim interneti per te gjitha shkollat ne territorin e Bashkise.	19075	24947	24947



P9.F1.O1.A15 Blerje xham per mirembajtjen e dritareve te godinave te sistemit arsimor	290	290	289
P9.F1.O1.A16 Blerje bojrash per mirembajtjen e godinave te sistemit arsimor	290	290	277
P9.F1.O1.A17 Blerje materialeve per mirembajtjen e rrjeteve elektrike te godinave te sistemit arsimor	600	478	478
P9.F1.O1.A18 Mirembajtje e zakonshme e objekteve arsimore	7150	8150	7878
P9.F1.O1.A19 Sigurimi I objekteve per raste te ngjatrjve te jashtezakonshme per zjarr dhe termete	720	720	716
P9.F1.O1.A20 Dizinfektimi I mjediseve te objekteve te sherbimeve mbeshtetese	100	100	99
P9.F1.O2.A21 Mbeshtetje per mirembajtjen e infrastructures sherbimeve mbeshtetese per nxenesit dhe stafin mbeshtets ne shkolla	4,805	4,805	3717
P9.F1.O2.A9 Ndertim I dhomave te zhveshjes dhe tribunes prane fushes sportive shkiolla 28 nentori	3,636	2,035	2001
P9.F1.O2.A10 Vendosja e radiatoreve dhe montimi/ instalim I kaldajes se shkolles Shejnaze Juka	5500	6396	6128
P9.F1.O2.A11. Vendosja e radiatoreve dhe montimi/ instalim I kaldajes se shkolles 28 Nentori	3200	4590	4272
P9.F1.O2.A12. Rikonstriksion I catise se Shkolles Veli tela Muriqan	2600	2107	2107
P9.F1.O2.A13. Rikonstriksion I terraces se Shkolles Haxhi Hajdari te Fshatit Golem	2200	1933	1727
P9.F2.O1 .A1. Mbështetja personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor	122 994	123237	122478
P9.F2.O1 .A4 Blerje pajisje orendi (shporeta,lavatriçe,frigorifer.aristona,pompaujiti ,fshesa me korrent,shporet per ngrohje etj.	500	500	495
P9.F2.O2.A1 Mbështetja per mirembajtjen e infrastructures, sherbimet mbeshtetese per femijet dhe stafin edukues ne kopshtepersonelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor	22 769	22769	22030
P9.F2.O2.A2 Rikonstrukcion i pjesshem i kopshtit "Ismet Sali Bruçaj"	2 931	2931	2878
P9.F2.O2.A3 Rikonstrukcion i godines se kopshtit "Guerrile"	2886	2886	0
P9.F2.O2.A4 Blerje mjet transporti (furgon)	1.200	1200	1147
P9.F3.O1 .A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	410	410	407



P9.F3.O1 .A2 Festivali i 55-t mbarëkombëtar për femije	4500	4500	4299
P9.F3.O1.A3 “Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) te Qendres Kulturore te Femijeve.	280	280	263
P9.F3.O1.A4 “Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore per vitin 2018”	972	972	972
P9.F3.O1A5 Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri per nxënësit e shkollave 9 vjeçare.	445	445	445
TOTALI	207,403	370,110	352,266

P.10 Strehimi dhe Shërbimet Sociale

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.

Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

Spektori i Përfshirjes Sociale, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.

Spektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale, dhe Shëndetin Publik.

Shërbimet me bazë komunitare të krijuara gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 12 qendra komunitare; 6 në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave dhe Shalës. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Në vitin 2018, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, është arritur inagurimi dhe vënia në funksion e Qendrës së parë Rinore Publike në territorin e bashkisë së Shkodrës. Kjo qendër i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj. Gjithashtu, në vitin 2018 është inaguruar qendra komunitare multifunksionale, e cila do të ofrojë shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian, por sigurisht do të jetë një qendër e gatshme dhe në shërbim të komunitetit të zonës. Kjo qendër u ndërtua në kuadër të bashkëpunimit me UNDP në zbatimin e projektit FSERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale”.

Gjithashtu gjatë vitit 2018, kanë filluar punimet për rikonstruksionin e godinës së ish shkollës dhe krijimin e qendrës komunitare “Për Familjen” në njësinë administrative Rrethina, Shtoj i Vjetër.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, ligjit 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse, Ligjit nr. 22/2018 “ Për strehimin Social”, veprimtaria e Drejtorisë është bazuar në katër funksione kryesore të ndara sipas objektivave specifike:

- F1. Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, për personant me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit, etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- F3. Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

F4. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.

F1.O1. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshë, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

F2.O1. Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat e komunitetit.

F2.O2. Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe Politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.

F2.O3. Partneritetet e ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

F2.O4. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.

F2.O5. Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

F3.O1. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative.

F3.O2. Krijimi i qendrës komunitare rinore për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.

F4.O1. Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër.

F1.O1.A1 Projektim dhe nderhyrje në infrastrukture me synim përmirësimin e jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian.

Gjatë vitit 2018, është realizuar vlerësimi i infrastruktures dhe hapësirave për krijimin e administrimit e ujërave të zeza, ËC, etj. dhe vazhdon puna për projektimin e tyre.

F1.O1.A1/1 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizura.

Është realizuar vlerësimi mbi infrastrukturën e banimit dhe gjithashtu kostimi i ndërhyrjeve me synim përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian. Gjithashtu në vitin 2018, Bashkia

e Shkodrës ka aplikuar, fituar dhe filluar zbatimin e projektit “Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë në lagjen “Mar Lula”

Gjatë vitit 2018 ka filluar zbatimi i projektit për ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë në lagjen “Mar Lula”. Projekti synon ndërtimin e rrjetit me ujë të pijshëm të zonës informale “Mar Lula” e cila ndodhet në periferi të Shkodrës dhe hap rrugën për procesin e formalizimit të kësaj zone. Projekti i ndërtimit të rrjetit të zonës “Mar Lula” ka një vlerë totale 19,269,483 lekë . Bashkfinancimi i Bashkisë Shkodër është 4,048,800 lekë. Zbatimi i projektit do realizohet gjatë 2 viteve 2018-2019. Vlera e fondit për 2018 është 7933 (mijë lekë) dhe është realizuar në masën 100 %.

Nga ky projekt do të përfitojnë 3000 banorë nga të cilët rreth 100 janë banorë të komunitetit rom.

F1.01.A2 Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.

Ka përfunduar rikonstrukcioni i plotë i banesave sociale me qera të ndërtuar pranë ish konviktit të shkollës pyjore, për strehimin e kategorisë së jetimëve dhe familjeve një prindërore në situatë të vështire social ekonomike. Është realizuar vlerësimi i kushteve social ekonomike i jetimëve që jetojnë në konviktet e shkollave. Jemi në pritje të miratimit të ndryshimit të destinacionit të godinës nga Këshilli i Ministrave dhe po punohet për realizimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen dhe miratimin e përfituesve duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të ligjit të ri nr. 22/2018 “ Për strehimin Social” që ka hyrë në fuqi në Nëntor 2018.

Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.

Sfidë tjetër është aspekti menaxherial dhe bashkërendues i punës në këto banesa sociale me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si premisë e rëndësishme për fuqizimin e personave të sistemuar aty, duke synuar një përfshirje sociale më të gjerë.

F1.02.A1. Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.

Në përmbushje të përgjegjësisve ligjore për zbatimin e politikave të strehimit sipas programeve sociale të strehimit ka krijuar një bazë të dhënash për aplikimet e bëra për programet sociale të strehimit.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për strehim bazuar në aplikimet e administruara në databazën për strehimin.

Njëkohësisht janë vlerësuar asetet në pronësi të Bashkisë së Shkodrës me qëllim vënien në dispozicion të projekteve për të financuar realizimin e ndërtimit të banesave për strehim social. Është planifikuar një fond i veçantë nga buxheti i Bashkisë Shkodër për mbështetjen e realizimit të programit social të strehimit të bonusit të strehimit.

Janë evidentuar sipërfaqet e trojeve të ndërtimit për zbatimin e programeve sociale të strehimit dhe konkretisht janë planifikuar 8 njësi strukturore të planifikuar për strehim. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të investimeve janë planifikuar disa projekte të përmirësimit të kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara.

Po punohet për realizimin e procedurave ligjore për zbatimin e programeve të strehimit duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të ligjit të ri nr 22/2018 “ Për strehimin Social” që ka hyrë në fuqi në Nëntor 2018.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”.

F1.O2.A2. Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom & Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës.

Është realizuar vlerësimi mbi infrastrukturën e banimit dhe gjithashtu kostimi i ndërhyrjeve me synim përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian. Është realizuar shkrimi i draftit final mbi studimin vlerësues të kushteve të banimit të komunitetit rom e egjiptian, dhe kostifikimit të nevojave për ndërhyrje, në bashkinë e Shkodrës. Studimi vlerësues i kushteve të banimit të komunitetit rom e egjiptian, dhe kostifikimi i nevojave për ndërhyrje, në Bashkinë e Shkodrës është i gatshëm.

F2.O1.A1 Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Shtrirja e shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Skuadra të terrenit, të përbëra nga punonjës të qendrave komunitare “Për Familjen” dhe policë Bashkiakë, funksionale në zonat kryesore ku janë identifikuar fëmijë në situatë rruge; në zonën urbane të Bashkisë së Shkodrës, në pikën kufitare Muriqan dhe në plazhin e Velipojës në njësinë Administrative Velipojë. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge dhe mbështetur është 100 dhe numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura është 40.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për fëmijët në situatë rruge, në bashkëpunim me DAR, Drejtorinë Vendore të Policisë dhe organizatat partnere është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues me slogan “Mos dhuro para, dhuro kujdes”.

F2.O2.A1. Ndihma ekonomike dhe PAK.

Në zbatim të Vendimit Nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e kriterëve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin janar 1805 familje, nga te cilat: 1623 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 182 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin shkurt 1557 familje, nga te cilat: 1401 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 156 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin mars 1821 familje, nga te cilat: 1639 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 182 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Prill 1777 familje, nga te cilat: 1603 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 174 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Maj 1757 familje, nga te cilat: 1585 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 172 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Qershor 1724 familje, nga te cilat: 1552 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 172 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Korrik 1747 familje, nga te cilat: 1576 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 171 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Gusht 1764 familje, nga te cilat: 1593 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 171 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Shator 1897 familje, nga te cilat: 1691 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 206 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Tetor 2002 familje, nga te cilat: 1777 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 225 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Nentor 2031 familje, nga te cilat: 1801 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 230 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Në muajin Dhjetor 2079 familje, nga te cilat: 1845 familje jane trajtuar nga sistemi elektronik kombetar dhe 234 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri ne 6%.

Nr. i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë në muajin janar 4114, në shkurt 4175, në mars 4181, në prill 4135, në maj 4148, në muajin qeshor 4149, në muajin korrik 4135, në muajin gusht 4150, në muajin shtator 4117, në muajin tetor 4152, në muajin nëntor 4177 dhe në muajin dhjetor 4218.

Nr. i invalidëve të punës trajtuar me shtesë kempit ka qenë në muajin janar 3377, në shkurt 3371, në mars 3390, në prill 3381, në maj 3366, në muajin qeshor 3388, në muajin korrik 3353, në muajin gusht 3328, në muajin shtator 3299, muajin tetor 3331, muajin nëntor 3360 dhe në muajin dhjetor 3387.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore janë realizuar fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror si më poshtë:

			Plani Vjetor V.2018	Fakti Vjetor V.2018	Diferenca
1.Ndihma	Ekonomike	Lek	123.140.000	113.265.792	+ 9.874.208
2.Paaftesia total		Lek	778.350.000	772.556.821	+ 5.793.179
3.Shperblimet e fund vitit		Lek	-	15.657.000	- 15.657.000
TOTALE		Lek	901.490.000	901.479.613	+ 10.387

Duhet të theksojmë faktin që detyrimi i mbetur në dhjetor të vitit 2017 në shumën 10.020.160 lekë për kategorinë " kujdestare të paaftëve" është shlyer me datën 10 janar 2018 me çeljen e fondeve të reja të vitit kalendarik 2018, shumë kjo e përfshirë në totalin 772.556.821 lekë të pagesave të PAK .

Për vitin 2018 janë kryer pagesat sipas skemës së re të Ndihmës Ekonomike për të 12 muajt e vitit me një diferencë prej 913 400 lekë për mungesë fondi.

F2.02.A2. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit, dhe janë planifikuar aktivitete në zbatim të kësaj marrëveshjeje. Gjatë vitit 2018 janë realizuar 3 takime të tryezës teknike për rastet e dhunës në familje dhe 2 takime të tryezës së Komitetit Drejtues. Gjithashtu janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat.

F2.02.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

Gjatë javës së familjes, janë organizuar 7 aktivitete sensibilizuese me qëllim promovimin e vlerave të familjes dhe shërbimeve që ofrohen në fuqizim të familjes biologjike, promovimit të shërbimeve alternative me qëllim deinstitutionalizimin dhe parandalimin e institucionalizimit. Aktivitetet janë zhvilluar në qendrat komunitare "Për Familjen" nr 3, 4, 5 e në Dajç dhe gjithashtu në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç. Nr. i pjesëmarrësve në këto aktivitete ka qenë 350.

F2.02.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë

12 studentë; 11 të nivelit bachelor dhe 1 i nivelit master

Po zhvillojnë praktikën profesionale pranë shërbimit social dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare.

F2.02.A5. Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës.

Bashkia Shkodër, ka vazhduar të punojë në mënyrë të qëndrueshme për trajtimin e qenve endacakë (sterilizim, kastrim, dehelmintizim, vaksinim, matrikullim dhe rregjistrim). Me anë të këtyre ndërhyrjeve të synohet të ndikojmë drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit publik dhe situatës së krijuar nga prania e qenve endacakë.

Për vitin 2018, është realizuar procesi KSVL (Kap, Sterilizo, Vaksino, Lësho) i trajtimit të 170 qenve endacakë në fazën e parë dhe 330 qenve të tjerë në fazën e dytë, proces i cili po kryhet në bashkëpunim me Fondacionin StrayCoCo dhe shoqatën Pro Qen Albania.

Sa i përket krijimit të një institucioni mikpritës (Strehëza) që do të luante rolin e një qendre, e cila do të ofronte shërbime veterinarë si vaksinimi, sterilizim/kastrimi, dehelmintizimi dhe kafshët do të ishin nën kujdesin konstant të mjekeve veterinerë, grupimeve të vullnetarëve dhe studentëve, gjë e cila nuk është realizuar ka një sërë arsyesh të tilla si :

Mungesa e një asemi të bashkisë Shkodër me infrastrukturën e nevojshme për përshtatje për krijimin e strehëzës.

Mungesa e financimeve të plota për ndërtimin, vënien në funksion të saj dhe mbulimin e kostove për ushqyerjen dhe mbajtjen e qenve në të.

Kundërshtimet e OJF-ve animaliste që operojnë në territorin e bashkisë Shkodër dhe jo vetëm.

Strehëzat nga ana tjetër është vërejtur që nuk reduktojnë numrin e qenve endacakë, motivojnë njëriëit për të mos pasur kujdes ndaj tyre, janë burim i përhapjes së sëmundjeve infektive si dhe mirëmbajtja e tyre në kushtet e nevojshme higjeno-sanitare dhe të trajtimit human të qenve ka kosto shumë të madhe, kosto kjo e papërbalushme për buxhetin e bashkisë Shkodër.

Në këtë mënyrë Bashkia Shkodër në bashkëpunim me fondacionin zvicerian StrayCoco, shoqatën Pro Qen Albania dhe grupimin vullnetar Animals Need Me ka vazhduar bashkëpunimin për realizimin e procesit KSVL (Kap, Sterilizo, Vaksino, Lësho) të trajtimit të 170 qenve endacakë në fazën e parë dhe 330 qenve të tjerë në fazën e dytë.

Pavarësisht punës së realizuar përgjatë këtyre viteve problemi i qenve endacakë vazhdon të mbetet shqetësues, ndaj nevojitet edhe ndërgjegjësimi dhe përfshirja e komunitetit për minimizimin dhe përmirësimin e problemit.

F2.O2.A6. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Gjatë këtij viti, është përmbyllur puna për hartimin dhe përgatitjen e planit të veprimit gjinor si aktiviteti i parë në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017. Dokumenti përfundimtar është prezantuar dhe miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, me datë 20.12.2018.

F2.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.

Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile.

Janë realizuar 18 takime konsultative me organizatat partnere. Pjesëmarrëse kanë qenë 19 organizata.

F2.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë organizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese me fëmijët dhe për fëmijët. Në rrugët kryesore fëmijët kanë shpërndarë mesazhe sensibilizuese për respektimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu në qendrat komunitare janë organizuar takime dhe aktivitete me rastin e kësaj dite.

F2.03.A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve.

Në ditën botërore të të moshuarve, pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 4, është zhvilluar një tryezë diskutimi me të moshuar, ku fokusi i këtij ka qenë diskutimi mbi nevojat e moshës së tretë dhe mundësitë që ofrohen në territor për këtë moshë.

Nevojat për kujdes social për të moshuarit janë gjithnjë në rritje dhe kjo është një nga sfidat tona, të familjes, të institucioneve publike, shoqërisë civile dhe të komunitetit, për të krijuar sa më shumë kushte e mundësi sociale që të jetojnë me dinjitet moshën e pleqërisë. Në këtë kuadër, të moshuarve iu prezantuan shërbimet që do të ofrohen pranë qendrës komunitare “Për Familjen”, nga Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar të cilat konsistojnë në; informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë; ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj.

F2.03. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi Ndryshe, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi ndryshe në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore .

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues. Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve Para& Tetraplegjikëve të Shqipërisë- dega Shkodër, kanë organizuar një aktivitet sensibilizues me personat me aftësi ndryshe, në mjediset e palestrës së shkollës “Ali Laçej”. Në bashkëpunim me këtë organizatë po punojmë për të ofruar sa më shumë shërbime për njerëzit me aftësi të veçantë, për promovimin dhe mundësimin e zhvillimit të aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive për personat me aftësi ndryshe, për gjithpërfshirje dhe integrim. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi ndryshe në fusha të ndryshme të jetës.

F2.03.A6. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues për të Drejtat e Fëmijëve. Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, shkollat 9 vjecare dhe organizatat partnere të shoqërisë civile ka organizuar aktivitetin social, kulturor, sensibilizues me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve. Ky aktivitet u organizua në lulishten pranë Bexhistenit dhe ishin pjesëmarrës rreth 100 fëmijë.

F2.03.A7. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi

U realizua një fushatë ndërgjegjësuese e shtrirë përgjatë të gjithë javës e quajtur “Java e gruas”.

Në kuadër të 8 Marsit, gjatë të gjithë javës janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin, me shoqërinë civile, me institucionet rajonale. Aktivitetet janë zhvilluar në institucionet kulturore, si Muzeu

Historik "Oso Kuka", Muzeu i Dëshmisë dhe Kujtesës, Biblioteka "Marin Barleti", etj., në qendrat komunitare "Për Familjen".

Synimi i kësaj fushate ka qenë promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

F2.O3.A8. Bashkëpunimi me Save the Children

Në vazhdim të vitit të tretë të zbatimit të aktiviteteve të parashkuara në Marrëveshjen me Save The Children, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuëse për shërbimet alternative me qëllim parandalimin e institucionalizimit dhe deinstitutionalizimin e fëmijëve.

Po zbatohen aktivitete në mbështetje për familjet biologjike me synim parandalimin e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre. Gjatë këtij viti, 28 familje kanë përfituar shërbime parandaluese dhe fuqizuese me synim rritjen e fëmijëve pranë familjeve biologjike.

F2.O3.A9. Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Bashkia e Shkodrës ka arritur marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën "Shpresë për botën", për mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjes, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit.

Në zbatim të marrëveshjes së arritur është përmirësuar cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Në shtëpinë e fëmijës 6 – 18 vjec është inaguruar salla për aktivitete sportive dhe kulturore për fëmijët që jetojnë në këtë institucion dhe jo vetëm. Gjatë vitit janë realizuar 12 aktivitete në bashkëpunim me këtë organizatë. Gjithashtu në prag të festave të fundvitit, janë organizuar një sërë aktivitete kulturore me fëmijët dhe përfituesit pranë institucioneve dhe janë shpërndarë dhurata për të gjithë.

F2.O3.A10: Dita ndërkombëtare e romëve

Në kuadër të kësaj dite, janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuëse me pjesëmarrje të gjerë nga komuniteti, institucionet dhe organizatat. Synimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian.

Në shkollën "Salo Halili" është organizuar aktiviteti ndërgjegjësuë, social-kulturor ku morën pjesë përfaqësues nga komuniteti rom, përfaqësues të organizatave partnere ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore. Theksi i këtij aktiviteti ishte edukimi dhe frekuentimi i shkollës për fëmijët rom. Gjithashtu në bibliotekën "Marin Barleti" është zhvilluar një takim me fëmijët rom dhe me shkrimtarin për fëmijë Xhahid Bushati, i cili i foli fëmijëve për rëndësinë e librit gjatë të gjithë jetës. U zhvillua një javë aktivitete ku u dhuruan libra dhe lodra për fëmijët rom.

F2.O3.A11. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."

Në vazhdim të vitit të dytë të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Marrëveshjen me Sos Fshatrat e Fëmijëve, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuere me synim fuqizimin e familjes së fëmijëve në rrezik institucionalizimi dhe fëmijëve të institucionalizuar për parandalimin dhe deinstitutionalizimin e tyre.

Gjatë këtij viti, janë realizuar 5 aktivitete në bashkëpunim me Sos, Fshatrat e Fëmijëve dhe nr i përfituesve është 320.

F2.O4.A2 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian. Është arritur punësimi i 18 personave të komunitetit rom dhe egjiptian dhe janë referuar për përfitim të kurseve profesionale, ku vetëm 5 kanë shfaqur interes dhe po ndjekin kurset. Janë përfunduar 2 procedura për ndarje nga trangu familjar dhe një tjetër aktualisht është në proces. Në tetor është inaguruar qendra e re multifunkionale për komunitetin rom dhe egjiptian. Kjo qendër është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve gjatë këtij viti është 300. Gjithashtu gjatë këtij viti është planifikuar dhe projektuar ndërhyrja e tretë infrastrukturore, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE; rikonstruksioni i kopështit “Guerrile”.

F2.O4.A3. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit

Për vitin 2018 është përgatitur dhe realizuar e gjithë procedura e nevojshme për lëvrimin e shpërblimit të jetimëve e dalë nga strukturat rezidenciale, me rastin e festive të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive. Fond i planifikuar është 400 mijë lekë e realizuar kjo në masën 100%.

F2.O4.A4. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ

Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar faza e parë e punimeve për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu janë realizuar punimet për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve.

F2.O4.A5. Plani I zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian

Në zbatim të planit të zhvillimit janë realizuar dhe ofrohen shërbimet në mbështetje dhe fuqizim të komunitetit rom dhe egjiptian.

Rreth 50 fëmijë të komunitetit rom frekuentojnë rregullisht shkollën, 10 të rinj janë përfitues të klasave të analfabetizimit, 2 familje janë mbështetur nga mikroiniciativat për biznes, rreth 50 fëmijë kanë marrë pjesë në kampin veror të organizuar nga Bashkia e Shkodrës.

F2.O5.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndeteshëm

Gjatë vitit 2018, janë realizuar 12 tema të shëndetit bazuar në ditët ndërkombëtare, si: Kanceri i qafës së mitrës, Kanceri “Ne mundemi, unë mundem”, Fëmijët dhe higjiena e gojës, Autizmi, Aktiviteti fizik tek fëmijët dhe adoleshentët, Obeziteti, Kanceri i gjirit, Dhuna me bazë gjinore, Shëndeti riprodhues dhe seksual, Hiv/Aids, Moshimi, Larja e duarve etj. Këto tema janë prezantuar në 58 takime të organizuara në qendrat komunitare “Për Familjen”, në shkolla, në zonën urbane dhe në njësitë administrative Dajç, Guri i Zi, Postribë, Ana e Malit dhe Bërdicë. Numri i përfituesve është rreth 1110.

F2.O5.A2 Projektimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor

Bashkia e Shkodrës tashmë ka krijuar një database të qendrave shëndetësore parësore të gatshme, me të dhënat aktuale dhe nevojat për ndërhyrje. Pjesë e këtij database i cili është në përditësim të vazhdueshëm, është projektimi dhe përmirësimi i kushteve të qendrave shëndetësore në territor. Aktualisht është në proces ndërtimi i dy qendrave të reja në territorin e bashkisë, një në lagjen nr. 4 të qytetit dhe një në Shtoj të Vjetër, Njësia Administrative Rrethina. Gjithashtu pritet të fillojnë punimet për ndërtimin e një qendre të re. Aktualisht në bashkinë e Shkodrës janë 14 qendra funksionale. Gjatë vitit 2018 kanë marrë shërbim në qendrat shëndetësore rreth 173029 individë.

F3.O1.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Sociale Komunitare “Për Familjen”

Gjatë kësaj periudhe janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Gjithashtu është realizuar krijimi i qendrave të reja në njësitë administrative dhe ndërkohë po punohet për ngritjen e shërbimit lëvizës në Njësitë administrative Shosh e Pult.

Sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, gjatë kësaj periudhe janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Gjithashtu është realizuar krijimi i qendrave të reja në njësitë administrative dhe ndërkohë po punohet për ngritjen e shërbimit lëvizës në Njësitë administrative Shosh e Pult. 12 Qendra Komunitare “Për Familjen” të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet.

Ne totalin e shpenzimeve për qendrat komunitare realizimi në total është 78 %. Janë realizuar pagat me rreth 79 %, shpenzimet operative me rreth 47 % dhe investimet me rreth 99.6 %.

F3.O1.A2 Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 4 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 155.

„Shpenzime per paga e sigurime“

Fondi i planifikuar per mbulimin e shpenzimeve ne paga eshte 22.819 .mije leke dhe realizimi paraqitet ne vleren 22.421 mije leke dhe fondi i planifikuar per sigurime shoqerore eshte 3.758.mije leke dhe realizimi paraqitet ne vleren 3,752.mije leke.

„Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera“

Fondi i planifikuar per kete ze eshte 8.541.mije leke dhe realizimi i ketij artikulli paraqitet me vleren 8.193.124 mije leke

Ne zerin“Materjale zyre dhe te pergjithshme“ „ realizimi eshte 45.mije leke,kjo vlere perfaqson shpenzimet qe jane bere per blerje kancelarie.

Ne zerin „Materjale per pastrim ngrohje dhe ndriçim“ realizimi perfshin vleren 821.mije nga 900.mije leke qe ishin planifikuar per te blere materjale pastrimi, gaz per ngrohje e gatim.

Ne zerin „Materjale dhe sherbime speciale“ realizimi eshte 4479.mije leke nga 4.560 mije leke qe ishte planifikuar..Ne kete vlere perfshihet shuma prej 4299.mije leke qe perfaqson realizimin e „Kontrates se Furnizimit me Ushqime“ si dhe shuma prej 180.mije leke qe perfaqson realizimin e „Blerjeve te materjaleve te tjera „si batanije,ene guzhine etj .

-Ne zerin „Sherbime nga te trete“ realizimi eshte 2.124.mije leke.Kjo vlere e perfaqson faturat e energjise elektrike qe perfshin shumen prej 941 mije leke, faturat e konsumit te ujit me vlere prej 838 mije leke dhe faturat e pageses se internetit prej 43.mije leke.Ne kete shume perfshihet realizimi i blerjeve te druve te zjarrit me nje vlere prej 262.mije leke dhe sherbimi per dizinfektimin e ambjenteve te Çerdheve me vlere prej 40.mije leke

Ne „Zerin „Shpenzime Transporti“ .realizimi perfshin vleren prej 200.mije.leke ne te cilen perfshihet shpenzimet qe jane bere per blerje karburanti.

Ne zerin “Mirembajtje e zakonshme” fondi i planifikuar prej 550 mije leke eshte realizuar ne masen 95% me nje vlere prej 524 mije leke ku perfshihet vlere prej 489.mije qe perfaqson realizimin e “Mirembajtjese ndertesave (lyerjes me boje) si dhe vlerat perj 35 mije leke qe perfaqsojne shpenzimet qe jane bere per mirembajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike.

3. Ne zerin “Investime” fondi planifikuar prej 400.mije lekë është realizuar në vlerën 400 mijë lekë. Tek kjo vlerë përfshihet shuma prej 240 mijë lekë që janë përdorur për të blerë: soba me dru , fshesa me korent, shporete gatimi,pompe uji dhe boliere ,vlera prej 100mije lekë është shpenzuar për të blerë paisje për sistemin e sigurisë dhe 60 mije lekë për blerje kompjuteri.

F3.O1.A3. Shërbime alternative per femijet dhe familjen.

Gjatë kësaj periudhe, janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve të mundshme që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim, deinstitutionalizimin e tyre.

Sa i përket shërbimit të kujdestarisë familjare, janë organizuar 5 takime informuese dhe ndërgjegjësuese me komunitetin, mbi shërbimin e kujdestarisë familjare, ku janë shpërndarë materialet promovionale të përgatitura posacërisht për këtë shërbim. Gjithashtu kemi 12 familje kujdestare me lidhje gjaku, nga ku janë 5 fëmijë të deinstitutionalizuar, të marrë në kujdestari nga familjarët. 1 familje kujdestare pa lidhje gjaku. Në proces janë 3 raste kujdestarie; 2 me lidhje gjaku dhe një pa lidhje gjaku.

F3.01. A4. Nderhyrje te integruara per perfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik te femijeve dhe te rinjve.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Acli Ipsia për projektin Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” po zbatohen aktivitetet si; kurse të rikuperimit shkollor, edukimit të autonomisë dhe bashkëjetesës për jetimët që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe atyre që kanë dalë nga këto institucione, pas moshës 18 vjeçare.

Gjatë vitit 2018 ka filluar dhe është në proces zhvillimi i kurseve të rikuperimit shkollor ku marrin pjesë 11 të rinj dhe fëmijë që jetojnë në shtëpinë e fëmijës shkollor 6-18 vjeç, zhvillimi i kursit të autonomisë ku përfitues janë 19 fëmijë që jetojnë në shtëpinë e fëmijës 6-18 vjeç, zhvillimi i kursit të kuzhinës ku përfitues janë 9 jetimë, zhvillimi i kursit të gjuhës së huaj (anglisht) ku përfitues janë 44 fëmijë përkatësisht 9 nga shtëpia e fëmijës shkollor 6-18 vjeç, 9 nga fshati Grudë, 15 nga Vinoteka dhe 11 të rinj jetimë që jetojnë në shtëpinë familje Ravasco. Gjithashtu po zhvillohet edhe kursi i informatikës ku përfitues janë 39 fëmijë; 11 nga Gruda, 12 nga Vinoteka, 8 nga shtëpi familja Shpresa dhe 8 nga Shkodra.

F3.01.A5 Rehabilitim dhe ndërtim I këndeve të lojrave në parqet dhe lulishtet e qytetit të Shkodrës

Nga vlerësimi i realizuar në hapësirat publike të qytetit të Shkodrës, disa parqe të ndërtuara para disa vitesh në sajë të kontributit të donatorëve janë dëmtuar rëndë. Për këtë qëllim është planifikuar rehabilitimi i këndeve të lojrave me synim ofrimin e mundësive sa më cilësore në shërbim të fëmijëve dhe familjeve tyre. Rehabilitimi i parqeve është në proces zbatimi.

F3.02.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes"

Në dhjetor të vitit 2018 është inaguruar qendra e parë rinore publike në territorin e bashkisë së Shkodrës.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2018 janë si më poshtë:

Janë zhvilluar takimet me drejtoritë e Bashkisë Shkodër; Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, ZIN, Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, si dhe Drejtorinë e Turizmit; Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit - Shkodër.

Janë organizuar dhe zhvilluar fushatat e vullnetarizmit me studentë të universitetit “Luigj Gurakuqi”.

U zhvillua trajnimi 5 ditor mbi Menaxhimin e Ciklit të Projektit.

Është realizuar dhe ka përfunduar kursi socio politik.

U zhvillua trajnimi me përfaqësues së Komunës së Triestës, të cilët ndanë eksperiencën e tyre me të rinjtë e Bashkisë Shkodër mbi Shërbimin e Informagiovani Trieste.

Janë zhvilluar takimet me drejtoritë e Bashkisë Shkodër; Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, ZIN, Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, si dhe Drejtorinë e Turizmit; Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit - Shkodër.

Janë organizuar dhe zhvilluar fushatat e vullnetarizmit me studentë të universitetit “Luigj Gurakuqi.

U zhvillua trajnimi 5 ditor mbi Menaxhimin e Ciklit të Projektit.

Është realizuar dhe ka përfunduar kursi socio-politik.

U zhvillua trajnimi me perfaqësues së Komunës së Triestës, të cilët ndanë eksperiencën e tyre me të rinjtë e Bashkisë Shkodër mbi Shërbimin e Informagiovani Trieste. Janë organizuar 5 takime informuese me drejtorinë e Bashkisë së Shkodrës, ku pjesëmarrës kanë qenë rreth 150 të rinj.

Janë organizuar 4 fushata vullnetarizmi dhe përfitues kanë qenë rreth 200 të rinj.

Rreth 20 të rinj, aktivistë të organizatave rinore në territorin e Bashkisë Shkodër, kanë marrë pjesë në ciklin e menaxhimit projektit. Takimi u zhvillua në ambientet e Bibliotekës Publike “Marin Barleti”.

Në kursin socio politik kanë marrë pjesë rreth 350 të rinj.

F4.O1.A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe

Funksionimi i shtëpi – familjeve dhe ofrimi shërbimeve në përputhje me standartet e shërbimeve shoqërore. Mbështetja dhe financimi i aktiviteteve të 7 shtëpi – familjeve, të administruara nga organizata “Projekti Shpresa”. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetsore 60 individë me aftësi ndryshe.

Në transfertën specifike të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për qendrën “Shpresa” Shkodër. Shuma e alokuar për këtë qendër ishte 19,371 mijë lekë nga të cilat 16,940 mijë lekë për paga dhe sigurime dhe 2,431 mijë lekë për shpenzime operative. Vlera e realizuar në total është 19,168 mijë lekë duke u realizuar në masën 99 %.

F4.O1.A2. “Asnjë Fëmijë Jashtë”

Aktiviteti “Asnjë fëmijë jashtë”, si një aktivitet artistik e kulturor gjithpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve u zhvillua në qendër të qytetit të Shkodrës. Në këtë aktivitet fëmijët performuan në fusha të ndryshme artistike si muzike, recitim, vegla muzikore, teatër etj duke synuar gjithpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonist.

F4.O1.A3. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”

Mbështetja e aktiviteteve të bandës muzikore e përbërë nga persona me aftësi ndryshe Trupa Muzikore përbëhet nga 25 të rinj me aftësi ndryshe. Gjatë këtij viti kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat çdo javë dhe kanë arritur të marrë pjesë dhe të performojnë në aktivitete të ndryshme.

BEGIN - INTERREG V-B Adriatico -Jonian 2014-2020 (Adrion) 51 429.25 euro –Investime të financuara nga Bashkimi Europian në kuadër të këtij programi. Qëllimi I përgjithshëm I projektit Begin është të mbështesë krijimin e sipërmarrjeve sociale dhe rrjeteve të aktorëve që lehtësojnë sektorin e ekonomisë sociale, duke promovuar inovacionin social, me vëmendje të veçantë ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Projekti nuk ka nisur akoma implementimin, pasi është akoma në proces hapja e llogarisë së dedikuar projektit. Deri në Janar 2019 është hapur llogaria special pranë Bankës së Shqipërisë dhe është kredituar kjo llogari në shumën e paradhënies nga donator.

Është akoma në process hapja e llogarisë speciale të projektit pranë një banke të nivelit të dytë dhe transferimi i shumës së paradhënies nga llogaria speciale pranë Bankës së Shqipërisë në llogarinë në bakën e nivelit të dytë.

Bashkia Shkodër I ka dërguar të gjithë kërkesat e nevojshme Ministrisë së Financave për këtë qëllim dhe është në pritje të finalizimit të këtij procesi.

Fondet e financimit të programeve

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të Programit të hartuar gjatë procesit të miratimit të Buxhetit të vitit 2018. Ky program konsiston në mbulimin sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Buxheti i akorduar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së programit. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018

1. Fondet e miratuara për këtë program për aktivitetet e planifikuara nga Drejtoria e Shërbimeve sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik janë **1,026,768** mijë lekë nga të cilat janë realizuar **1,020,133** mijë lekë që përbëjnë 99.4 % .

Nga këto fondet për shpenzime korrente sipas planit 2018 janë:

- a. Paga dhe sigurime janë realizuar në masën 32,563 mijë lekë nga 35,320 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 92 %.
- b. Shpenzime operative janë realizuar në masën 14,408 mijë lekë nga 16,830 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 85.6 %.
- c. Transferta janë realizuar në masën 929,424 mijë lekë nga 929,683 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe përbën 99.9 %.
- d. Investime janë realizuar në masën 43,738 mijë lekë nga 44,934 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 97.3 %.

Fondet e rishikuara për këtë program:

Me Vendimin nr. 121, datë 23.05.2018, të Kryetares së Bashkisë është miratuar rishpërndarja e fondit ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente për vitin 2018 duke u shtuar fondi 500 mijë lekë me tvsh për projektin P10.F2.O2.A5. "Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimin qenve të rrugës", në pikën A1 "Trajtimi i qenve të rrugës" i planifikuar vlerë 200 mijë lekë me Tvsh në total bëhet 700 mijë lekë me Tvsh duke u pakësuar kjo shumë nga tepricat e fondeve, rrjedhojë e diferencave gjatë procesit të prokurimeve dhe me konkretisht janë pakësuar 27.35 mijë lekë në projektin P10.F2.O1.A1 "Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge", 57.35 mijë në projektin P10.F2.O2.A6. "Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore", 51 mijë lekë në projektin P10.F2.O3. A7. "Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi", 14.3 mijë lekë në projektin P10.F2.O3. A10 "Dita ndërkombëtare e romëve" dhe 350 mijë në projektin P10.F1.O1.A2 "Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit

rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, prane Qendes Komunitare "Per Familjen" nr 6".

Me VKB – në nr 35, datë 22.05.2018 “ Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017 dhe të rishpërndarjes së fondeve të trashëguara” shtohet projekti P10.F3.O1.A5 Rehabilitim dhe ndertim I kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres me vlerë 1,668 mijë lekë me tvsh.

Në po këtë vendim është bërë një shtese fondi prej 1,985.586 mijë lekë për projektin P10.F4.O1. A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe” dhe ndryshimet përkatëse në fishë.

Fondi fillestar i planifikuar për çerdhet për mbulimin e shpenzimeve në paga ishte **22.592** mije leke, me vendimin nr.55 dt.19.07.2018 „Per miratim shtese plani dhe rishperndarje te fondeve te buxhetit te Bashkise Shkoder“ ky fond është shtuar me **vleren 980.mije**, për **vlerën 145.mije** lekë është pakësuar sepse jane bere transferta tek llogaria „606“per individe per raste te daljes ne pension dhe raste fatkeqësish sipas“U.Brendshem“ nr.375 dt.16.4.2018,UB.nr,384 dt.16.05.2018 dhe U.B nr. nr.547 dt 10.07.2018, nr./11144.prot.,eshte paksuar edhe per vleren **608.mije** leke qe eshte bere transferta tek llog.606“ ne baze te“ Urdherit te Kryetares me nr.956 dt.30.11.2018 „Per shperblimin e e punonjesve me rastin e festave te fundvitit“.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitet/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P10.F1.O1.A1 Projektim dhe nderhyrje ne infrastrukture me synim permiresimin e jeteses per komunitetin rom dhe egjiptian.	-	-	-
	-	7,933	7,933
P10.F1.O1.A1/1 Projekte per permiresimin e kushteve te banimit per komunitete te pafavorizura.			
P10.F1.O1.A2 Sherbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, prane Qendres Komunitare "Per Familjen" nr 6.	2,005	1,655	536
P.10.F1.O2.A1 Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.	600	600	0.00
P.10.F1.O2.A2 Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës	-	-	-
P10.F2.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për	100	72.65	72.65

Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge			
P10.F2.O2.A1. Ndhimja ekonomike dhe PAK	990,123	901,490	901,480
P10.F2.O2.A2. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	300	300	284
P10.F2.O2.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	50	50	34
P10.F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë	-	-	-
P10.F2.O2.A5. Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës.	1000	1500	684
P10.F2.O2.A6. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200	142.65	142.65
P10.F2.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës.	-	-	-
P10.F2.O3. A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	50	46
P10.F2.O3. A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve.	-	-	-
P10.F2.O3. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	100	100	86
P10.F2.O3. A6. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori	-	-	-
P10.F2.O3. A7. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	150	99	98
P10.F2.O3. A8 Bashkëpunimi me Save the Children	-	-	-
P10.F2.O3. A9 Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.	-	-	-
P10.F2.O3. A10: Dita ndërkombëtare e romëve	100	86	86
P10.F2.O3. A11. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."	-	-	-
P10.F2.O4.A2 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	-	-	-
P10.F2.O4.A3. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	400	400	400

P10.F2.O4.A4. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ	-	-	-
P10.F2.O4.A5. Plani I zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian	-	-	-
P10.F2.O5.A1 Informimi dhe promovimi për një komunitet më të shëndeteshëm	-	-	-
P 10.F2.O5.A2 Projektimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së shërbimit shëndetësor parësor	-	-	-
P10.F3.O1.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Sociale Komunitare “Për Familjen”	11,530	11,530	8,934
P10.F3.O1.A2 Çerdhet	35,211	36,355	35,571
P10.F3.O1. A3. Shërbime alternative per femijet dhe familjen.	100	100	99
P10.F3.O1. A4. Nderhyrje te integruara per perfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik te femijeve dhe te rinjve.	-	-	-
P10.F3.O1.A5 Rehabilitim dhe ndertim I kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres	-	1,668	1,274
P10.F3.O2.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes"	37,012	37,012	37,012
P10.F4.O1.A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;	17,385	19,371	19,168
P10.F4.O1.A2. “Asnjë Fëmijë Jashtë”	266	266	214
P10.F4.O1.A3. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	355	355	355
Programi INTERREG V-B Adriatico -Jonian 2014-2020 (Adrion) 51 429.25 euro -Investime	-	-	-
Total	1,097,037	1,021,135	1,014,508

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

Për drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik lëvrimi i fondeve të parashikuara është realizuar në masën prej 99.4 %.

Sa i përket aktiviteteve të administrimit të apartamenteve sociale dhe programeve të strehimit social, është krijuar Komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Nuk është realizuar fondi i parashkuar pasi pritet vendimi nga Këshilli Bashkiak për miratimin e sistemit të pikëzimit.

Sa i përket projektit P10.F2.O2.A5. "Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës" për krijimin e një institucioni mikpritës (Strehëza) që do të luante rolin e një qendre, e cila do të ofronte shërbime veterinarë si vaksinimi, sterilizim/kastrimi, dehelmintizimi dhe kafshët do të ishin nën kujdesin konstant të mjekëve veterinerë, grupimeve të vullnetarëve dhe studentëve, gjë e cila nuk është realizuar ka një sërë arsyesh të tilla si :

Mungesa e një aseti të bashkisë Shkodër me infrastrukturën e nevojshme për përshtatje për krijimin e strehëzës.

Mungesa e financimeve të plota për ndërtimin, vënien në funksion të saj dhe mbulimin e kostove për ushqyerjen dhe mbajtjen e qenve në të.

Kundërshtimet e OJF-ve animaliste që operojnë në territorin e bashkisë Shkodër dhe jo vetëm.

Strehëzat nga ana tjetër është vërejtur që nuk reduktojnë numrin e qenve endacakë, motivojnë njëriëz për të mos pasur kujdes ndaj tyre, janë burim i përhapjes së sëmundjeve infektive si dhe mirëmbajtja e tyre në kushtet e nevojshme higjieno-sanitare dhe të trajtimit human të qenve ka kosto shumë të madhe, kosto kjo e papërbalueshme për buxhetin e Bashkisë Shkodër.

Për projektin Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6. Nuk është miratuar ndryshimi i destinacionit të godinës nga Këshilli i Ministrave. Po punohet për realizimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen dhe miratimin e përfituesve duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të ligjit të ri nr. 22/2018 " Për strehimin Social" që ka hyrë në fuqi në Nëntor 2018.

Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.

Sfidë tjetër është aspekti menaxherial dhe bashkërendues i punës në këto banesa sociale me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si premisë e rëndësishme për fuqizimin e personave të sistemuar aty, duke synuar një përfshirje sociale më të gjerë.

Për Projekti Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.

Mbetet problematikë plotësimi i ligjit me aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurat dhe modalitetet e zbatimit të programeve sociale të strehimit. Duke marrë parasysh stafin e ri të angazhuar në çështjet e strehimit si një funksion i ri brenda drejtorisë vlerësohet si shumë e rëndësishme ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i mundësisë së shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet bashkive në mënyrë që të përmirësohet performanca e administratës në zbatimin e programeve sociale të strehimit, duke iu referuar nenit 74/2,3,4 sipas të cilit ministria përgjegjëse për strehimit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji harton dhe miraton programet e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore.

BEGIN - INTERREG V-B Adriatico -Jonian 2014-2020 (Adrion) Projekti nuk ka nisur akoma implementimin, pasi është akoma në proces hapja e llogarisë së dedikuar projektit. Deri në Janar 2019 është hapur llogaria speciale pranë Bankës së Shqipërisë dhe është kredituar kjo llogari në shumën e paradhënies nga donatori.

Është akoma në proces hapja e llogarisë speciale të projektit pranë një banke të nivelit të dytë dhe transferimi i shumës së paradhënies nga llogaria speciale pranë Bankës së Shqipërisë në llogarinë në bankën e nivelit të dytë.

Bashkia Shkodër I ka dërguar të gjithë kërkesat e nevojshme Ministrisë së Financave për këtë qëllim dhe është në pritje të finalizimit të këtij procesi.

P11 Kultura dhe shërbimet rekreacionale

Shkodra, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore do të bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor.

Kjo trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me shtrirje nga Alpet deri në bregdet, do të bëhet faktor kyç për rritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve.

Njëqind e dyzet e dy monumente kulturore janë sot të përfshira në hartën e re administrative territoriale të Bashkisë së Shkodrës. Programi ynë synon fuqizimin e strukturës administrative dhe mirë organizimin e institucioneve aktuale të kulturës së Bashkisë.

Një nga kolonat kryesore të programit ka qene rivitalizimi i institucioneve aktuale të kulturës.

Shkodra ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në art dhe kulturë, me të cilat ajo merr kuptim. Këto vlera kanë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Pjesë e programit ka qene mbështetësja dhe nxitësja e zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet institucioneve dhe enteve lokale.

Pikënisja e programit tonë është mirë menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore- artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellë në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, të fotografisë, muzikës, teatrit etj. Si dhe ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës.

Muzika folklorike dhe qytetare shkodrane, promovimi dhe organizimi i festivaleve të përvitshme dhe aktivitetet kulturore kanë pasuruar traditën muzikore të qytetit me kompozime dhe shfaqje të reja duke gjallëruar jetën artistike në Shkodër.

Kemi synuar promovimin e formave alternative të administrimit dhe marketingut të Arteve pamore dhe institucioneve të tjera kulturore në Shkodër pjesë e rrjetit muzeve dhe institucioneve kulturore për t'u vizituar.

Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përcimi i vlerave kulturore dhe sportive ka qene një nga politikat e programit.

Bashkia e Shkodrës, Drejtoria e Kulturës bashkë me Bibliotekën Marin Barleti, ka mbështetur në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij me synimin e ndërthurjes së politikave vendore dhe strategjive ndërkombëtare për bibliotekat publike.

Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave

Drejtoria jonë me qëllim kryesorë atë të zhvillimit të sektorit të kulturës, në zbatim të kuadrit ligjor, synon në mbulimin e këtyre funksioneve kryesore:

F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F3. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetareve.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1 O1: Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mirë administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.

F2 O1 :Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës.

F2 O2: Pasurimi dhe gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.

F3 O1: Promovimi dhe nxitja e leximit si instrument edukimi duke rritur aksesin dhe cilësinë e shërbimit pranë Bibliotekës “Marin Barleti”.

F3 O2: Ruajtja, mirë administrimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës “Marin Barleti”.

Produktet për vitin 2018

Gjatë vitit 2018, për realizimin e funksioneve dhe objektivave përkatës të mësipërm, drejtoria e jonë ka realizuar produktet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme, të parashikuara në Buxhetin 2018 të Bashkisë Shkodër për programin e Kulturës.

P11.F1.O1.A1: “Java e Pavarësisë” Ekspozitë etnografike me elementë kostumografie e zejesh:

Ekspozitë-konferencë mbi figurën e Gjergj Kastrioti Skënderbeu si frymëzues i Rilindjes Kombëtare Shqiptare – Muzeu Historik.

Aktiviteti solli mjaft informacione që u trajtuan për herë të parë në një këndvështrim ndryshe. Gërshetimi i kumtesave dhe ekspozitës së botimeve në shekuj për Skënderbeun, ishte një tjetër risi e aktivitetit të organizuar në mjediset e Muzeut Historik të Shkodrës.

Aktiviteti u organizua në formën e një forumi, ku u diskutuan tema rreth jetës dhe veprimtarisë së Heroit , nga stafi i muzeut dhe studiesit Simon Lufi, Marsel Nilaj, Eduard Grishaj, Fatmir Juka, Ndriçim Mlika, Anelmo Spahija dhe Pjerin Mirdita.

Në fund të kumtesave publiku pati mundësinë të njihej me një ekspozitë botimesh të rralla, pjesë e pasurisë së çmuar dokumentare të Muzeut Historik.

P11.F1.O1.A4:Hartim dhe konceptim projekti arkitektonik dhe inxhinierik për rikonstruksion Godinës së Muzeut “Oso Kuka”

Kushtet në të cilat ndodhet sot në tërësi Muzeu Historik janë jashtë standarteve muzeologjike, duke rrezikuar pasuritë e çmuara që ky muze ka në fondet e tij. Degradimi në vite i godinës, bëri që ne të ndërmerrim hapa konkret për të realizuar një projekt total rikonstruksioni. Komunikimi në vazhdimësi edhe me institucionet qendrore të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore, solli nevojën e menjëhershme

për ndërhyrje. Në vitin 2018 u planifikua realizimi i një detyre projektimi nga Bashkia Shkodër, i cili do t'i hapte rrugë Projektit për Rikonstrukcion të Muzeut. Kjo fishe aktualisht është në fazë tenderimi publik.

P11.F1.O1. A5: Mbështetje për funksionimin e aktivitetit dhe shërbimin në vazhdim të Muzeut

Historik: Muzeu Historik i Shkodrës ka nisur të organizohet që në vitin 1947, nën emërtimin “Muzeu Popullor” dhe mori formë të plotë në vitin 1949.

Në vitin 1996, Muzeu Historik i Shkodrës u transferua në banesën “Oso Kuka”, ku ndodhet edhe sot. Paralelisht me të vazhdon të funksionojë edhe Muzeu i Kalasë “Rozafa” i vendosur në godinën e Kapitenerisë. Vitet e fundit strukturës organike të Muzeut i është shtuar edhe ajo e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës.

Gjatë këtij viti janë realizuar:

1. Përmirësimi i dukshmërisë së sallave të Muzeut të Kalasë. Lyerje me gëlqere dhe vaj lini i ambjenteve të brendshme, i cili ndikon në mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore;
2. Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik, Shkodër;
3. Prodhim dhe shtypje biletash për rrjetin muzeal.

P11.F1.O1.A8: Rikonstrukcion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve, Shkodër ishte kërkuar për të kryer kondicionimin dhe ajrosjen e ambjenteve, salla A e GASH. Për shkak të kompleksitetit të projektit ishte e pamundur realizimin i tij. Gjithashtu dhe mungesa e përgjegjesit për një kohë të gjatë solli mosndjekjen dhe mosrealizimin e tij.

P11.F1.O1.A9: Publikime promicionale, fletëpalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës. Nevoja për promovim dhe njohja me historinë e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës, si Muzeu më i ri i Bashkisë Shkodër, por me një histori që përkujton viktimat që vuajtën dënime të padrejta në burgjet e regjimit komunist.

Në vitin 2018 janë realizuar Fletëpalosje, broshura informative dhe Guidë mbi aktivitetin e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës. Duhet theksuar se këto materiale kanë rezultuar shumë të vlefshme për aktivitetin tone të përditshëm, sepse vizitorët i kanë marrë ato dhe nepermjet tyre është bërë dhe promovimi i Muzeut në vendet e ndryshme të Botës.

P11.F1.O1.A10: Cikël bisedash dhe ndërgjegjësim i të rinjve nën fokusin e librave me tematikë mbi të kaluarën komuniste. Prej 3 vitesh Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës ka futur në axhendën e tij të aktiviteteve organizimin e disa cikle bisedash me të rinjtë me tematikë të kaluarën komuniste. Fokusi i këtyre takimeve është njohja me historinë e komunizmit të nxënësve dhe studentëve.

Në vitin 2018 u realizuan 4 cikle bisedash të ndara në dy periudha, shkurt-maj dhe tetor-dhjetor dhe lektor folës ishin vuajtes direkt të regjimit komunist të cilët deshmuar eksperiencat e tyre të vuajtjeve me të rinjtë pjesëmarrës.

P11.F1.O1.A11: Mirëmbajtje e ndërtesës së Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës

“Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës” në Shkodër, i pari muze i ndërtuar në Shqipëri për të përkujtuar torturat e regjimit komunist në vend, krejtësisht këtë vit erdhi me një imazh të ri.

Bashkia Shkodër, ka bërë të mundur ndriçimin e fasadës së jashtme të këtij muzeu, me një stil dhe imazh të kuruar nga specialistë të fushës.

Ky muze, me një pamje tjetër, bëhet i aksesueshëm për turistët edhe gjatë orëve të mbrëmjes, ku në dritaret e tij janë imazhet e emrave më të mëdhenj të Shkodrës dhe Shqipërisë të cilët vuajtën diktaturën e egër komuniste në ish burgun famëkeq të Shkodrës.

P11.F1.O1.A13: Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve:Ekspozitë në Muzeun Historik “Jehona e Zejeve”
Qellimi i këtij aktiviteti ishte ruajtja dhe përcjellja tek brezat e ri, të disa prej zejeve tradicionale dhe njihjen me teknikat e zbatimit të tyre, në rastin konkret, gdhendja nëgur e dru.

Për këtë ju bë ftesë shkolla të mesme të qytetit, studentët e të cilëve me anë të veglave si çekiç , dalta, etj , përformuan nën kujdesin e specialistit të DRKK-Shkodër , Z. Petrit Bilali, mësuan dhe prodhuan elementë dekorativ ndërtimi.

Gjithashtu këtij aktiviteti formues, ju bashkua edhe ekspozita e kuruar nga specialistët e Muzeut Historik, e cila kishte në përbërjen e saj veglat e punës së periudhave të ndryshme historike, pjesë e pasurisë së fondeve tona muzeale.

P11.F1.O1.A14:Ekspozita “Salloni i Vjeshtës”

Galeria e Arteve të Shkodrës ka realizuar ekspozitën “Salloni i vjeshtës”, edicioni i 12-të.

Edicioni i 12-të i këtij aktiviteti, me titullin "HAPËSIRË E BRAKTISUR" është kuruar nga Vladimir Myrtezai dhe Edison Çeraj. Pas procesit përzgjedhës nga ana e kuratorëve, lista e autorëve pjesëmarrës përbëhej nga: Alketa Ramaj, Arben Suma, Albes Fusha, Andi Hila, Ahmet Malevija, Aurora Kalemi, Adnan Bushati, Anduela Aliko, Bledar Baja, Diomen Boriçi, Denisa Brahimi, Eros Dibra, Edis Kadija, Edison Shahini, Fatmir Juka, Fatlum Doçi, Florian Haxhihyseni, Gjëlosh Mitaj, Ila Gjinaj, Ilir Kaso, Lindita Gjoka (Dedukaj), Liljana Çefa, Nirvana Baja, Nesret Gjokaj (Nuki), Rubin Mandija, Sokol Kola.

Fituese e këtij edicioni ishte Aurora Kalemi. Ekspozita qëndroi e hapur nga data 22 nëntor deri më 31 dhjetor 2018.

P11.F1.O1.A15:Çmimi Idromeno: ekspozite personale e fituesit te ketij cmimi: Me dt. 14 shtator 2018, në Galerinë e Arteve të Bashkisë së Shkodrës, u përurua ekspozita personale e artistes Lori Lako, fituese e Çmimit Idromeno 2017, me titull: "THE SEA IS FAR, THOUGH MY TEARS ARE SALTY". Aktiviteti pati interes të lartë tek publiku i pranishëm jo vetëm në ditën e hapjes, por edhe në ditët në vazhdim. Ekspozita u mbajt e hapur deri më 14 tetor 2018.

P11.F1.O1.A16:Personazh i ftuar. Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve Shkodër

Në datën 12 prill 2018, u përurua ekspozita personale e artistes Erëmirë Jahja – me titull "Tingull..."Znj. Jahja është një ndër personalitetet e veçanta të qytetit të Shkodrës në fushën e arteve pamore. Ajo solli për publikun një ekspozitë të veçantë, e cila kishte si temë kryesore qytetin e Shkodrës, përmes peisazheve, kostumeve tradicionale dhe portreteve të ndryshme, të gjitha këto të shoqëruara me fraza të zgjedhura të këngëve qytetare shkodrane.

Ekspozita qëndroi e hapur për publikun deri me dt. 11 maj 2018.

P11.F1.O1.A17:Takime publike, biseda publike mbi artin, ëorkshop me artistë të rinj dhe studentë: U zhvilluan 4 takime publike: ne takimin e pare publik ishte i ftuar artisti i mirenjohur shkodran Zef Paci i cili e përqendroi diskutimin e tij mbi temën"Jeta politike e përditshme në arkivin fotografik të ATSH-së".Publiku ishte kryesisht studentë dhe studiues të artit.

I ftuari i takimit të dytë ishte Sidi Kanani i cili foli mbi temën "Imazhi...mes të shenjtes, laikes dhe magjikes". Tema ngjalli shumë interes tek të pranishmit, të cilët kryesisht ishin studentë dhe studiues të artit, duke e kthyer në bashkëbisedim të gjithë aktivitetin.

I ftuar i takimit të tretë publik në Galerianë e Arteve ishte studiuesi Edmir Ballgjati, i cili foli mbi temën "Ahengu shkodran dhe transformime të tij në periudhën socialiste". Interesi ishte shumë i lartë tek të pranishmit.

Ne bashkepunim me Universitetin e Shkodres Luigj Gurakuqi, dega e pedagogjise muzikore dhe piktures grafike, u organizua dhe nje ëorkshop me studentë të arteve figurative. Tema e zgjedhur nga pedagogu i pikturës Rubin Mandija “Zgjedhje e lirë”, solli si produkt vepra të reja dhe inovative të artit figurativ. Në përfundim të këtij ëorkshop-i u prezantuan me një ekspozitë në Galerinë e Arteve, punët e studentëve Andi Matallari, Edona Vatoci, Elsamina Musiq, Rudolf Faja, Xhulian Millaj.

P11.F1.O1.A18: Aktivitete në partneritet me shoqata kulturore: kjo fishe u zhvillua ne muajin maj në partneritet me “Art House”, një bashkëpunim shumë i mirë në pikëpamjen artistike dhe organizative. Programi i pasur artistik me titull "Ekranit i Artit" u vlerësua maksimalisht nga artdashësit. I lindur si një projekt që kërkon të promovojë lidhjet mes artit bashkëkohor dhe kinemasë, në të prezantohen filma, dokumentarë mbi artin bashkëkohor të shoqëruar me instalacione, video, takime me artistë e kuratorë, rezidenca për artistë ndërkombëtare, produksione dhe shpërndarje të filmave. Këtë vit, programi i përzgjedhur solli filma, dokumentarë e video që janë shfaqur vitet e fundit në festivalin e filmit, i cili shënoi edhe dhjetë vjetorin e themelimit të tij.

Të ftuar të veçantë të Ekranit i Artit ishin Silvia Lucchesi, drejtoreshë e “Lo schermo dell’arte”, Leonardo Bigazzi, kurator i VISIO European Programme on Artists’ Moving Images, Rà di Martino, regjisore e “Controfigura”, Driant Zeneli, artist pjesëmarrës në programin VISIO 2017 me videon “It would not be possible to leave planet Earth unless gravity existed” si dhe muzikantët Admir Shkurtaç dhe Giorgio Distanti. Ditët e këtij aktiviteti “Ekranit të Artit”, krahas projeksioneve, u shoqëruan edhe nga momente muzikore, biseda e prezantim libri.

P11.F2.O1.A2: Realizimi i memorialit për të persekutuariat politik: Qyteti i Shkodrës, është qyteti më i persekтуar gjatë diktaturës komuniste. Gjatë kësaj periudhe në Shkodër numërohen 3000 të burgosur politik, 2000 të internuar, 601 të pushkatuar dhe 136 persona të vdekur në tortura. Në qytetin tonë nuk kishte një memorial që perkujton këto viktime. Në vitin 2014 komisioni Drejtësi dhe Paqe, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Shoqatën e ish të përndjekurve politik, Shkodër, Galerinë e Arteve si dhe mbështetur nga organizatat gjermane Renovabis dhe Maksimilian Kolbe, ka realizuar një konkurs për realizimin e një veprë që perkujton persekucionin komunist në Shkodër.

Realizimi i këtij memoriali është në fazën e derdhjes në bronz të figurave perberese të tij dhe të perfundimit të bazamentit ku ai do të ngrihet.

P11.F2.O1.A3 :Orkestra Frymore, honorare vjetore: Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë, me fillimet e hershme që nga viti 1876. Bashkia Shkodër e mbështet çdo vit me honorare këtë formacion, i cili gjatë gjithë vitit është prezent në pothuajse të gjitha aktivitetet artisko-kulturore si dhe në datat e rëndësishme historike zyrtare kombëtare dhe lokale. Formacioni i Orkestrës Frymore të Bashkisë Shkodër, përbëhet prej 40 muzikantëve.

P11.F2.O1.A4: Mbështetje për menaxhimin e Teatrit “Migjeni” : gjatë vitit 2018 është kryer blerja e biletave për aktivitetet e Teatrit dhe blerja e kancelarive të nevojshme për ecurinë normale të procesit të punës. Janë paguar të gjitha shërbimet nga të tretë për furnizim me energji, ujë etj.

Shërbimet nga të tretë si energji, ujë etj. janë shërbime që financohen nga Bashkia Shkodër çdo vit, të cilat janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e Teatrit “Migjeni”. Gjithashtu janë mbështetur shërbime administrative për Teatrin “Migjeni” siç janë pritje-përcjelljet, të nevojshme për aktivitete të ndryshme; sigurancioni i ndërtesës së Teatrit “Migjeni”, i cili është detyrim ligjor; pjesëmarrje në konferenca të ndryshme të stafit të teatrit si dhe mbështetje për shërbime transporti për aktivitete artistike brenda dhe jashtë vendit. Trupat artistike të atashuara pranë Teatrit “Migjeni” janë ftuar të marrin pjesë në aktivitete apo konkurse të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në shumicën e rasteve, këto trupa kthehen me çmime të fituara me meritë nga këto aktivitete. Bashkia Shkodër e nxit dhe e mbështet çdo vit Teatrin “Migjeni” për të qenë pjesë e këtyre aktivitetëve. Gjithashtu është realizuar dhe mirembajtja e ambjentëve të Teatrit Migjeni nepermjet lysterjeve të mjediseve të ndryshme dhe riparimeve të nevojshme në teater.

P11.F2.O1.A5:Administrimi dhe menaxhimi i Teatrit “Migjeni”: Institucioni i Teatrit “Migjeni” është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 37 personash. Kjo fishe ka të bëjë me pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit “Migjeni”.

P11.F2.O1.A9:Administrimi dhe menaxhimi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” Qendra e Kultures “Pjetër Gaci” ka 4 punonjës, janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore të tyre. Këtë vit Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” ka funksionuar në ambjentet e teatrit Migjeni pasi e gjithë godina i është nënshtruar një rikonstruksioni total të ambjenteve. Si pasojë shpenzimet për mirëmbajtjen e godinës nuk janë realizuar.

P11.F2.O2.A1: Dita e luleve 6 Maj

“Dita e Luleve 2018”, u zhvillua në datën 6 maj 2018 në disa pika të qytetit të Shkodrës, nga sheshi “Nënë Tereza”, përgjatë rrugës “28 Nëntori” dhe në sheshin para Bashkisë Shkodër.

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata “Consulting and Development Partners”.

“Panairi i luleve” – I vendosur në sheshin para Bashkisë Shkodër, panairi i luleve u hap në orën 10:00-20:00 të datës 6 maj. Në këtë organizim u ftuan subjekte dhe qytetarë të ndryshëm që merren me kultivimin e luleve. Shumë subjekte morën pjesë me standat e tyre me lule duke krijuar një larmirshmëri të madhe buqetash me lule.

“Parada e luleve” – Kjo temë ishte e dedikuar për fëmijët. U angazhuan fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar. Gjithashtu, pjesë e këtij bashkëpunimi u bënë edhe subjekte arsimore private të qytetit tonë. Në orën 11:00 në Sheshin “Nënë Tereza” filloi parada e grupeve të ndryshme të fëmijëve, të cilët të veshur në përshtatje me tematikën e ditës, performuan gjatë gjithë pedonale “28 nëntori”, deri tek sheshi para Bashkisë Shkodër.

Koncerti i mbajtur në sheshin para Bashkisë Shkodër, nga Qendra Kulturore e Fëmijëve, filloi në orën 10:30-12:30. Ky koncert u prit shumë mirë nga të pranishmit, të cilët ishin më shumë fëmijë të moshave të ndryshme.

“Zanat e luleve” - Pranë sheshit të Bashkisë Shkodër ishte vendosur dy kënde të veçanta, të zbuluara me lule dhe ideuar si ministudio fotografike për fotografimin e fëmijëve dhe të rriturve nga ora 10:00 – 12:00 dhe mbasdite 17:00- 19:00.

“Lulet e qytetit tim përmes fotografisë” – Konkurs i shpallur disa ditë para zhvillimit të aktivitetit, i cili konsistonte në zhvillimin e një gare fotografie, mes të apasionuarve dhe fotografëve profesionistë, të cilët do të shkrepnin foton më të bukur me tematikë lulet e Shkodrës. Në ditën e festës fotot u ekspozuan në oborrin e Muzeut Historik, banesa “Oso Kuka”.

“Poezia e luleve” – Konkurs i shpallur disa ditë para zhvillimit të aktivitetit në adresën e vendosur në dispozicion për të gjitha konkurset e Festës së Luleve. Sipas kriterit të vendosur nga Bashkia Shkodër, konkursi kishte të bënte me krijimin e Poezisë Gegë, kushtuar luleve. Këtu morën pjesë 12 poetë të rinj dhe të afirmuar. Juria në këtë rast ishte përzgjedhur me kujdes; ajo ishte e përbërë nga tre emra të njohur të fushës së letrave, z.Zija Vukaj, znj. Ermire Aliaj dhe z.Erion Temali Prezantimi i të gjitha poezive pjesëmarrëse u bë në mbasditen e datës 6 maj në orën 18:30 – 19.30 në Muzeun Historik, banesa “

OsoKuka". Poezitë u interpretuan nga vetë autorët para publikut prezent.Vendin e parë e fitoi poezia "Lulja e Lotit" nga Nesti Gjoni.

"Miss biçikleta" – Ky konkurs solli argëtim të madh tek publiku i pranishëm dhe tek konkurentët. Shkodra, e cila njihet ndryshe edhe si qyteti i biçikletave, e ka në traditën e saj përdorimin në masë të gjërë të këtij mjeti lëvizës. Për këtë arsye, organizatorët disa ditë para zhvillimit të aktivitetit shpallën edhe konkurimin për biçikletën e zbukuruar më bukur me lule të freskëta. Ky konkurs u zhvillua në orën 19:30 -20:00 në Muzeun Historik, banesa "Oso Kuka" dhe krijoi atmosferë shumë të mirë tek të pranishmit. Fituesja e këtij konkursi u shpall nga votat e publikut të pranishëm,Klevisa Marashi.

P11.F2.O2.A2: Ndërmendje

Aktiviteti "Ndërmendje 2018" u zhvillua me datë 28 dhjetor 2018 në Teatrin "Migjeni", sipas parashikimeve të përcaktuara gjatë organizimit, në orën 19:00.Ky koncert, si çdo vit, edhe kësaj radhe ishte me karakter klasik, sipas kriterëve të shpallura nga Bashkia Shkodër.Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Fondacioni "Arte".

Me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, të përbërë prej 50 elementësh dhe me një repertor të përzgjedhur, koncerti u mirprit nga spektatori i pranishëm në sallë.Këtë vit e përzgjedhur si soliste ishte violinistja shkodrane, e cila prej vitesh punon dhe jeton në Itali, Cecilia Laca. Dirigjent Norman Īidjaja dhe solistë të tjerë ishin Armando Likaj, Klodiana Brahimi, Niki Mjeda, Granit Musliu.

P11.F2.O2.A3Fjala Artistike me nxënësit e shkollave të mesme, në nderim të figurave të shquara:

Aktiviteti " Fjala artistike me nxenesit e shkollave te mesme" ka filluar ne muajin Shkurt 2018 dhe ka mbaruar ne Nentor 2018, duke perfshire shkollat e mesme te qytetit te Shkodres. Kete vit eshte perqendruar ne shkollat 28 Nentori, Oso Kuka, At Pjeter Meshkalla dhe shkolla Shejnaze Juka. Ky aktivitet pati si qellim jo vetem perkujtimin e figurave te shquara shqiptare por edhe evidentimin e brezit te ri te aktoreve dhe nxitjen e nxenesve qe ne moshe te re te marrin pjese ne aktivitetet e Teatrit " Migjeni".

P11.F2.O2.A4: Aktivitete me rastin e 2 Prillit:

Ngjarjet e 2 prillit në Shkodër nisën si një protestë qytetare kundër regjimit më të egër komunist që njohu Europa. Në valën e kësaj demonstratë anti-komuniste, u vranë pabesisht katër njerëz.

Djemtë e Shkodrës, Arben Broci, Bujar Bishanaku, Nazmi Kryeziu dhe Besnik Ceka u bënë dëshmorët e demokracisë për një ëndërr të madhe – "Ta shihnin Shqipërinë si e gjithë Europa".

Masakra e 2 prillit 1991 edhe sot e kësaj dite mbulohet me një mister të madh.

Shkodra dhe shkodranët i kujtojnë çdo vit djemtë e saj, duke kujtuar ende ëndrrën e tyre të përealizuar.

Ata janë tashmë pjesë e pashlyeshme e historisë tonë dhe e qëndresës antikomuniste, ndërkohë që rruga për ndërtimin e demokracisë në Shqipëri vazhdon të jetë sfida më e rëndësishme.

Bashkia Shkodër në respekt të dëshmorëve të demokracisë dhe të gjithë qytetarëve që ishin pjesë e asaj demonstratë, organizon çdo vit aktivitete në homazh të të rënëve dhe në përkujtim të asaj ngjarjeje, e cila bëri ndryshimin e madh në vendin tonë.

Ndër aktivitetet kryesore që do të mbahen me rastin e kësaj dite janë:

- Homazhe pranë memorialit të Dëshmorëve të Demokracisë,
- Aktivitet përkujtimor
- Pritje në Bashkinë Shkodër

P11.F2.O2.A5 :Festival Jazz-i

“Festival Jazz-it” projekt i titulluar “Shkodra Jazz Festival” nga subjekti fitues, u zhvillua në datat 27 gusht – 2 shtator 2018. Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër, Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj” dhe “Optional Music International”. Projekti ishte i konceptuar i ndarë në disa elementë: Nga data 27 gusht – 1 shtator 2018 u zhvilluan orë intensive masterklasi të dy rrymave muzikore Jazz dhe Klasike, me rreth 50 nxënës pjesëmarrës nga të gjitha trevat shqipfolëse, e titulluar “Rrok Academy”. “Rrok Academy” është shkolla e parë e këtij lloji në Shqipëri, e cila ka të bëjë me kurse të avancuara për muzikantë, dhe ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën elitare, përmes leksioneve intensive të drejtuara nga profesionistë të fushës. Koncertet e mëdha Jazz u mbajtën në datat 29-30-31 gusht, me të ftuar Paolo Marzocchi, Markelian Kapidani, Paçalin Pavaci, Jose Maria Gallardo Del Rey, Diego Borotti, Davide Liberti, Mattia Barbieri, Joyce Elaine Yuille, Michael Rosen, Monica Fabbrini, NU4tet, Lidia Lufi. Koncerti klasik u mbajt në datën 2 shtator në Teatrin “Migjeni”. Koncertet u mbajtën në Teatrin “Migjeni”, Muzeu Historik, Sheshi “Nënë Tereza”, Kinema “Millenium”, Qendra Rinore “Arka”, ndërsa “Rrok Academy” u zhvillua në Qendrën Kulturore të Fëmijëve dhe Galeria e Arteve, Shkodër.

P11.F2.O2.A6; Karnavalet

“Karnavale 2018”, u zhvilluan në datat 08-11 shkurt 2018 në Muzeun Historik, Shkodër (Banesa “Oso Kuka”) dhe në sheshin “Nënë Tereza”.

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Shoqata Kulturore Teatrorë “Zef Jubani”.

Karnavale 2018, të titulluara “Karneval në tepsi” nga subjekti, u konceptuan të ndara në disa ditë mbi tema të ndryshme:

Data 08.02.2018 – E titulluar “Dita e bijave”, ky aktivitet paralajmëron ardhjen e karnavaleve. Aktiviteti u zhvillua në ambjentet e Muzeut Historik, Shkodër. Pjesë e kësaj dite u bënë grupe vajzash të shkollave të qytetit të Shkodrës, të shoqëruara nga mësueset e tyre.

Data 09.02.2018 – Kjo ditë ishte konceptuar si një konkurim me performanca artistike mes shkollave të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe të mesëm. Aktiviteti filloi në orën 10:00 në sheshin “Nënë Tereza” Festa zgjati për rreth dy orë. Në këtë ditë morën pjesë 16 shkolla të Bashkisë Shkodër, nga të cilat u përzgjedhën tre prej tyre për të marrë pjesë në ditën finale të Karnavaleve.

Data 11.02.2018 – Festa e Karnavaleve filloi në orën 10:00 me nisjen e karvanit shëtitës karnavalesk nga qendra e shoqërisë “Illyricum” në Gjuhador për të përshkuar më pas lagjen “Gjuhador”, Trumën e Dugajve të reja, Rus i vogël, Sheshi i Katedrales, Sarreq, sheshi “Isa Boletini”, Parrucë, sheshi para ish-monumentit të “5 heronjve” për të përfunduar në ndalesën e fundit në sheshin “Nënë Tereza” ku edhe u mbajt festa kryesore e Karnavaleve. Gjithashtu, pjesë e karvanit karnavalesk u bë edhe Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, e cila e shoqëroi karvanin deri në sheshin “Nënë Tereza”.

Koncerti përmbyllës i Karnavaleve filloi rreth orës 12:00 në Sheshin “Nënë Tereza” dhe zgjati rreth dy orë dhe në fund u realizua edhe djegia e dordolecit, si një traditë e Karnavaleve, Pjesëmarrja e publikut ishte shumë e madhe.

P11.F2.O2.A7: “Koncertet e verës”

“Koncertet e verës” u zhvilluan në muajin Korrik - Gusht në datat: 15, 25 Korrik 2018 dhe 1, 13 Gusht 2018, në pika të ndryshme të qytetit dhe në Njësinë Administrative Velipojë.

15 Korrik 2018 - u mbajt koncerti i parë i verës, në sheshin përpara Bashkisë Shkodër. E ftuar ishte këngëtarja e mirënjohur Rezarta Smaja së bashku me grupin e saj Bled Doçi, Antonio Fierza dhe Jetmir Mesi. Koncerti filloi në orën e parashikuar në orën 20:00.

Repertori i zgjedhur, rreth 20 këngë, Shqiptare dhe të huaja për koncertin e parë të “Koncerteve të Verës” ishte i zhanrit Rock dhe Pop. Të gjitha këngët u luajtën dhe u kënduan “live” nga banda muzikore dhe nga këngëtarët pjesëmarrës.

25 Korrik 2018- Të ftuar në koncertin e dytë ishin Olimpia Smajlaj dhe grupi The B4ND, i cili u zhvillua në sheshin përpara Bashkisë Shkodër.

E veçanta e këtij koncerti ishte sepse ky grup i bashkua festës së miqësisë të organizuar nga birra Elbar duke rritur kështu mundësinë e promovimit të këtyre artistëve në një masë shumë më të gjerë. Repertori i zgjedhur nga Olimpia Smajlaj and THE B4ND për të performuar në këtë koncert ishte i zhanrit Rock, Pop, Latine dhe muzike shqiptare, të cilat u sollën për publikun në një formë shumë të freskët.

1 Gusht 2018 - Nata e tretë e "Koncerteve të verës" erdhi ndryshe. Ai u zhvillua në sheshin “Nene Tereza” dhe ishin të ftuar grupi më i ri muzikor nga Shkodra “Brios”. Në repertorin tyre pati muzikë të huaj dhe shqiptare. Pjesa përpara skenës ku u zhvillua koncerti ishte e mbushur plot me të rinj, që kënduan e kërcyen deri në fund të koncertit. Anëtarët e grupit “Brios” ishin Eugjen Marku (Vokal, Kitar); Rafael Marinaj (Tastier); Klajdi Ibro (Bateri); Klodian Guri (Kitar); Xhiesian Luca (Bass). Pjesë e këtij koncerti ishte dhe “Viki Haxhi and Friends”, antarët e këtij grupi janë Alfons Lazri (Kitar), Florian Martini (Bateri) dhe Viki Haxhi (Kitar/Vokal).

13 Gusht 2018- Bazuar suksesin që grupi muzikor “Brios” kishte në datën 1 Gusht , për koncertin e katërt dhe të fundit të “Koncerteve të Verës”, u sugjerua që ky grup të ftohej përsëri dhe të performonte në Njësinë Administrative Velipojë në datën 13 Gusht, duke qenë se sezoni turistik ishte në pikun e tij. Pjesë e këtij grupi ju bashkuan dhe disa të rinj të tjerë si :Margerita Shllaku (Vokal); Antonio Shllaku (Përkusion); Enes Bajri (Kitar); Emanuel Marku (Kitar Bass). Po në këtë koncert mori pjesë edhe këngëtarja Rigërsa Zefi. Ky koncert i ka shërbyer më së mirë promovimit të këtyre artistave të rinj.

P11.F2.O2.A9: Shkodra n’Fest

“Shkodra n’Fest”, të konceptuara si një sërë aktivitetesh të ndryshme gjatë muajit dhjetor, u zhvillua nga data 08 dhjetor – 31 dhjetor 2018 në qendër të qytetit të Shkodrës, në rrugën “13 dhjetori”, sheshi para Bashkisë Shkodër.

“Shkodra n’fest” vazhdoi për gjatë gjithë muajit dhjetor dhe aktivitetet artistike që shoqëruan mbrëmjet ishin si më poshtë:

Data 11/12/2018 – Koncert i madh festiv me të ftuar grupin “Brios dhe miqtë”. Pjesëmarrja e publikut në këtë koncert ishte e madhe, pavarësisht temperaturave të ulta. Moderimi i kësaj mbrëmje i ishte besuar Ketlin Pjalmit. Në skenë u ngjitën: Grupi “Brios”, Artemisa Mithi dhe Rigersa Zefi. I ftuar ishte humoristi Tan Brahim.

Data 13/12/2018 – Muzikë e zgjedhur me hitet më të fundit të huaja dhe shqiptare si dhe me karakter festiv nga D.J OLI. Aktiviteti u realizua përreth shtëpizave. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte e mirë.

Data 19/12/2018 – “Shkodra n’fest me shënd e verë dritash”. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me organizatën BID. I ftuar special i kësaj nate ishte këngëtari i mirnjohur Mateos Frroku.

Data 21/12/2018 – Muzikë e zgjedhur me hitet më të fundit të huaja dhe shqiptare si dhe me karakter festiv nga D.J OLI. Aktiviteti u realizua përreth shtëpizave. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte e mirë.

Aktivitetet e datave 22 dhe 23 dhjetor, të parashikuara për tu zhvilluar përreth shtëpizave, nuk u realizua dot për shkak të reshjeve të shumta të shiut.

Data 24/12/2018 – Orkestra Frymore e Qytetit, performancë artistike në sheshin para Bashkisë Shkodër. Banda performoi një repertor të pasur me marshe, pjesë festive dhe këngë qytetare shkodrane të përpunuara.

Data 26/12/2018 – Koncert i madh festiv me të ftuar këngëtaren shumë të njohur Rezarta Smaja & Band. Pjesëmarrja e publikut në këtë koncert ishte e madhe. Në skenë u ngjitën: Rezarta Smaja & Band dhe këngëtari shkodran Ylber Tahiri.

Data 30/12/2018 - Muzikë e zgjedhur me hitet më të fundit të huaja dhe shqiptare si dhe me karakter festiv nga D.J IRGI. Aktiviteti u realizua përreth shtëpizave. Pjesëmarrja e qytetarëve ishte e mirë.

P11.F2.O2.A10 “Festa e Muzikës”

Aktiviteti kulturorë “Festa e Muzikës” solli në Shkodër spektaklin “Maratona e Këngës” e cila u zhvillua në sheshin “Nënë Tereza” në datën 15 gusht 2018.

Në këtë koncert morën pjesë 22 këngëtarë e grupe muzikore, të përzgjedhur si më të mirët nga e gjithë shqipëria

Repertori i zgjedhur për maratonën e këngës ishte i zhanreve të ndryshme, si Popullore qytetare, Popullore të përpunuara, Pop, Rock etj. Moderatore e koncerti ishte Nevina Shtylla

Njohja e këngëve të zgjedhura për të përformuar në koncertin “Maratona e Këngës” nga ana e publiku bëri që atmosfera të ishte e ndezur deri në orët e vona.

P11.F2.O2.A12: “Festa e Trashëgimisë Kulturore”

“Festa e Trashëgimisë Kulturore”, e titulluar “Za Fest” u zhvilluan në datat 20-21-22 Korrik 2018 në Theth. Bashkia Shkodër për të dytin vit rradhazi mbështeti këtë aktivitet të madh festiv.

Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës së Thethit. “Zâ-Fest” konsiston në organizimin e një koncerti të madh festiv me të ftuar nga Shqipëria dhe më gjërë; Lojra popullore; Panair i produkteve vendore të zonës.

Data 20.7.2018 - Dita e parë filloj me Yoga Session duke vazhduar me panairin e punimeve artizanale dhe produkteve lokale duke vazhduar me performanca muzikore live nga artistët Linda Rukaj dhe Vlashent Sata. Gjithashtu për të gjithë të pranishmit u shfaq një film.

Data 21.7.2018 - Dita e dytë e cila ishte dhe dita e koncertit të madh filloi përsëri me Yoga Session, Hiking, panairin e punimeve artizanale dhe produkteve lokale. Koncerti i madh filloi në orën 18:00 dhe zgjati deri nga ora 12 e natës. U këndua kryesisht muzikë shiptare por edhe e huaj. Një koncert emocionues falë stilit origjinal të secilit prej artistëve.

Data 22.7.2018 - Dita e tretë dhe e fundit nisi përsëri me Yoga, Meditim dhe Hiking. Ato që patën mundësi shijuan dhe një ditë më shumë nga atraksionet e këtij vendi.

P11.F2.O2. A13: Honoraret anëtarët e këshillit kulturorë artistik.

Gjate 2018 Këshilli Artistiko Kulturor i Bashkise Shkoder i përbëre prej 7 anëtarësh funksionoi rregullisht. Ai mori në shqyrtim në bazë të një procedurë të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shkodër te reflektuar ne 6 mbledhjet e tij vjetore ne lidhje me zhvillimin e ketyre eventeve per 2018.

P11.F2.O2.A14 “Lëvizja e Postribës”

“ Lëvizja e Postribës” e njohur si lëvizja e parë antikomuniste në Shqipëri, e ndodhur më 9 shtator 1946, përkujtohet çdo vit nga Bashkia Shkodër.

Këtë vit përveç ceremonialit zyrtar u bë dhe promovimi i librit “Kryengritja e Postribës – Konferencë Shkrecore Kombëtare”, botim i Bashkisë Shkodër. Ky libër është i pari që i kushtohet tërësisht kësaj kryengritje, duke mbledhur dëshmi autentike dhe të dhëna historike shumë të rëndësishme.

P11.F2.O2.A16 Takim Kombëtar Bandash Frymore në Shkodër

Orkestra Frymore është një nga vlerat unikale që ka qyteti ynë dhe një nga trupat më të konsoliduara artistike, e cila vazhdon të funksionojë si formacion i rregullt, i atashuar pranë Bashkisë Shkodër dhe i menaxhuar nga Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”.Këtë vit, për herë të parë, Bashkia Shkodër zhvilloi “Takim Kombëtar të Orkestrave Frymore” në Shkodër në datat 26 dhe 27 shtator 2018.Në këtë takim morën pjesë 7 banda frymore.

Me datë 26 shtator në orën 17:00, të gjitha bandat ishin pozicionuar në rrugët e ndryshme të qytetit, ku duke përformuar gjatë gjithë rrugës do të mbërrinin në destinacionin final që ishte sheshi “Nënë Tereza”. Të gjitha bandat sëbashku luajtën marshe festive të cilat krijuan një atmosferë të jashtëzakonshme në qytet. Parada vazhdoi përgjatë gjithë rrugës “28 Nëntori” deri tek sheshi para Bashkise Shkodër për një performancë tjetër. Koncerti final u zhvillua në Teatrin “Migjeni”.

Data 27 shtator filloj me minikoncerte të bandave në pikat kryesore të qytetit. Në Muzeun Historik, banesa "Oso Kuka", u realizua ekspozita "AR-KA Tinguish", gjithashtu përfaqësuesit e bandave zhvilluan takimin me temë "E sotmja dhe e ardhmja e orkestrave frymore".

P11.F2.O1.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike që ka qyteti ynë. Ky formacion përbëhet nga 40 persona përfshirë dirigjentin dhe spalën e orkestrës. Ai ndër vite na ka bërë krenarë për emocionet e shumta që na ka dhuruar me realizimet e aktiviteteve artistike duke filluar nga koncerte-recitale, koncerte me rastin e festave kombëtare, parakalime në qytet, inagurime të ndryshme, përkujtime të figurave historike, pjesëmarrje në aktivitete jashtë vendit etj. Prandaj me të drejtë bashkia ketë vit e ka rritur shperblimin e artisteve.

P11.F2.O1.A4 Mbeshtetje per manaxhim te Teatrit Migjeni

Trupat artistike të atashuara pranë Teatrit "Migjeni" shpesh herë ftohen të marrin pjesë në aktivitete apo konkurse të ndryshme, brenda dhe jashte vendit. Në shumicën e rasteve, këto trupa kthehen me çmime të fituara me meritë nga këto aktivitete. Bashkia Shkodër e nxit dhe e mbështet çdo vit Teatrin "Migjeni" për të qenë pjesë e këtyre aktiviteteve. Jane realizuar dhe udhetime jashte shteti si ne : Podgorice te Malit te Zi, Presheve, Prizren, Gjakove, Ferizaj te Kosoves. Jane realizuar dhe udhetime brenda vendit si ne Tirane 3 here, ne Elbasan, Korçe, Butrint dhe Fier.

P11.F2.O1.A5 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"

Institucioni i Teatrit "Migjeni" është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 35 personash. Kjo fishe ka të bëjë me pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit "Migjeni".

P11.F2.O1.A9 Administrimi dhe menaxhimi i Qendres Kulturore Pjeter Gaci

Qendra e Kulturës "Pjetër Gaci" është institucion kulturor në varësi të Bashkisë Shkodër.

Ky institucion është vazhdues i traditave më të mira kulturore - artistike të Shtëpisë së Kulturës dhe Krijimtarisë Popullore e themeluar në vitin 1945.

Detyra kryesore e institucionit është ruajtja dhe evidentimi i vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore-artistike të qytetit e më gjërë dhe transmetimi i tyre në mënyrë sa më dinjitoze pa lënë mënjanë vlerat e reja që krijohen.

Krijon lidhje me institucione të tjera të profilit për zbatimin e politikave kulturore lokale dhe kombëtare. Gjithashtu bashkërendon punën me individë, shoqata apo institucione homologe në organizimin e aktiviteteve kulturore artistike.

Fusha e veprimtarisë së institucionit është e shtrirë në dy drejtime artistike të lidhura veçanërisht me sferën e muzikës.

- Aktivitete që lidhen me muzikën e kultivuar ku përfshihen formacione si:
 - Orkestra Frymore
 - Çmimi "Pjetër Gaci"
 - Koncerte Recitale

- Aktivitete që lidhen me muzikën dhe veprimtarinë popullore –folklorike të trevës sonë
 - Ansambli i Këngëve dhe Valleve.
 - Grupi i Valleve

Në qytetin e Shkodrës një ndër vlerat e spikatura të traditës dhe kulturës është kënga qytetare dhe vallja popullore tradicionale e shoqëruar dhe me element të tjerë origjinal si; kostumet, orkestracionet dhe interpretimet e larmishme. Institucioni që përfaqëson më së miri këto vlera është Qendra e Kulturës “P.Gaci” në varësi të Bashkisë Shkodër. Ky institucion me ansamblin popullor është përfaqësuar në evenimente të ndryshme kombëtare dhe më gjërë duke u vlerësuar me çmime të ndryshme herë pas here.

- Qendra Kulturore “P.Gaci” dhe Veprimtarinë e Saj Etnomuzikore, Koreografike.

Ky institucion e trajton trashëgiminë jomateriale shpirtërore folklorike si pasuri kombëtare që ruhet e zhvillohet në trojet shqiptare. Gjithashtu trajton si pasuri kombëtare të gjitha ato vlera të krijuara nga pakicat kombëtare e linguistike në Shkodër e më gjërë duke bashkëpunuar dhe me Qendren Kombëtare të Veprimtarive Folklorike që mban lidhje të vazhdueshme.

Merr pjesë në takime kombëtare, seminare, tryeza të rrumbullakta, takime pune në marrëveshje me institucione të tjera kulturore-artistike, shoqata kulturore si dhe grupe private që merren me artin dhe kultivimin e trashëgimisë jomateriale.

Ajo disponon një garderobë të pasur të zonave të veriut me veshje popullore kombëtare që përdoret kryesisht për aktivitetet kulturore.

QKPG-ja është i vetmi institucion lokal i specializuar në realizimin e Festivaleve Folklorike Tipologjike dhe në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.

Në realizim të kësaj detyre institucionale të vitit 2018 u realizuan këto aktivitete:

Orkestra Frymore:

- | | | |
|--|---|---------------------------------|
| • 2 prill | - | 2 prill Teatri Migjeni |
| • Gomari i Babatasit | - | 11 prill Teatri Migjeni |
| | - | 12 prill Teatri Migjeni |
| | - | 13 prill Teatri Migjeni |
| | - | 14 prill Teatri Migjeni |
| | - | 15 prill Teatri Migjeni |
| | - | 21 prill Teatri Migjeni |
| | - | 22 prill Teatri Migjeni |
| | - | 11 maj Teatri Kombetar |
| | - | 12 maj Teatri Kombetar |
| | - | 13 maj Teatri Kombetar |
| • Dita e Postribës | - | 9 shtator Postribë, Shkodër |
| • Gomari i Babatasit | - | 23 shtator Teatri Migjeni |
| • Takimi Ndërkombëtar i Orkestrave Frymore | - | 26 shtator Parada dhe Koncerti |
| | - | 27 shtator Parada në Qytet |
| | - | 27 shtator Ekspozitë dhe Biseda |
| • Gomari i Babatasit | - | 29 shtator Teatri Kombëtar |
| • Homazhe per Viktor Jubanin | - | 2018 nëntor |
| • Dita e Pavaresise | - | 28 nëntor |
| • Performancë artistike para bashkisë | - | 24 dhjetor |

Grupi i Valleve:

- | | | |
|-----------------------------|---|----------|
| - Vit të mbarë Shkodër | - | 8 janar |
| - Lojrat popullore | - | 21 prill |
| - Performancë para bashkisë | - | 6 maj |



- Dance konteporan - 7 maj
- Performancë, ardhja e ambasadoressë BE-së - 7 maj
- 15 vjetori i shoqatës "Dukagjini" - 13 maj
- Katerkoll (grupi i shkolles 9-vjecare) - 15 maj
- Festa e Thethit 2018 - Hapja zyrtare e sezonit turistik - 9 qershor
- Dita e Liqenit - 23 qershor
- 30-vjetori i bashkëpunimit Gjermani - Shqipëri festohet në Shkodër - 8 shtator, pedonale
- Panair - Tetor
- Java e Pamvarësisë - 24 nentor
- Koncert në bashkëpunim me "Treva e Dukagjinit" - 24 dhjetor

Aktivitetet e tjera:

- Edicioni i XV-të i FFTK i Këngës Popullore Qytetare, Elbasan 2018 - 10 mars, Elbasan.
- Çmimi "Pjetër Gaci"
 - 10 maj, Teatri Migjeni
 - 11 maj, Teatri Migjeni – shkolla e muzikes
 - 12 maj, Teatri Migjeni – shkolla e muzikes – galleria e arteve
 - 13 maj, Teatri Migjeni – Çmimi Special
- Ahengu Shkodran 2018 - 1 tetor, Muzeu Historik i Shkodrës
- Festivali i Rapsodeve - Grupi Instrumental "Shpresa" - 25 dhe 26 tetor, Lezhe.

Qendra Kulturore "P.Gaci" drejtohet nga përgjegjësi i saj, ka në staf dy specialistë muzike që janë edhe udhëheqësit artistik të programeve muzikore dhe një koreograf që drejton grupin e valleve. Ky staf me specialist të fushave përkatëse vazhdimisht kërkon ruajtjen e origjinalitetit dhe të cilësisë artistike.

P11.F2.O2.A16 Takim Kombëtar bandash frymore ne Shkodër

Me dt. 26-27 shtator 2018 u organizua në Shkodër "Takimi i parë ndërkombëtar i orkestrave frymore"

Ky aktivitet i cili mendojme që të kthehet në traditë pasi siç dihet Shkodra ka një traditë të hershme dhe të pasur në aktivitetin dhe rolin e bandave muzikore duke filluar që nga gjysma e dytë e shekulli XIX-të deri në ditët e sotme.

Ishte një bashkëpunim i sukseshëm i disa institucioneve kulturore mbështetur totalisht nga Bashkia Shkodër.

Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" Teatri 'Migjeni' Muzeu "Oso Kuka" në kordinim me zyren e cultures në Bashki bënë të mundur realizimin me sukses të këtij eventit të rëndësishëm artistiko- kulturor.

Në këtë aktivitet dy ditor morën pjesë 7 (shtatë) trupa artistike nga krahina të ndryshme të vendit si dhe Mali i Zi

- Ork.frymore "Afërdita" e Elbasanit
- Ork.frymore "Lekë Gjergji" e shkollës artistike Prenkë Jakova Shkodër
- Ork.frymore – Lezhe
- Ork.frymore e Bashkisë Durrës
- Ork.frym -Tivat
- Ork.frymoree Bashkisë Berat

- Ork.frymore e Bashkisë Shkodër

Ato treguan një seriozitet pjesmarrjeje duke ju përgjigjur kriterëve dhe platformes paraprake përpiluar nga stafi organizator.

Në programin dy ditor ishin planifikua:

- Parada në qytet
- Koncerte në pika të ndryshme të qytetit
- Tryezë e rrumbullakët
- Vizita në ambjente turistike
- Koncerti final me një minutazh të përcaktuar dhe vlersuar nga një Juri prestigjioze.

Aktiviteti u mbyll me një darkë gjithpërfshirëse në prani edhe të titullares së Bashkisë znj Voltana Ademi, e cila përshëndeti gjithë të pranishmit dhe garantoi vazhdimsinë e saj edhe në të ardhën.

P11.F2.O2.A17 Çmimi “Pjetër Gaci”

Edicioni 17-te çmimi “Pjetër Gaci” Takim për interpret te rinj të muzikes vokale-instrumentale 10-13 maj 2018

Aktiviteti zgjati për 4 ditë ; 3 ditë audicione dhe dita finale.

U konfirmuan për të marrë pjesë rreth 200 pjesmarres.

U paraqiten rreth 170 konkurentë në kategori dhe degë përkatëse.

Në dispozicion ishin 4 juri me profesionistë për disiplinen e Pianos, Harqeve, Intrumente të Frymës dhe Kanto.

U realizuan rreth 45 orë audicione për 3 ditë .

Audicionet u mbajtën në 3 ambjente artistike dhe u ndoqën nga rreth 400 artdashes ;

- Në skenen e teatrit ‘Migjeni 3 ditë (1 ditë kanto me 5 orë audicion dhe 2 ditë piano me 18 orë audicion)
- Në sallën e koncerteve “Gjon Kapedani” shkolla artistike “P.Jakova” (2 ditë harqe me 15 orë audicion)
- Në sallën e ‘Galerisë së Arteve Shkodër (1 ditë frymore me rreth 7 orë audicion)

Nata finale me 20 fitues absolutë në kategori dhe degë të ndryshme u mbajt në teatrin “Migjeni” me dt. 13 maj ora 18.00 dhe zgjati rreth 2.30 min, spektatorë pjesmarres ishin rreth 250 vetë.

Fitues i çmimit special “Pjetër Gaci” u shpall Klaudio Zoto –Tiranë, kategoria E, violoncel.

Fitue i çmimit “Paganini” u shpall Redio Stoli –Tiranë, kategoria F.

P11.F2.O2.A18 “Ahengu Shkodran”

Që nga viti 2013 kur ka startuar “Ahengu Shkodran” me iniciativën e Qendres Kulturore “Pjetër Gaci” nga viti në vit ka ngjallur interes të madh për artdashësit shkodranë por edhe më tej.

Pa ndryshuar thelbin e kesaj vlerë që tashmë e dimë që është shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë kulturore kombëtare formati I këtij aktiviteti ka ndryshuar nga viti në vit duke I dhënë përparësi edhe interpretimit të këngëtarëve të rinj që fratmirësisht në Shkodër nuk mungojnë.

Këtë edicion të fundit ‘Ahengu Shkodran kishte në qendër të vëmendjes rikthimin e grupit “Karajfilat që ka Shkodra’ në 35 vjetorin e themelimit, tashmë të rinovuar edhe me elementë rinj. (Pasi siç dihet grupi ka patur aktivitetin e tij kulmor në vitet 80- të e në vazhdim.

Ngjalli shumë emocione dhe tregoj një nivel të lartë interpretimi edhe të grupit të rinovuar. Për këtë eveniment u krijua dhe një këngë e re nga mjeshtri ZEF ÇOBA me tekst të Ramazan Çeka “Karajfilat prap këndojnë”

Meritë ka dhe bashkëpunimi me formacionin muzikor të teatrit “Migjeni” në drejtimin e Ilir Zoga dhe stafi i Muzeut ‘Oso Kuka, padyshim dhe interesi dhe mbështetja e Bashkisë Shkoder

P11.F2.O2.A19 Honorare " Grupi i Valleve"

Grupi i valleve ka një traditë në vite me një numër të madh pjesëmarrësish dhe drejtuesish të njohur, të cilët kanë kontribuar në shumë aktivitete të ndryshme, duke na lënë një pasuri të çmuar në këtë fushë. Ky grup mori pjesë në shumë aktivitete që janë organizuar në qytete si:

- | | | |
|--|---|---------------------|
| - Vit të mbarë Shkodër | - | 8 janar |
| - Lojrat popullore | - | 21 prill |
| - Performancë para bashkisë | - | 6 maj |
| - Dance konteporan | - | 7 maj |
| - Performancë, ardhja e ambasadoressë BE-së | - | 7 maj |
| - 15 vjetori i shoqatës “Dukagjini” | - | 13 maj |
| - Katerkoll (grupi i shkolles 9-vjecare) | - | 15 maj |
| - Festa e Thethit 2018 - Hapja zyrtare e sezonit turistik | - | 9 qershor |
| - Dita e Liqenit | - | 23 qershor |
| - 30-vjetori i bashkëpunimit Gjermani - Shqipëri festohet në Shkodër - | - | 8 shtator, pedonale |
| - Panair | - | Tetor |
| - Java e Pamvarësisë | - | 24 nëntor |
| - Koncert në bashkëpunim me “Treva e Dukagjinit” | - | 24 dhjetor |

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët shpërblehen me honorare për 10 muaj të vitit

P11.F2.O2.A20 Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”

Festivali kete vit u organizua ne dy nete, ku u interpretuan 16 kenge, Ato u perzgjodhen nga nje numer i madh kengesh te ardhura jo vetem nga qyteti yne por dhe nga qytete te tjera dhe nga nje zhuri profesioniste.

Mendoj se festivali i sivjetshem, megjithe veshtiresite qe hasen ne keto aktivitete te medha, ja arriti te ngjadhete interes tek publiku, fale edhe dy edicioneve te meparshme te ketij festivali, te cilet kane lene gjurme tek artedashesit shkodran. Sfida e ketij edicioni ishte qe ne rradhe te pare te mos binim me poshte se te kaluarit dhe ne rradhe te dyte, te mund te permirsonim ndonje element qe c’do staf i ri pretendon te arrije.

Materiali muzikore dhe letrar, ne pergjithesi ishte me nivel te kenaqshem artistik. Ato arriten te krijonin mundesine qe kengetaret te na sillnin performanca te mira. Vlet te permendet niveli interpretativ I kengetareve, qe per hir te vertetes, jane figura te spikatura kombetare duke filluar nga Bujar Qamili, Rezarta Smaja, Mukades Qanga, Lidia Lufi, Artemisa Mithi etj te cilet I dhane nje vlere te shtuar kengeve te interpretuar nga ato.

Dua te theksoj nje element shume te rendesishem te festivalit, e cila eshte orkestra. Ajo tingelloj mjaft mire dhe u drejtua nga tre dirigjente: Jetmir Barbullushin, i cili vjen per here te dyte ne kete festival, Kujtim Alia dhe Ilir Zoga te cilet ndikuan edhe ne rritjen e performances se kesaj orkestre, e gjitha me instrumentiste shkodran.

Elemente shume I rendesishi I spektaklit eshte dhe skenografia e cila u projektua nga Adnan Kastrati dhe I dha nje freski pamore gjithe festivalit. Motivi i lules se “kenges qytetare shkodrane” shoqeronte cdo pjese te skenes duke na futur ne atmosferen e obborreve shkodrane.

Materiali letrar u pregatit me finese dhe pa ekzagjerime nga Ermira Alia. Ai tingelloj mjaft i kendshem dhe me humor i servirur bukur nga aktorja e humorit Rudina Dembaqe dhe vendosjes ne skene nga regjisorja e spektaklit, Rita Gjeka.

Nje nga pikat e mira te ketij festivali ka qene dhe organizimi i tij nga zyra e kultures prane bashkise dhe drejtoria e teatrit “Migjeni”.

P11.F2.O2.A21 “Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”

Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturorë “Pjetër Gaci”, ditën e marte, dt. 27.11.02018, ora 11:00, në pedonalen “Kole Idromeno”, organizuan koncert festiv me pjesëmarrjen e Orkestrës Frymore të qytetit. Në këtë aktivitet ishte dirigjent: Kujtim Alia (Mjeshtër i Madh).

Performanca e ketij koncerti ne ambjente te hapura u pelqye shume nga publiku duke kerkuar dhe shfaqje te tjera te ketij lloji.

P11.F2.O2.A22 “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”

Në dt. 11 dhe 12 Mars 2018 në kuader të festes së veres në Elbasan u organizu Festivali mbarëkombëtar Folklorik Tipologjik i Këngës Popullore Qytetare. Mbështetur nga Ministria e Kultures në bashkëpunim me Qendrat Kulturore në rrethe.

Për dy netë me rradhë u ngjiten në skenen e teatrit Skampa rreth 15 grupe konkurruese të Qendrave Kulturore dhe shoqatave artistike në mbarë trevat shqiptare, me kritere të përcaktuara qartë për ruajtjen e vlerave që përfaqëson kënga popullore shqiptare, dhe sejcili grup sjell vlerat e vehta autentike. Grupi i Shkodres pranë Qendres së Kultures “Pjetër Gaci” në bashkërendim me orkestren e teatrit “Migjeni” dhe me mbështetjen e Bashkisë me një grup prej rreth 20 artistesh të afirmuar dhe të rinj e vlerësoj maksimalisht këtë eveniment.

Ajo çfarë ishte e rëndësishme në këtë pjesmarrje të trupes së Shkodres ishte gjithpëfshirja dhe sidomos elementi i ri. Juria vlerësoi Marjana Begu si këngëtarja më e mirë për të rinj.

P11.F2.O2.A24 Festival burimor

Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” u prezantuan me grupin instrumental “Shpresa” në edicionin e 10-të të “Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullore” në Lezhë me datat 25-26 tetor 2018.

Grupi Instrumental “Shpresa” pranë shoqatës “Bashkimi kënga jonë” përgatitur nga Rrok Gjelaj përfaqësuan me dinjitet qytetin tonë nën kujdesin e QKPG dhe Bashkisë Shkodër ku rapsodi i ri Gabriel Rraposhi u vlersua me Çmimin Inkurajues.

Në festival morën pjesë rreth 15 grupe nga trevat e ndryshme shqiptare me rreth 170 artistë.

U ndanë 9 çmime; Çmimi; Ndue Shyti, Dervish Shaqja, Gjokë Nonaj, Çmimi i Karrierës, 2 Çmime instrumentisti më i Mire, Çmimi inkurajues, Çmimi për vitin e Skënderbeut.

Aktiviteti u organizua në Lezhë nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Ministria e Kultures dhe Bashkia Lezhë.

P11.F2.O2.A27 Dita nderkombetare e Jazz-it

Ky projekt u zhvillua me date 30 Prill 2018, dite perkujtimore nderkombetare per muziken Jazz. Aty moren pjese 20 artiste nderkombetar organizuar ne bashkepunim me shoqaten Hemingej Tirana dhe Institutin Italian te Kultures. Pjesmarrja e publikut shkodran ishte masive dhe mbushi plot gjalleri edhe rruget kryesore te qytetit. Artistet me performance perfshine ne kete feste dhe qytetaret shkodrane. Me pas aktiviteti u zhvendos ne ambjentet e teatrit Migjeni deri ne oret e vona nepermjet performancave te lira te artisteve.

P11.F2.O2.A28 Drame

Në teatrin “Migjeni” u shfaq premiera “Jugori” me autor: Rainer Eerner Faassbinder, Regjisor: Dino Mustafic, As/Regjisor: Melisa Becovic, Skenograf: Sadik Spahija, Koreograf: Gjergj Prevazi, Kostumografe:

Merita Spahija, Përkthyes: Nancy Bakalli, Kompozitor: Zef Çoba, Piano: Klevis Gjergji, Këngëtar: Laorjan Ejlli dhe videot e shfaqjes u realizuan nga Juli Vuka.

Shfaqja flet për mungesen e gatishmërisë për të pranuar atë që është ndryshe sipas orientimit seksual, racor, fetar dhe përkatësi etnike. Në shfaqje u bë adoptimi përmes rrëfimit personal me të cilin kombinohet teksti origjinal i Fassbinder. Shfaqja u bazua në hulumtimet sociologjike, intervistat e emigrantëve në Europë, të dhënat nga forumet e internetit dhe materialet dokumentare si dhe deklaratave të bashkë atedhetarëve tan mbi temen e ksenofobisë.

Ky ishte një nga projektet më të mëdha teatrore në Shkodër me ndërthurjen multimediale kërkesave të produksionit organizimit dhe numrit të bashkëpunëtorëve.

Shfaqja u dha në datat 21-22-23 Dhjetor, nr spektatorëve ishte rreth 500 persona.

P11.F2.O2.A29 Komedi

Në teatrin “Migjeni” u shfaq premierë një nga kryeveprat e At Gjergj Fishtës “ Gomari i Babatasit” Sarkazma therëse e Fishtës mbi deputetët e ministrat abuzivë ishin përshtatur me aktualitetin, duke marrë vlerësim të spektaktorit Shkodranë dhe jo vetëm. Me Regji të Altin Bashës, Skenografi dhe Kostumografika të Iliriana Loxha-Bash, Koreografi të Gjergj prevazit dhe Muzika nga Kompozitori Endri Sina. Pjesëmarrës në shfaqje ishte dhe Orkestra Frymore e Qytetit të Shkodrës nën drejtimin e dirigjentit Kujtim Alia të cilët ekzekutuan të gjitha pjesët muzikore. Shfaqja u dha 12 here, 7 here në Shkodër dhe 3 herë në Tiranë ku pati 4668 spektatore. Në Festivalin Kombëtar të Teatrove shfaqja “Gomari i Babatasit” mori dhe çmimin “Regjisori më i mirë”

P11.F2.O2.A30 Tragjikomedi

Për shfaqjen e Tragjikomedise, shpenzime skenografisë janë realizuar dhe pagesat për honoraret janë të mbartura si borxh të cilat do të likuidohen në muajt e parë të vitit 2019, sapo kjo premiere të jete gati për tu shfaqur.

P11.F2.O2.A31 Variete

Premiera “Humor me shkollë të mesme” u shfaq në datat 1-2-3-4 Nëntor 2018 nga Estrada Profesioniste e Teatrit “Migjeni”. Libreti u realizuar nga Arjan Çuliqi, Regjisor Besnik Çinari, Drejtues Muzike: Ilir Zoga. Në këtë shfaqje të ftuar ishin dhe figura të njohura të futbollit shkodranë dhe më gjerë. Po ashtu morën pjesë dhe këngëtarët profesionist të teatrit “Migjeni” dhe të ftuar. Shfaqja pati rreth 2000 spektatorë. Libreti i shfaqjes ironizon problematikat e ditës si bixhozi, shërbimi shëndetësorë dhe gjendjen aktuale të ekipit futbollit të Vllaznisë. Pjesëmarrës në këtë shfaqje ishin aktorët Zyliha Miloti, Besnik Çinari, Drande Xhai, Anton Krosa, Muhamet Çekini, Gac Kodrina, Fritz Selmani, Astrit Fani dhe Pëllumb Gjonaj

dhe këngëtarët Mukades Çanga, Violeta Zefi, Bujar Qamili, Rezarta Smaja, Orjeta Kelaj, Laorjan Ejlli dhe Leonard Guga.

P11.F2.O2.A32 Shfaqje për femije

Për kete projekt jane realizuar shpenzime skenografisë dhe pagesat per honoraret janë të mbartura si borxh te cilat do të likuidohen në muajt e parë të vitit 2019, kur te realizohet shfaqja.

P11.F2.O2.A33 Teatri i Kukllave

Aventurat Tif, Taf Tufit një shfaqje e realizuar nga autori dhe regjisori Ilir Dragovoja. Shfaqja u dha 3 ditë dhe pat një numër të konsiderueshëm spektatorësh nga shkolla te ndryshme fillore te Bashkise Shkoder. Duke qenë se ishte një shfaqje e veçantë në llojin e saj u investua shumë kohë parapërgatitje që aktorët të mësonin menyrën e lëvizjeve të materialeve të përdorura. Tashme keto aktore te rinj do jene perhere te ftuar prane Teatrit Migjeni per performanca te ndryshme ne kete teater.

P11.F2.O2.A34 "Pranvere me kange"

Ne teatrin "Migjeni" me datat 4-5 maj eshte zhvilluar koncerti "*Prandverë me kangë 2018*".

Ky koncert, tashme tradite disa vjeçare ne qytetin tone, eshte pjese e rendesishme e projekteve kulturore te Bashkise Shkoder.

Koncerti "Prandverë me kangë" vit pas viti ka synuar te sjelle me kenge pranveren ne skenen e teatrit "Migjeni" nepermjet repertorit shume te bollshem dhe te larmisem te kengeve me te zgjedhura te qytetit tone dhe jo vetem, te kenduara me pasion dhe profesionalizem nga zerat me te mire te qytetit.

"Prandverë me kangë 2018" erdhi me ndryshe se vitet e tjera pasi u konceptua dhe u realizua mbi idene e prurjes ne skene te kengeve me te sukseshme te muzikes se lehte te krijuar nga kompozitore shkodrane. Keto kenge u interpretuan me profesionalizem nga kengetaret e rinj te qytetit.

Pjese e repertorit te ketij koncerti ishin dhe kenge nga dy festivalet "Lule bore".

Perzgjedhja me kujdes e kengeve dhe interpretimi dinjitoz i kengetareve realizuan me se mire pritshmerine e ketij koncerti. Kjo u vu re nga duartrokitjet e perzemerta te spektatoreve, te cilet u bene pjese e shfaqjes duke kenduar thujse te gjitha kenget bashke me kengetaret.

P11.F2.O2.A36 Viti kulturor Shqiperi-Austri

Shfaqja teatrale "Rrethi" u realizuar në kuadër të vitit kulturor Shqipëri – Austri, i cili është një bashkëpunim i teatrit "Migjeni me Ambasaden Austriake. Shfaqja u dha në datat 14,15,16 shtator me autor "Arthur Schnitzler" dhe Regjisori Alois Galle. Shfaqja ndertohe mbi dhjetë dialogje të cilat vendosen përballë njërit-tjetrit. Shfaqja flet per gënjeshttra, mashtrime dhe lakmi. Vdekja është një tjetër mendim, i cili nuk i ndahet personazheve të pjesës, ajo nxit tundimin për të shijuar momentin.

P11.F3.O1.A2:Periodiku Gegnia

Kjo revistë ka karakter kulturor dhe përfshin një gamë të gjërë artikujsh që kanë lidhje me gjuhën, letërsinë, artin, albanologjinë, historinë etj. Promovimi i kësaj reviste pati jehonë pozitive dhe interesi për të ishte i lartë. Revista "Gegnia" ka arritur në numërin e shtate te saj, i regjistruar me ISSN përkatëse, me orientim kulturor dhe është e hapur për të gjithë shkrimtarët e rinj dhe profesionistë.

P11.F3.O1.A3 Festivali Letrar i Shkodrës

Përveç punës kërkimore shkencore që Biblioteka "Marin Barleti" ka në punën e saj të përditshme, ajo gjatë gjithë vitit organizon edhe veprimtari kulturore që kanë ndikim tek publiku. "Festivali letrar i Shkodrës" zhvilloi edicionin e njembdhjete të tij këtë vit. Ky festival, i konceptuar si një forum letrar, i dedikohet kryesisht shkrimtarëve shkodranë që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por gjithashtu synimi i këtij festivali është edhe të jetë një urë lidhëse me shkrimtarë të hapësirave shqiptare.

Këtë vit festivali u zhvillua i ndarë në kater takime me shkrimtarë të ndryshëm dhe target grupe të ndryshme si me poshte:

- | | |
|--------------------|----------------|
| 1 Gerda Mulder | dt. 05.10.2018 |
| 2. Hysen S.Dizdari | dt.12.10.2018 |
| 3. Xhahid Bushati | dt.13.10.2018 |
| 4. Agron Tufa | dt.27.11.2018 |

Si dhe takime me shkrimtarët e meposhtem:

- | | |
|------------------------------------|----------------|
| 1. Andrea Dushi | dt. 12.10.2018 |
| 2. Skender Temali | dt. 20.10.2018 |
| 3. Violeta Volumi | dt. 25.10.2018 |
| 4. Paulin Ujka & Njazi Kazazi | dt. 03.11.2018 |
| 5. Edlira Llukaçaj | dt. 17.11.2018 |
| 6. Edmond Buharaja & Qamil Gjyrezi | dt. 24.11.2018 |

Gjate muajit nëntor Biblioteka Marin Barleti ka marrë pjesë aktive në **"Fushata Kombëtare e Leximit" duke organizuar takimet e meposhteme në koshtet dhe shkollat fillore:**

- | | |
|-------------------------------------|----------------|
| 1. Kopështi "Zemra e gëzuar" | dt. 01.11.2018 |
| 2. Kopështi "Ismet Sali Bruçaj" | dt. 02.11.2018 |
| 3. Kopështi "Borëbardha" | dt. 06.11.2018 |
| 4. Kopështi "Aromë trendafili" | dt. 09.11.2018 |
| 5. Shkolla "Haxhi Sheh Shamia" | dt. 14.11.2018 |
| 6. Shkolla "Dëshmorët e Prishtinës" | dt. 16.11.2018 |
| 7. Shkolla "Branko Kadia" | dt. 19.11.2018 |
| 8. Shkolla "Pashko Vasa" | dt.22.11.2018 |
| 9. Shkolla "At Gjon Karma"-Gur i Zi | dt. 23.11.2018 |
| 10.Shkolla "Maria Ndiqmetare" | dt.26.11.2018 |

P11.F3.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin e nevojave për edukim dhe çlodhje të komunitetit.

Bashkia Shkodër çdo vit mbështet Bibliotekën "Marin Barleti" në pasurimin e fondeve të saj. Edhe këtë vit Biblioteka "Marin Barleti" shtoi numrin e fondeve të saj, në letërsi të huaj, në fondin për fëmijë, fondin e autorëve shqiptar, albanologji dhe fondin e gjuhëve të huaja.

P11.F3.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi i degës ekonomike të kulturës

Dega Ekonomike e Kulturës ka strukturën e mëposhtme prej 28 punonjesh ku janë paguar Paga dhe Sigurimet Shoqërore për punonjësit e mëposhtëm: në Bibliotekën Publike "Marin Barleti" 14 punonjës; Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetese 8 punonjës, Muzeu Historik 5 punonjës; dhe GASH 1 punonjës. Gjithashtu janë mbuluar shpenzime për shërbim nga tre; materiale kancelarie; materiale të ndryshme mirëmbajtje; sigurim ndërtesë; rimbushje fikse zjarri, sistem kondicionimi dhe kondicionere; është realizuar dhe mirëmbajtja e 5 ëebpage dhe i faqes O-PAC.

Fondet e financimit të programit:

Fondet e miratuara për këtë program janë 85776 mijë lekë dhe realizimi për periudhën 12 mujore është 72123 mijë lekë, në masën 84% .

Fondet për shpenzimet korrente sipas planit 2018 janë:

- Paga e sigurime janë realizuar në masën 30 547 mijë lekë nga 35240 mijë lekë që ka qene e parashikuar. Realizimi në masën 87%.
- Shpenzime operative janë realizuar në masën 28 906 mijë lekë nga 35 531 mijë lekë që ka qene e parashikuar. Realizimi në masën 81%.
- Transferta janë realizuar në masën 7076 mijë lekë nga 7081 mijëlekë parashikuar. Realizimi në masën 100%.
- Investimet janë realizuar në masën 5 594 mijë lekë nga 7 925 mijë lekë të parashikuara. Realizimi në masën 71%.

Sipas kërkesës të Teatrit Migjeni, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me vendim nr prot 194 date 09.08.2018 është pakesuar fondi prej 200 000 leke tek fishprojekti Festivali Burimor dhe i është kalur si shtese projektit Koncert premiere e orkestres frymore.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare:

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Plani Korrigjuar	Realizimi 12- mujori 2018 në mijë lekë
P11.F1.O1 .A1 "Java e Pavaresise" Ekspozitë etnografike me elemente kostumografie dhe zejesh	30	30	20
P11.F1.O1.A4 Hartim dhe konceptim projekti arkitektonik dhe inxhinierik për rikonstrukcion godines se Muzeut Oso Kuka	300	300	300
P11.F1.O1.A5 Mbeshtetje për funksionimin e	450	450	334



aktivitetit dhe shërbimin në vazhdim të Muzeut historic.			
P11.F1.O1.A8 Rikonstruksion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër.	1,000	100	0
P11.F1.O1.A9 Publikime promocionale, fletëpalosje e guide për vendin e Dëshmës e Kujtesës	150	150	119
P11.F1.O1.A10 Cikël bisedash dhe ndërgjegjësim i të rinjve në fokusin e librave me tematikë mbi të kaluarën komuniste.	70	70	20
P11.F1.O1.A11 Mirembajtje ndërtesës VDK	300	300	240
P11.F1.O1.A13 Dita ndërkombëtare e Muzeumeve. Ekspozitë tematike.	30	30	26
P11.F1.O1.A14 Ekspozita “Salloni i vjeshtës”	465	465	449
P11.F1.O1.A15 Çmimi “Idromeno”.	350	350	154
P11.F1.O1.A.16 “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.	140	140	106
P11.F1.O1.A17 Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe ërkshp me artistë të rinj	150	150	123
P11.F1.O1.A18 Aktivitete në partneritet me shoqata kulturore.	100	100	68
P11.F1.O1.A19 Përgatitje dhe ekspozim të portreteve të kryetarëve të Bashkisë Shkodër ndër vite.	875	875	0
P11.F2.O1.A2 Realizimi i Memorialit për të persektuarit politikë.	2 700	2700	2688
P11.F2.O1.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore	4532	4532	3298
P11.F2.O1.A4 Mbeshtetje për menaxhim të Teatrit Migjeni	6071	6071	5257
P11.F2.O1.A5 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni”	19071	19071	17362
P11.F2.O1.A9 Administrimi dhe menaxhimi i Qendres Kulturore Pjetër Gaci.	3559	3559	2715
P11.F2.O1.A10 Blerje pajisje fonie për Teatrin Migjeni	1555	1555	1495
P11.F2.O2.A1 “Dita e Luleve” 6 Maj	500	500	500
P11.F2.O2.A2 “Ndërmendje”	1,100	1100	1100
P11.F2.O2.A3 Fjala artistike me nxenesit e shkollave të mesme në nderim të figurave të shquara.	300	300	255
P11.F2.O2.A4 Aktivitete me rastin e “2 Prillit”	270	270	257
P11.F2.O2.A5 Festival Jazz-it	1500	1500	1500
P11.F2.O2.A6 Karnavalet	560	560	560
P11.F2.O2.A7 Koncertet e verës	600	600	600



P11.F2.O2.A9 Shkodra n'fest.	600	600	600
P11.F2.O2.A10 Festa e Muzikës	500	500	495
P11.F2.O2.A12 Festa trashëgimise kulturore	1,000	1000	1000
P11.F2.O2.A13 Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik.	200	200	171
P11.F2.O2.A14 "Lëvizja e Postribës"	100	100	88
P11.F2.O2.A16 Takim Kombëtar bandash frymore ne Shkodër.	1500	1500	1367
P11.F2.O2.A17 Çmimi "Pjetër Gaci"	1309	1601	1309
P11.F2.O2.A18 "Ahengu Shkodran"	478	478	397
P11.F2.O2.A19 Honorare " Grupi i Valleve".	720	720	550
P11.F2.O2.A20 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë".	2,500	2500	2500
P11.F2.O2.A21 "Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore"	434	434	373
P11.F2.O2.A22 "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare"	320	320	238
P11.F2.O2.A24 Festival burimor.	200	0	0
P11.F2.O2.A27 Dita nderkombetare e Jazz-it	200	200	200
P11.F2.O2.A28 Drame	1,795	1795	1671
P11.F2.O2.A29 Komedi	2150	2150	2079
P11.F2.O2.A30 Tragjikomedi	900	900	899
P11.F2.O2.A31 Variete	1005	1005	974
P11.F2.O2.A32 Shfaqje per femije	700	700	686
P11.F2.O2.A33 Teatri i Kukllave.	300	300	300
P11.F2.O2.A34 Pranvere me kange	650	650	506
P11.F2.O2.A36 Viti kulturor Shqiperi- Austri	1500	1500	1472
P11.F3.O1.A2 Periodiku gegnisht	378	378	339
P11.F3.O1.A3 Festivali letrar i Shkodrës	50	50	43
P11.F3.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	1370	1370	948
P11.F3.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës	18097	18097	13371
Total	85776	85776	72123

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12-mujorin 2018

- Rikonstrukcion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër nuk është realizuar për shkak të kompleksitetit të projektimit të tij dhe pamundësisë së hartimit të një projekti sipas standarteve të duhura.

- Projekti për realizimin Përgatitje dhe ekspozim të portreteve të kryetareve të Bashkisë Shkodër ndër vite nuk është realizuar për shkak të mungesës së theksuar të stafit në Galerine e Arteve, staf i domosdoshëm për udhëheqjen e procesit të realizimit të këtij projekti.

P12 Rinia dhe Sportet

Programi për rininë ofron shërbime specifike në lidhje me a) Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj., b) Vlerësimin e nevojës për mbështetje të rinjve; c) Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore; d) Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

Nëpërmjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumësportësh “Vllaznia” dhe Klubi i futbollit “Vllaznia”.

Në përbërje të Klubit shumësportësh “Vllaznia” mbështeten ekipet në disiplina të ndryshme sportive.

Pjesë përbërëse e programit në mbështetje të sportit të futbollit është mbështetja dhe financimi i ekipeve zinxhir të grupmohave të ndryshme pjesë e Akademisë së Futbollit “Vllaznia”.

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2018, për synimet e saj në zhvillimin e sportit është përqendruar në këto funksione zhvillimi:

F1. Programet dhe projektet rinore.

F2. Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat për secilin funksion janë si më poshtë:

F1.01. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

F2.01. Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet

F2.02. Garantimi i pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit “Vllaznia” në Kampionatet kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore.

Produktet për vitin 2018

Drejtoria e Kulturës, Arsimit Rinisë dhe Sportit, gjatë vitit 2018 ka punuar për përmbushjen e funksioneve dhe objektivave të caktuara sa më sipër nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

P12.F1.O1.A2 Kampionati I lojërave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka organizuar kampionatin e lojërave me dorë mes shkollave të Bashkisë Shkodër në Javën e Pavarësisë. Kampionati u zhvillua në datat 25 dhe 26 nëntor mes 4 shkollave, përkatësisht '28 Nëntori', 'Oso Kuka', 'Jordan Misja' dhe 'Shejnaze Juka'. Ky kampionat po kthehet në traditë tashmë për qytetin ku përveç angazhimit të rinjve në fushën e sportit, shërben edhe për evidentimin e talenteve të reja. Aktiviteti kishte interes të lartë ku kishte rreth 3000 shikues nxënës, mësues e dashamirë të sportit përgjatë të tre ditëve të zhvillimit të tij. Në përfundim të aktivitetit ishte shkolla 'Oso Kuka' e cila doli fituese për femra dhe shkolla '28 Nëntori' e cila mori trofeun e djemve.

P12.F1.O1.A3 Maratona e pavarësisë Ulqin - Shkodër 2018.
Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit pranë Bashkisë me datën 25 Nëntor 2018, në kuadrin e festimeve të Javës së Pavarësisë, ka organizuar Maratonën e Pavarësisë, me nisje nga Ulqini për në Shkodër, 42 km e gjatë, me pjesëmarrjen e 90 sportistëve maratonistë. Në këtë maratonë, në kategorinë meshkuj dolën fitues 3 sportistë përkatësisht në vend të parë Aleksandar Kiradjev, Shkup Maqedoni, në vend të dytë Adrian Decani, Kosovë, vendi i tretë Zhelko Mllovic, Serbi. Ndërsa në kategorinë e femrave ku vendi i parë ishte Biljana Kiradzieva, Novi Pazar Serbi, vendi i dytë, Qëndresa Ramadani Kosovë, dhe vendi i tretë Rita Zeqiri nga Kosova. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Komunën Ulqin dhe Këshillin Kombëtar i Shqiptarëve në Ulqin. Aktiviteti u ndoq nga qindra qytetarë të mbledhur para sheshit të Bashkisë si dhe sportdashës të ndryshëm që kishin ardhur posaçërisht për të shprehur mbështetjen e tyre për sportistët pjesëmarrës.

P12.F1.O1.A4 Promovimi i lojës së shahut në Shkodër.
Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar. Këtë vit kampionati u organizua në 3 faza. Faza e parë ishte për fëmijët e shkollave 9-vjecare, ku fituesit e kësaj faze kalonin në fazën tjetër dhe përballeshin me gjimnazistët. Faza e fundit dhe përfundimtare u zhvillua në Bashkinë Shkodër ku morën pjesë më të mirët e 2 fazave të para dhe veteranët e këtij sporti. Aktiviteti u përbyll duke shpallur kampionin e qytetit.

P12.F1.O1.A5 Aktivitete sportive beach volley massive dhe profesioniste.
Sektori i Arsimit Rinisë dhe sportit pranë Bashkisë gjatë muajit Korrik 2018 ka mbështetur aktivitete sportive (beach volej) në plazhin e Velipojes në datat 27/28/29. Ky aktivitet përgjatë 3 ditëve tërhoqi vëmendjen e rreth 1000 pushuesve, sportistëve dhe sportdashësve. Pjesëmarrja ishte e gjërë ku morën pjesë 21 ekipe meshkujsh dhe 7 ekipe femrash. Ky aktivitet u mbështet dhe nga katërshja e arbitrave të cilët dhanë një mbështetje me vlerë në mbarëvajtjen e kampionatit që konsistuan në mbajtjen e ndeshjeve, zgjidhjen e kontestimeve të dala here pas here nga sportistët, mbajtjen e rregullt të pikëve, përcaktimin e skuadrave fituese si në fazën pre eliminatorë, eliminatorë dhe në atë finale.

P12.F1.O1.A8 Revista Sportive Vllaznia
Duke vazhduar traditën dhe duke qënë një nga SK me rezultate më të larta në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare, Bashkia Shkodër në projektet e saj për 2018 pati edhe Revistën e dytë sportive

“Vllaznia”. Në këtë Revistë u pasqyruan disiplinat dhe sportistët që luajnë nën logon e KF Vllaznia dhe SK Vllaznia. Me anë të kësaj reviste synohet promovimi i sporteve dhe sportistave të qytetit të Shkodrës.

P12.F2.O2.A9 Aktivitet sportiv ndërkombëtar, "Memorial Vllaznia 2018" në boks.

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë perbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 3 trajnerë.

Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 14 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marrë medalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithsej 42 medalje. Ky aktivitet ndërkombëtar ka 14 vite që organizohet në qytetin e Shkodrës duke promovuar kështu vlerat e kesaj disiplinë, të qytetit dhe sportistave elitare dhe atyre që duan të promovohen.

P12.F2.O1.A10 Mirënjohje për sportistët dhe trajnerët më të mirë.

Në fund të cdo viti si traditë që vazhdon, evidentohen sportistët dhe trajnerët më të mirë duke i dhënë një mirënjohje për punën e palodhur të tyre, si dhe duke i promovuar edhe me shumë para qytetit. Këtë vit u mbajt një mbrëmje gala për të nderuar jo vetëm sportistët më të mirë të vitit por edhe figurat e shquara të cilët e cuan emrin e Vllaznisë në nivele të larta të sportit kombëtar e ndërkombëtar.

P12.F2.O1.A12 Aktivitet ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’ Xhudo

Bashkia Shkodër mbështet turneun ndërkombëtar të xhudos i cili zhvillohet për të 17 vit rradhazi. Ky turne mbahet në 2 ditë në datat 15-16 qershor dhe kishte pjesëmarrje të gjërë nga të gjitha vendet e rajonit. Turneu ishte në kategoritë Junior, Kadet dhe Senior ku gjithsej morën pjesë 2000 sportistë të cilët kurrkuan në 8 pesha të ndryshme. Ekipi më i mirë u shpall ekipi i xhudos Vllaznia ku mori vendin e parë. Në vend të dytë doli ekipi i xhudos nga Bosnje-Herzegovina, dhe vendin e tretë e mori ekipi nga Mali i Zi.

P12.F2.O1.A13 Aktivitet ndërkombëtar Çiklizëm.

Spektori i Arsimit Rinisë dhe Sportit më qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive në programin e rinisë dhe sportit ka parashikuar për vitin 2018 Aktivitetin Ndërkombëtar në Çiklizëm në datat 20 dhe 21 prill 2018. Morën pjesë 50 çiklistë në kategori dhe nga klube të ndryshme si Vllaznia, Tirana, Partizani, Teuta, Burreli, Elbasani, Besa, Apollonia, Flamurtari dhe Skenderbeu. Ditën e parë dolën fitues në kategorinë kadet/junior Fushë Krujë - Shkodër 67.7 km 1. Bruno Kola (Vllaznia) 2. Astrit Kronaj (Vllaznia) 3. Maringlen Xheleku (Tirana). Aktiviteti kishte interes të lartë pasi u ndoq nga qindra qytetarë, ish sportistë si dhe u përshëndet nga presidenti i Federatës Shqipëtare të Çiklizmit.

P12.F2.O1.A15 Aktivitet ndërkombëtar në atletike, për sallat e hapura.

Spektori i Arsimit Rinisë dhe Sportit më qëllim pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive në programin e rinisë dhe sportit ka parashikuar për vitin 2018 Aktivitetin Ndërkombëtar në atletike për sallat e hapura edhe si promovim i stadiumit të rikonstruktuar ‘Loro Borici’. Ky aktivitet u pa i arsyeshëm të mos zhvillohet për arsye se terreni i pistës së vrapimit në stadium nuk është brënda kushteve teknike për të zhvilluar gara.

P12.F2.O1.A1 Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia:

Eshte realizuar menaxhimi i Sport Klubit Vllaznia duke përfshirë, paga, siguracione, shërbime postare, shërbime internet dhe telefonie, energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu paisja e zyrave me materiale për zyra, si dhe kancelari, mundësimi i materiale të pastrimit. Është siguruar mbështetja për ekipin e ciklizmit me naftë për shoqërimin e sportistave gjatë stërvitjesme makinë. Ndërsa për mirëmbajtjen e

Pallatit të Sportit “Qazim Dervishi” janë siguruar vendosja e kamerave të sigurisë dhe lyerja e parketit. Për sportistat janë siguruar materialet sportive për të zhvilluar stërvitjen në kushte të pranueshme.

P12.F2.O1.A1 Administrimi dhe Mirembajtje e Stadiumit Loro Boriçi

Dorezimi i munguar i stadiumit “Loro Boriçi” solli mospërdorimin e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit “Loro Boriçi”. Kështu me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 477 datë 26.06.2018 është ngritur grupi i punës “Për marrjen në dorëzim të objektit stadiumi “ Loro Boriçi” dhe të dokumentacionit tekniko-ekonomik sipas investimit të realizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit” .

Grupi i punës , verifikoi dokumentacionin tekniko-ligjor dhe vëren se, Ne zbatim të VKM nr 408/2015 “ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “ të ndryshuar neni 25 ,27 dhe 27/1 në dokumentacionin e shqyrtuar verën se kishte mungese të theksuar dokumentacioni.

Bashkia Shkodër me shkresën nr 12731 prot datë 03.08.2018 i është drejtuar FSHF për plotësimin e dokumentacionit në mënyrë që të vijojmë me procedurën e mëtejshme të marrjes në dorëzim të punimeve të objektit.

P12.F2.O1.A3 Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia

Është realizuar administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shërbim të sigurimit të standarteve për drejtimin e tij. Për shkak të mosdorëzimit të Stadiumit “Loro Boriçi” nga FSHF dhe mospërdorimit të fondeve të planifikuara për menaxhimin e tij, si dhe me kërkesë të Klubit Futbollit Vllaznia u miratua rishpërndarja e fondeve duke i paksuar ato nga administrimi dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi”, dhe shtuar tek Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shumën 17 000 000 lekë.

P12.F2.O2.A1 Mbështetje të Ekipi i basketbollit meshkuj të rritur

Ekipi i Basketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967, 1969, 1990, 1993, 1994, 1995, 2000, 2014, 2015, 2016. Fitues i kupës së Republikës 8 herë në vitin 1957, 1959, 1965, 1989, 2001, 2008, 2013, 2014. Në vitin 2017 u rëndit në vend të katërt si në Kampionat Kombëtar, ashtu edhe në Kupë.

P12.F2.O2.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj.

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 7 herë në vitet 2005, 2006, 2008, 2010, 2013, 2017 dhe në vend të tretë për vitin 2018

P12.F2.O2.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura.

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka arritur në vazhdimësi rezultate të larta në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fitues i kupës së Republikës 2 herë në vitet 1962,1988. Sezonin sportiv 17-18 e mbylli në vendin e pestë.

P12.F2.O2.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja

Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra SK “Vllaznia” përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Gjatë historisë së tij ky ekip ka zënë gjithnjë vende të kënaqshme në renditje në aktivitetet e zhvilluara. Kampion kombëtar në vitin 2016, vendin të dytë në 2017 dhe kampion në vitin 2018.

P12.F2.O2.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.

Ekipi i të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973. Kampion kombëtar për vitin 2017-2018

P12.F2.O2.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura.

Ekipi i volejbollit të të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 3 herë në vitet 1947, 1957, 1960. Fitues i Kupës së Republikës 3 herë, në vitet 1962, 1963, 1964. Për vitin 2018 ekipi rënditet në vendin e fundit.

P12.F2.O2.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj.

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka fituar tre kampionate kombëtare në vitet 1997, 2001, 2012. Në sezonin sportiv 17-18 ka zënë vendin e 4.

P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja.

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të treta dhe të katërta në kampionatet kombëtare. Në vitin 2016, 2017 dhe 2018 ekipi shpallet kampion kombëtar.

P12.F2.O2.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur.

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 21 herë, në vitet 1951, 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013; 2015 dhe 2018. Fitues i kupës së Republikës 20 herë në vitet 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013. Si ekip rënditen në vendin e 1 në kampionat dhe në kupë.

P12.F2.O2.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur.

Ky ekip ka dalë kampion 18 herë në vitet 1993, 1994, 1997, 1998, 1999, 2003, deri në 2005, 2009 deri në 2017 kampion absolut. Fitues i Kupës së Republikës në 26 vitet e fundit në vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017. Kampion absolute për vitin 2018 duke marrë disa medalje të arta si në kampionat kombëtar, ashtu edhe në kupë të republikës.

P12.F2.O2.A11 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur.

Ekipi i ciklizmit të të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të para në kampionatet kombëtare (Rrethi ciklistik i Shqipërisë) 8 herë në vitet 1982, 1984, 1985, 1998, 1989, 1995, 1997, 2017. Kampion kombëtar për vitin 2018, dhe vend të parë në Kupë.

P12.F2.O2.A12 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura.

Ekipi i futbollit të femrave për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 25 sportiste dhe 2 trajnerë.

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 5 herë në vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Kampion absolut për 2018.

P12.F2.O2.A13 Mbështetje e ekipit të Gjymnastikës femra të rritura

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ekipi i gjymnastikës i të rriturve për meshkuj ka zënë vendin e parë në vitet 1976-1977, ndërsa ekipi i gjymnastikës i të rriturve për femra ka zënë 9 herë vendin e parë në kampionatet në vitet 2005, 2006, 2008, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018.

P12.F2.O2.A14 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 1994. Ky ekip mbas vitit 1994 deri në vitit 1998 nuk merr pjesë në asnjë aktivitet për arsye financiare dhe fillon aktivitet në vitin 1999 e në vazhdim. Ekipi i të rriturve në vitin 2014, 2015, renditet në vendin e dytë dhe të tretë duke patur rezultate shumë të

mira në aktivitetet kombëtare dhe merr pjesë disa here në aktivitetet miqësore ndërkombëtare. Rënditet në vend të dytë në vitin 2018.

P12.F2.O2.A15 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë N/kampion 2 herë në vitet 2009, 2010, nga vitit 2010 dhe deri 2015 renditet në e vendin e tretë. Gjithashtu për vitin 2018 është rënditur në vendin e tretë.

P12.F2.O2.A16 Mbështetje e ekipit të Notit të rritur dhe të rritura

Ekipi i notit për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Në gara individuale ka pasur shumë rezultate të larta, gjithsej 30 medalje ari, argjendi dhe bronzi. Rënditet në vendin e tretë dhe të katërt për vitin 2018.

P12.F2.O2.A17 Mbështetje e ekipit të peshngritjes meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 3 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 8 herë në vitet 1972, 1973, 1976, 1978, 1991, 2004, 2008, 2009. Në vitin 2018 rënditet në vendin e katërt.

P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit të Ping - Pong të rritur

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 6 here në vitet 1966, 1968, 1970, 1975, 1982, 1983.

Ky ekip, që në vitin 1990 merr pjesë rregullisht në kampionatin kombëtar dhe kupat e Republikës duke zënë vende të dyta dhe të treta. Këtë vit u rëndit në vend të 2 si në kampionat, ashtu edhe në kupë.

P12.F2.O2.A19 Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 2008. Vend i dytë në 2018.

P12.F2.O2.A20 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura

Ekipi përbëhet nga 40 kadet (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 5 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 11 herë kampioni Kupës së Republikës, dhe vazhdon të jetë kampion absolut në 2018.

P12.F2.O2.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja

Ekipi përbëhet nga 40 kadet (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 5 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 11 herë kampioni Kupës së Republikës, dhe vazhdon të jetë kampion absolut në 2018.

Fondet e financimit të programit:

Fondet e miratuara për vitin 2018 janë 139,136 mije lekë.

Realizimi për periudhën 12 mujore është 125,660 mije lekë, në masën 90% ndaj planifikimit vjetor .

Fondet për shpenzimet korrente sipas planit 2018 janë:

- Paga e sigurime shoqërore janë realizuar 9,839 mije lekë nga 11 276 mije lekë të planifikuara. Realizimi është në masën 87%.
- Shpenzime operative janë realizuar 28 957 mije lekë nga 40 615 mije lekë të planifikuara. Realizimi është në masën 71 %.
- Transferta janë realizuar në masën 75 874 mije lekë nga 75 877 mije lekë. Te planifikuara. Realizimi është në masën 99 %.
- Investime janë realizuar në masën 10 990 mije lekë nga 11 368 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 97 %.

Fonde te rialokuara 2018:

- Aktivitet ndërkombëtar atletike për salla të hapura; Rialokim pakësim 300 000 për arsye të mos zhvillimit të aktivitetit.(Vendim Kryetari nr. 169 dt 13.07.2018)
- Maratona e Pavarësisë Ulqin-Shkoder; Rialokim shtese 100 000 (A.2) Çmimet për fituesit (Vendim Kryetari nr. 224 dt 19.10.2018); rialokim shtese 30 000 (A.1) Publicitet (Vendim Kryetari nr.169 dt.13.07.2018)
- Aktivitete sportive beach voley masive dhe profesioniste; Rialokim shtesë 270 000 (A.4) Akomodim dhe trajtim ushqimor (Vendim Kryetari nr.169 dt.13.07.2018); rialokim pakësim 357 000 (A.4) Akomodim dhe trajtim ushqimor (Vendim Kryetari nr.224 dt.19.10.2018)
- Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj; rialokim pakësim 250 000 (Vendim Kryetari nr. 224 dt. 19.10.2018)
- Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura; rialokim shtesë 150 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018)
- Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura; rialokim shtesë 300 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018)
- Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur; rialokim shtesë 100 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018)
- Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur; rialokim shtesë 100 000 (Vendim Kryetari nr. 224 dt. 19.10.2018)
- Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj te rritur; rialokim pakësim 100 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018)
- Mbështetje e ekipit te peshëngritjes meshkuj te rritur; rialokim pakësim 600 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018)
- Mbështetje e ekipit te Shahut te rritur; rialokim shtesë 150 000 (Vendim Kryetari nr. 182 dt. 19.07.2018); rialokim shtesë 150 000 (Vendim Kryetari nr. 224 dt. 19.10.2018)
- Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura; rialokim shtesë 257 000 (Vendim Kryetari nr. 224 dt. 19.10.2018)

Projekti "Jeto me sportin" Rialokim fondi (VKB nr.53 dt 19.07.2018)

Pakësim; Programi Arsimit parauniversitar, i mesëm i përgjithshëm-9230, Emërtimi Ndërtim i fushave sportive (P9F1O2A14), Investime Art 230 = 405,000 lekë, Art 231 = 6,459,000 lekë Total = 6,864,000 lekë, Institucioni Drejtoria ekonomike e arsimit.

Shtesë; Programi Zhvillimi i sportit-8140, Emërtimi Ndërtim i fushave sportive (P9F1O2A14), Investime Art 231 = 6,864,000 lekë Total = 6,864,000 lekë, Institucioni Bashkia Shkodër qendër.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018:

- Tabela e produkteve dhe realizimit të tyre nga pikëpamja financiare

Aktiviteti

Buxheti
në mijë
lekë

Plani i
korrigjuar

Realizimi
2018
në mijë

lekë.

P12.F1.O1.A2 Kampionati i lojrave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës.	0	0	0
P12.F1.O1.A3 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër 2017	170	300	294.7
P12.F1.O1.A4 Festivali i Shahut	250	300	294.764
P12.F1.O1.A5 Aktivitete sportive beach voley masive dhe profesioniste.	800	713	678
P12.F1.O1.A8 Revista sportive "Vllaznia"	350	350	279
P12.F1.O1.A9 Aktivitet sportive ndërkombëtar, "Memorial "Vllaznia" 2018" nëboks.	400	400	386
P12.F1.O1.A10 Mirenjohje per sportistet dhe trajneret me te mire	20	20	19.2
P12.F1.O1.A11 Aktivitet sportiv ndërkombëtar 'Nënë Tereza' xhudo	400	400	400
P12.F1.O1.A12 Aktivitet ndërkombëtar Çiklizëm	130	130	128.4
P12.F2.O1.A1 Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia	17,393	17,393	15,317
P12.F2.O1.A2 Administrimi dhe mirembajtje e Stadiumit "Loro Borici"	10,800	10,800	0
P12.F2.O1.A3 Administrimi i Klubit te futbollit Vllaznia	45,000	75,000	75,000
P12.F2.O2.A1 Ekipi i basketbollit i te rriturve per meshkuj	3,200	2,950	2,874
P12.F2.O2.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj te rinj	570	570	536
P12.F2.O2.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura	1,400	1,550	1,550
P12.F2.O2.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	480	480	477
P12.F2.O2.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.	3,500	3,700	3,583
P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura	1,450	1,750	1,740
P12.F2.O2.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj	470	470	447
P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja	470	470	451
P12.F2.O2.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur	2,900	3,000	2,984
P12.F2.O2.A10 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur	2,800	2,800	2,772



P12.F2.O2.A11 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur	1,250	1,350	1,347
P12.F2.O2.A12 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura	800	800	800
P12.F2.O2.A13 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura	850	850	846
P12.F2.O2.A14 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur	131	131	110
P12.F2.O2.A15 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj te rritur	740	640	634
P12.F2.O2.A16 Mbështetje e ekipit te Notit te rritur dhe te rritura	97	97	72
P12.F2.O2.A17 Mbështetje e ekipit te peshngritjes meshkuj te rritur	1,300	700	691
P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit te Ping - Pong territor	200	200	132
P12.F2.O2.A19 Mbështetje e ekipit te Shahut te rritur	137	437	432
P12.F2.O2.A20 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rritur/të rritura	800	1,057	1,050
P12.F2.O2.A20 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja	300	300	282
Total	99,558	139,136	125,664

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12-mujorin 2018

Vështiresite e ndëshura përgjatë realizimit të Buxhetit 2018 në programin Rinia e Sportet janë si më poshtë:

- Procedurat e tenderimit të shërbimeve dhe blerjes së mallrave të ndryshem sportive shpesh kanë hasur në vonesa për shkak të aplikimeve të operatorëve të vetëm ekonomike si dhe pastaj tërheqjes së tyre, apo dhe mos paraqitjes të operatorëve edhe pse procedurat janë përsëritur, duke shkaktuar mosrealizimin e plotë të projekteve të planifikuara.
- Demtimi i pistes se atletikes ne stadiumin “Loro Boriçi” solli mos realizimi e projektit aktivitet nderkombetar ne atletike per sallat e hapura.
- Dorezimi i munguar i stadiumit “Loro Boriçi” solli mospërdorimin e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit “Loro Borici”. Kështu me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 477 datë 26.06.2018 është ngritur grupi i punës “Për marrjen në dorëzim të objektit stadiumi “ Loro Borici” dhe të dokumentacionit tekniko-ekonomik sipas investimit të realizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit“ .
Grupi i punës , verifikoi dokumentacionin tekniko-ligjor dhe vëren se, ne zbatim të VKM nr 408/2015 “ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “ të ndryshuar neni 25 ,27 dhe 27/1 në dokumentacionin e shqyrtuar , se kishte mungese te theksuar dokumentacioni.
Bashkia Shkodër me shkresën nr 12731 prot datë 03.08.2018 i është drejtuar FSHF për plotësimin e dokumentacionit në mënyrë që të vijojmë me procedurën e mëtejshme të marrjes në dorëzim të punimeve të objekti.

P13. Emergjencat Civile

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Politikat e ndjekura gjatë 2018 janë bazuar në :

- 1- Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile
- 2- Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin
- 3- Parandalimi nga dëmtime të emergjencave civile
- 4- Informim publik për reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave.

F1. Planifikim, menaxhim, përballim i emergjencave civile.

F2. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

Objektivat për këtë funksion janë:

F1.O1. Krijimi i strukturave për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

F2.O1 Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Produktet për vitin 2018

F.1.O1.A2. Gjatë vitit 2018 janë trajtuar me ndihmë të menjëhershme nga Bashkia Shkodër të gjitha rastet e paraqitura pranë saj.

Është bërë plotesimi i dokumentacionit për dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie

Është bërë vlerësimi dhe hartuar dokumentacioni për banesat e përmytura për 59 raste. Raste zjarri në banesa 19. Është kryer verifikimi e hartuar dokumentacioni, është dhënë ndihma e menjëhershme.

Është bërë plotesimi i dokumentacionit për vlerësimin e dëmit ekonomik për familjet me raste fatkeqësie

Në mars-prill 2018 Të përmytur në 6 Nj.A (Gur i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Rrethina) + Qytet jane 5000 ha dhe shtëpi të rrethuara e me prezencë nga uji 734. Është punuar për përballimin e situatave të përmytjeve të shkaktuara në zonën e Nënshkodrës në periudhën mars-prill 2018, në Nj. Administrative të Gurit të Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Rrethina dhe në Qytet. U bë i mundur kordinimi i punës me të gjitha Drejtoritë e Bashkisë dhe administratat e Nj. A. për mbajtjen në gadishmëri dhe pjesëmarrjes së tyre në sistemet e lajmërimit të hershëm, të evakuimit, të shpërndarjes së ndihmave ushqimore, në kontributin e tyre në forcimin e argjaturave e pritave të rrezikuara nga ujrat e lumenjve, duke bërë të mundur që të mos rrezikohet asnjë jetë njerëzore apo bagëtie. U bashkëpunua me komunitetin duke realizuar një përfshirje të gjerë të tij në reduktimin e riskut nga fatkeqësitë e pashmangshme të motit. U realizua bashkëpunimi me Institucionet e tjera si Prefektura, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Reparti Ushtarak Vau i Dejës, Drejtoria e Policisë së Qarkut e Shoqatave të ndryshme të huaja apo vendase që ofruan ndihmesën e tyre në përballimin e situatës së vështirë që preku Bashkinë tonë.

U organizuan dhe u pa gadishmëria dhe mirëfunksionimi i vend evakuimeve në godinat e konvikteve të shkollave të mesme për personat në nevojë si dhe vendeve të përcaktuara për evakuimin e gjesë së gjallë në Bërdicë dhe pranë tregut të gjesë së gjallë në Golem.

Kanë funksionuar skemat e lajmërimit dhe evakuimit, janë kryer masat e hartuara për mbajtjen nën kontroll të territorit me gjithë gjendjen në kushte emergjence, duke bërë të mundur kalimin e kësaj gjendjeje pa pasoja jetësore dhe të gjësë së gjallë.

Është punuar pa ndërprerje për 24 orë si pranë Qendrës Operacionale të ngritur pranë Bashkisë Shkodër ashtu edhe në terren, duke ruajtur komunikimin për marrje dhe dhënie informacioni të vazhdueshëm dhe në kohë reale duke ndihmuar në zvogëlimin e pasojave të mundshme duke marrë pjesë në aktivizimin e strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile të Bashkisë dhe në qëndrimin sa më afër banorëve dhe kontributin direkt pranë tyre.

Nga ana e Këshillit Bashkiak, unanimisht është kërkuar shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Bashkisë Shkodër, me Rezolutën Nr. 2, datë 09.03.2018.

Bazuar në Urdhërin e Kryetares së Bashkisë Shkodër nr. 311, datë 11.04.2018, janë ngritur grupet e punës dhe janë kryer evidentimet e dëmeve të shkaktuara në banesa. Me Urdhërin nr. 317, datë 13.04.2018 janë ngritur grupet e punës për vlerësimet në ekonomitë bujqësore, infrastrukturë dhe objekte shtetërore si në shkolla, ujësjellësa, kabina elektrike, etj dhe janë raportuar në kohë pranë institucioneve të tjera.

Vlerësimet e bëra për dëmet në banesa, orendi, pajisje kanë kaluar në Këshillin Bashkiak ku janë miratuar vlerat e dëmeve me V.K.B. nr. 51, datë 19.07.2018, sipas të cilëve dëmet e shkaktuara janë për 19 banesa në Nj.A Ana e Malit me vlerën 3 317 133 lekë, në Nj. A. Dajç 17 banesa me vlerën 2 716 350 lekë dhe Qytet + Rrethina 23 banesa me vlerë 3 828 941,95 lekë. Dokumentacioni i hartuar është dërguar pranë Institucionit të Prefektit për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Dëmet e shkaktuara në bujqësi kanë përfshirë një sipërfaqe prej 2078,9 Ha me një vlerë dëmi prej 310 974 940 lekësh. Dokumentacioni është dërguar pranë Institucioneve përkatëse. Gjatë periudhës së përmbytjeve Bashkia Shkodër u ndihmua nga Institucione shtetërore dhe private me ndihma për nevojat më emergjente si krevate, batanije, ujë, ushqime, bazë ushqimore për gjënë e gjallë, etj., në një vlerë afërsisht prej 20 milionë lekësh. Problematike ishte mos shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme edhe pse e kërkuar nga Bashkia Shkodër dhe unanimisht nga ana e Këshillit Bashkiak si dhe buxhetimi për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e pësura në banesa dhe në kulturat bujqësore për zonat e përmbytura.

F1.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe çertifikimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.

- Blerje dhe Rimbushtje fikse Zjarri, Sensor tymi. Për këtë objekt është hartuar dokumentacioni tekniko – ekonomik dhe është në procedurë prokurimi

F2.O1.A1

Jane realizuar pagat dhe sigurimet, janë blerë materiale kancelaria, është paguar energjia elektrike, shërbim telefoni dhe ujësjellësi. Janë realizuar shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme mjete transporti, pjesë këmbimi, goma, bateri, kolaudim dhe siguracione.

Është realizuar blerja 20 pale uniforma intervenimi.

Për vitin 2018 janë realizuar shërbimet e mëposhtme:

Akte ekspertize 36 raste, kontrole, rikontrôle, verifikime 568 raste, Akte teknike (Çertifikata riçertifikime) 196 raste, Miratuar projekte Zjarri (leje ndërtimi) 73 raste, Vërtetime zjarri janë dhënë 30 raste, Ndërhyrje gjithsejt 664 raste (Aksidente, bllokime dyersh, etj 214 raste dhe zjarre 450 raste).

Fondet e financimit të programeve

Me VKB nr.55, dt 19.07.2018 për rishpërndarje të fondeve të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 260,000 lekë me tvsh për aktivitetin:

Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër

Me VKB nr.55, dt 19.07.2018 për rishpërndarje të fondeve të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 940,915 lekë me tvsh për aktivitetet:

Rregjistrim, kolaudim, targa me shumë 75,000 lekë

Siguracion automjetesh me shumë 25,000 lekë

Pagesë energji elektrike me shumë 300,000 lekë

Pagesë ujësjellsi me shumë 100,000 lekë

Trajnime dhe Seminare me shumë 185,000 lekë

Shpenzime për mirmbajtje të zakonshme mjete transporti me shumë 255,915 lekë

Me vendim të Kryetares së Bashkisë, nr 239, dt 15.05.2018, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 1,000,000 lekë për aktivitetin e mëposhtëm:

Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (shitesë fondi)

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2018, paraqitet si më poshtë:

Fondet e miratuara për këtë program janë 55,340 lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 50,194 në masën 91 % ndaj planit vjetor.

- a) Shpenzime Operative janë realizuar në masën 9,761 mijë lekë nga 10,021 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 97 %.
- b) Transferta janë realizuar në masë 1,971 mijë lekë nga 2,051 mijë lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi në masë 96%
- c) Investime janë realizuar në masën 7,000 mijë lekë nga 10,000 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 70 %.
- d) Pagat janë realizuar në masën 31,462 mijë lekë nga 33,268 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 95 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P13.F1.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër.	-	260	-
P13.F1.O1.A2.Organizimi i strukturës së mbrojtjes civile dhe i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër	1,600	1,600	1,520
P13.F1.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimidhe çertifikimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.	7,000	7,000	4,000
P13.F2.O1.A1.Shërbimi i MZSH	43,539	46,480	44,674
TOTALI	52,139	55,340	50,194

I. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2018

F1.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. Me VKB nr.55, dt 19.07.2018 për rishpërndarje të fondeve të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër, është miratuar rialokimi i fondeve me shumë totale: 260,000 lekë me tvsh për aktivitetin:

Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër Ky fond nuk është përdorur dhe mbetet gjendje për t'u përdorur për situata të paparashikuara.

F1.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe çertifikimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë.

- Projektimi akteve teknike kundra zjarrit. Këto projekte anë në proces hartimit pasi janë pjesë e projekteve teknike që realizohen në bashkëpunim me zyrën e projekteve për ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve.

Anekset 1-5 të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018.

Matrica e realizimit të buxhetit të vitit 2018, sipas programeve.